



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 145

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E martë, 13 gusht 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 272, datë 29.7.2024	Për miratimin e rregullores për standardizimin dhe administrimin e shtigjeve turistike..... 18497
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 602, datë 5.8.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Gjermanisë..... 18524
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 603, datë 5.8.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Ukrainës..... 18527
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 604, datë 5.8.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Italisë..... 18530
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 18.7.2024	Çështja Papakostandini kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 7568/08</i>) 18532
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 18.7.2024	Çështja Spahiu dhe të tjerë kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 79452/17 dhe 2 të tjera</i>) 18536
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 4.7.2024	<i>Kërkesa nr. 29264/16</i> , Piro Kuko kundër Shqipërisë dhe 3 kërkesa të tjera..... 18541
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 54, datë 9.7.2024	Me objekt shfuqizimin e ligjit nr. 106, datë 21.12.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8891, datë 2.5.2002, ‘Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit’” Pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 106, datë 21.12.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8891, datë 2.5.2002, ‘Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit’” 18542

Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 11830/2, datë 7.8.2024	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare.....	18563
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 42, datë 7.8.2024	Për disa ndryshime në rregulloren “Për licencimin, ushtrimin e veprimtarisë, revokimin e licencës dhe likuidimin e portofolit të kredive të krijuar nga ushtrimi i veprimtarisë financiare nga subjektet financiare jobanka”	18563
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 43, datë 7.8.2024	Për miratimin e rregullores “Për informacionin që shoqëron transfertat e fondeve”	18565
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 134, datë 9.7.2024	Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s lidhur me licencimin e shoqërisë “H.K. HEC Grabova 2” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	18573
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 135, datë 9.7.2024	Mbi licencimin e shoqërisë “5GX Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	18574
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 137, datë 10.7.2024	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin qershor 2024 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.....	18576
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 138, datë 10.7.2024	Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	18578
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 141, datë 16.7.2024	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “BMG Energy Sal” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	18579
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 142, datë 16.7.2024	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	18580
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 143, datë 16.7.2024	Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k., si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.....	18581
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 146, datë 19.7.2024	Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s lidhur me kërkesën e shoqërisë “Nova Prospect” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	18582
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 147, datë 19.7.2024	Mbi dhënien e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga HEC “Dragobia” dhe HEC “Cerem” të shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k.....	18583
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier nr. 62-2024-2389 (289), datë 3.5.2024	Vendim për shpalljen të zhdukur të shtetasit Lorenc Silaj.....	18585

**URDHËR****Nr. 272, datë 29.7.2024****PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
PËR STANDARDIZIMIN DHE
ADMINISTRIMIN E SHTIGJEVE
TURISTIKE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 28/1, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore për standardizimin dhe administrimin e shtigjeve turistike, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, bashkitë, Federata Shqiptare e Alpinizmit dhe Turizmit Malor.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi

**RREGULLORE
PËR STANDARDIZIMIN DHE
ADMINISTRIMIN E SHTIGJEVE
TURISTIKE****KREU I**
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**Neni 1**
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është:

1. Përcaktimi i autoriteteve përgjegjëse për administrimin e shtigjeve turistike (këtu e më tej “shtigjet”);

2. Krijimi i Regjistrit Kombëtar të Shtigjeve;

3. Përcaktimi i rregullave për regjistrimin e shtigjeve dhe përditësimin e informacionit në Regjistrin Kombëtar të Shtigjeve;

4. Përcaktimi i rregullave për regjistrimin digjital të shtigjeve;

5. Përcaktimi i rregullave për përcaktimin e kohës së ecjes në shtigje;

6. Përcaktimi i rregullave për numërtimin e shtigjeve;

7. Përcaktimi i kategorive të shtigjeve dhe kritereve që do të përdoren për klasifikimin e shtigjeve në kategoritë e përcaktuara;

8. Përcaktimi i informacionit mbi shtigjet;

9. Krijimi i platformës së shtigjeve;

10. Përcaktimi i rregullave dhe udhëzimeve për projektimin dhe hapjen e shtigjeve;

11. Përcaktimi i rregullave dhe udhëzimeve për projektimin dhe realizimin e ndërhyrjeve në shtigje;

12. Përcaktimi i rregullave dhe udhëzimeve për sinjalistikën në shtigje;

13. Përcaktimi i rregullave dhe udhëzimeve për inspektimin dhe mirëmbajtjen e shtigjeve;

14. Përcaktimi i modeleve tip të raporteve të inspektimit;

15. Përcaktimi i rregullave të sjelljes së vizitorëve të shtigjeve; dhe

16. Përcaktimi i autoriteteve përgjegjëse për trajnimin dhe certifikimin e shtegmbajtësve.

Neni 2
Qëllimi

Kjo rregullore synon të krijojë kushtet e nevojshme për standardizimin dhe miradministrimin e shtigjeve, për të promovuar rekreacionin në natyrë, turizmin rural dhe atë të aventurës, për të garantuar sigurinë e vizitorëve të shtigjeve dhe ruajtur mjedisin.

Neni 3
Përkufizime

Për qëllimin e interpretimit dhe zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

1. “Degëzime shtigjesh”, janë rrugë të mbyllura që ofrojnë akses në struktura mbështetëse dhe pika të rëndësishme, afër shtegut kryesor, si, zona kampimi, vende parkimi, burime ujore, zona historike, pika vërtetimi etj. Degëzimet e shtigjeve mund të çojnë dhe në shtegun kryesor nga një shteg dytësor, si dhe mund të përmirësojnë eksperiencën duke i lejuar vizitorëve, të shikojnë pjesë interesante të zonës ku shtegu kryesor nuk arrin të kalojë;

2. “Destinacion”, është një vendndodhje e veçantë që arrihet përmes kalimit në një shteg, si, por



pa u kufizuar te, majat e maleve, fshatrat, dhe pikat e rëndësishme gjeografike;

3. “Grupe interesi”, janë udhërrëfyesit e specialitetit të veçantë *hiking*, udhërrëfyesit vendorë, barinjtë, pronarët e parcelave dhe banorët e zonës ku kalon shtegu, operatorët turistikë, donatorët dhe organizatat jo fitimprurëse që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre zhvillimin e produkteve turistike;

4. “Gjerësi shtegu”, është hapësira pa shkurre, degë, ferra, bar të lartë, barishte dhe pengesa të tjera në shteg, që mund të përplasen me vizitorin ose që mund ta lagin atë pas një shiu ose vese të rënë;

5. “Koha e ecjes”, është koha mesatare që i duhet një vizitori mesatar për të përshkruar shtegun, pa llogaritur kohën për të pushuar, në kushte meteorologjike optimale dhe në mungesë të mbulimit të borës;

6. “Ligatina”, janë sipërfaqe ujore, kryesisht me ujë të cekët ose me terren të njomë, si, por pa u kufizuar te, kënetat e cekëta dhe ato të thella, kënetat me shkurre, kënetat pyjore, moçalet etj. Ligatinat janë terrene të brishta dhe kanë zakonisht specie delikate bimësh dhe kafshësh;

7. “Piktograme”, janë shenja që mund të përdoren në tabelat e vendosura në shtigje, për të shfaqur grafikisht një informacion të caktuar, në mënyrë që të kursehet hapësirë në tabelë;

8. “Rrugëkalim alpin”, është një rrugë e cila të çon në terrene të hapura ose të larta alpine me interes turistik. Kjo rrugë mund të përmbajë kalime të ekspozuara, të rrëshqitshme, të prirura për rënie dhe të pasigurta për ecje dhe ngjitje;

9. “Sipërfaqe e ecjes”, është sipërfaqja faktike e shtegut që shkelet, pavarësisht nëse është terren natyror apo jo natyror;

10. “Struktura mbështetëse (facilitete)”, janë struktura të ngritura, për të ofruar lehtësi apo shërbime për vizitorët, si, por pa u kufizuar te, strehat, zonat e kampimit, vendet e parkimit dhe stendat ose kioskat e informacionit;

11. “Shteg i lehtë”, është një rrugë pa vështirësi kalimi, përgjatë apo drejt vendndodhjeve të veçanta me interes turistik, që mund të jetë herë pas here e ngushtë dhe e pjerrët;

12. “Shteg malor i moderuar”, është një rrugë kryesisht e ngushtë dhe shpesh e pjerrët, që mund të ketë pjesë që janë të rrezikshme, nga ku mund të rrëzohesh. Kjo rrugë mundëson ecjen ose kalimin

përgjatë apo drejt vendndodhjeve të veçanta me interes turistik;

13. “Shteg malor i vështirë”, është një rrugë e ngushtë dhe shpesh e pjerrët, me pjesë të rrezikshme nga ku mund të rrëzohesh, vendkalime të siguruara të shpeshta dhe pjesë ngjitjeje që kërkojnë përdorimin e duarve, siguri në ecje dhe aftësi të mira në lartësi. Kjo rrugë mundëson ecjen ose kalimin përgjatë apo drejt vendndodhjeve të veçanta me interes turistik;

14. “Shtegmbajtës”, është personi përgjegjës për përmbushjen e detyrave që kanë të bëjnë me punët e terrenit, në pikën 3, të nenit 4, të kësaj rregulloreje;

15. “Shteg tematik”, është një shteg i cili ka një qëllim edukativ të qartë natyror, gjeologjik, historik, kulturor etj. Shtigjet tematike pajisen zakonisht me sinjalistikë të veçantë dhe pika vrojtimi.

KREU II

AUTORITETET PËRGJEGJËSE PËR ADMINISTRIMIN E SHTIGJEVE DHE REGJISTRI KOMBËTAR I SHTIGJEVE

Neni 4

Autoritetet përgjegjëse për administrimin e shtigjeve

1. Autoritetet përgjegjëse për administrimin e shtigjeve janë ministria përgjegjëse për turizmin, bashkitë dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (këtu e më tej “AKZM”), nëpërmjet degëve të saj rajonale.

2. Përgjegjësitë e ministrisë përgjegjëse për turizmin, janë:

a) krijimi dhe administrimi i Regjistrit Kombëtar të Shtigjeve;

b) regjistrimi i shtigjeve dhe informacionit përkatës në Regjistrin Kombëtar të Shtigjeve;

c) regjistrimi i ndryshimeve në informacionin mbi shtigjet, në Regjistrin Kombëtar të Shtigjeve; dhe

ç) krijimi, mirëmbajtja dhe administrimi i platformës së shtigjeve.

3. Dega rajonale e AKZM-së është përgjegjëse për administrimin e shtigjeve që ndodhen brenda zonave të mbrojtura, në territorin e saj. Përgjegjësitë e degës rajonale të AKZM-së, janë:

a) regjistrimi digjital i shtigjeve;

b) përcaktimi i kohës së ecjes në shtigje;

c) numërtimi i shtigjeve;



ç) klasifikimi i shtigjeve në kategoritë e përcaktuara;

d) përpilimi i informacionit mbi shtigjet, në përputhje me nenin 11, të kësaj rregulloreje;

dh) projektimi dhe hapja e shtigjeve të reja;

e) projektimi dhe realizimi i ndërhyrjeve në shtigjet ekzistuese;

ë) vendosja dhe zëvendësimi i strukturave aksesore në shtigje;

f) vendosja dhe zëvendësimi i sinjalistikës në shtigje;

g) inspektimi dhe mirëmbajtja e shtigjeve;

gj) përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm, për regjistrimin e shtegut dhe informacionit për të në Regjistrin Kombëtar të Shtigjeve, si dhe dokumentacionit të nevojshëm për përditësimin e informacionit mbi shtegun;

h) shqyrtimi i propozimeve, në përputhje me nenin 31, të kësaj rregulloreje.

4. Bashkia është përgjegjëse për administrimin e shtigjeve, që ndodhen brenda territorit të saj, por jashtë zonave të mbrojtura. Përgjegjësitë e bashkisë në funksion të administrimit të shtigjeve, janë të njëjta me ato të degëve rajonale të AKZM-së.

5. Përveç kur parashikohet ndryshe nëpërmjet një marrëveshjeje, në rast se shtegu shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose dege rajonale të AKZM-së, autoritet përgjegjës për shtegun është ai autoritet, në territorin e të cilit, shtegu ka gjatësinë më të madhe.

6. Bashkia ose AKZM-ja mund të kontraktojnë, persona fizikë ose juridikë privatë, me përvojë në turizmin e shtigjeve të ecjes, për të asistuar në përmbushjen e detyrave, në pikën 3, të këtij neni. Personat fizikë ose juridikë privatë kontraktohen, në përputhje me legjislacionin në fuqi mbi procedurat e prokurimit publik.

Neni 5

Regjistri Kombëtar i Shtigjeve

1. Për qëllimin e zbatimit të kësaj rregulloreje dhe mirë administrimit të shtigjeve krijohet, Regjistri Kombëtar i Shtigjeve.

2. Regjistri Kombëtar i Shtigjeve krijohet dhe administrohet nga ministria përgjegjëse për turizmin.

3. Regjistrin Kombëtar i Shtigjeve përmban, së paku, informacionin e mëposhtëm, për çdo shteg të regjistruar:

a) numrin e shtegut;

b) emrin e autoritetit përgjegjës për shtegun (bashkia apo dega rajonale e AKZM-së);

c) prezantimin planimetrik të shtegut, në shkallë jo më të vogël se 1: 25,000;

ç) profilin topografik të rrugës, në një shkallë jo më të vogël se 1: 25,000;

d) koordinatat gjeografike dhe lartësinë e pikave të rëndësishme të shtegut, me frekuencë të tillë që të lejojë identifikimin e kursit planimetrik të vetë shtegut;

dh) informacionin e përgjithshëm mbi shtegun dhe përshkrimin e rrugëkalimit, sipas nenit 11, të kësaj rregulloreje;

e) përshkrimin ortografik dhe fotografik të karakteristikave të shtegut, si peizazhi dhe aspekte të tjera, natyrore, historike dhe kulturore.

4. Ministri përgjegjës për turizmin ka të drejtën të kërkojë informata apo të dhëna të tjera, për shtigjet e regjistruara, që i shtohen informacionit të parashikuar në pikën 3, të këtij neni. Të dhënat e tjera për shtigjet, miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.

5. Regjistrimi i shtigjeve në Regjistrin Kombëtar të Shtigjeve, si dhe përditësimi i informacionit të lidhur me to, bëhet në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në nenin 6, të kësaj rregulloreje.

Neni 6

Regjistrimi dhe përditësimi i informacionit mbi shtigjet

1. Bashkitë dhe degët rajonale të AKZM-së, përgatisin dokumentacionin me informacionin e kërkuar në zbatim të nenit 5, të kësaj rregulloreje, për çdo shteg që kanë në përgjegjësi administrimi dhe e paraqesin atë në ministrinë përgjegjëse për turizmin, me qëllim regjistrimin e shtegut në Regjistrin Kombëtar të Shtigjeve.

2. Sektori përgjegjës në ministrinë për turizmin, shqyrtton dhe vlerëson kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të kërkesës dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj.

3. Në rast të konstatimit të mangësive në dokumentacionin e paraqitur, ministria përgjegjëse për turizmin njofton brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të kërkesës,



autoritetin që ka paraqitur kërkesën për plotësimin e dokumentacionit.

4. Sektori përgjegjës në ministrinë për turizmin ka të drejtën, që në kuadër të shqyrtimit të kërkesës për regjistrimin e shtegut në Regjistrin Kombëtar të Shtigjeve, të kërkojë ngritjen e një grupi pune, për verifikimin në terren të informacionit të paraqitur. Në përbërje të grupit të punës duhet të jetë dhe një përfaqësues i Federatës Shqiptare të Alpinizmit dhe Turizmit Malor. Sektori përgjegjës në ministrinë për turizmin, njofton autoritetin që ka paraqitur kërkesën dhe grupin e verifikimit, si dhe koordinon vizitën në terren.

5. Grupi i punës i ngritur me urdhër ministri, kryen verifikimet e nevojshme në terren dhe i paraqet sektorit përgjegjës në ministrinë për turizmin, raportin përmbledhës mbi gjetjet e konstatuara, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga dita e autorizimit të verifikimit.

6. Afati i parashikuar në pikën 2, të këtij neni, mund të shtyhet në mënyrë të arsyetuar, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike.

7. Në përfundim të procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit, ministria përgjegjëse për turizmin merr vendim për miratimin ose jo të kërkesës për regjistrimin e shtegut.

8. Nëse kërkesa miratohet, shtegu dhe informacioni për të, regjistrohet në Regjistrin Kombëtar të Shtigjeve.

9. Me përjashtim të rasteve kur përditësimi duhet të bëhet me një procedurë të përsheptuar, për përditësimin e informacionit mbi shtegun dhe regjistrimin e tij në Regjistrin Kombëtar të Shtigjeve, ndiqen të njëjtat procedura, të parashikuara në pikat 1 deri 8, të këtij neni.

10. Për rastet e përditësimeve të informacionit që kërkojnë procedurë të përsheptuar shqyrtimi, afatet e parashikuara në këtë nen, përgjysmohen.

KREU III INFORMACIONI MBI SHTIGJET DHE PUBLIKIMI I TIJ

Neni 7 Regjistrimi digjital i shtegut

1. Bashkitë dhe degët rajonale të AKZM-së, bëjnë regjistrimin digjital të çdo shtegu ekzistues ose të ri, që kanë në përgjegjësi administrimi, sipas pikave 3, 4 dhe 5, të nenit 4, të kësaj rregulloreje.

Regjistrimi kryhet përmes përdorimit të formatit *GPX* dhe sistemit gjeodezik *WGS84*.

2. Shtigjet regjistrohen në terren, në kohë reale, përgjatë përshkrimit të shtegut me këmbë dhe përdorimit të një pajisje *GPS* ose një aplikacioni hartografik. Për këtë qëllim, mund të përdoret aplikacioni *Outdooractive* ose aplikacione të ngjashme.

3. Përfaqësuesit e autoritetit përgjegjës që kryejnë regjistrimin digjital të shtegut, në përputhje me pikën 2, të këtij neni, kanë detyrimin të regjistrojnë pikat e rëndësishme të shtegut, si zonat historike, pjesët lidhëse me shtigje të tjera, pikat e vrojtimit, burimet e ujit, si dhe strukturat mbështetëse (facilitetet).

4. Pikave të rëndësishme të shtegut dhe strukturave mbështetëse duhet t'u bëhen foto gjeoreferenciale (foto me koordinata gjeografike).

5. Përfaqësuesit e autoritetit përgjegjës përcaktojnë gjatësinë e shtegut në kilometra, ngjitjen dhe zbritjen në metra, si dhe pikën më të lartë dhe të ulët të shtegut po ashtu në metra, përmes gjurmës *GPS* të shtegut dhe përdorimit të një platforme hartografike, si për shembull, *Outdooractive*.

6. Çdo gabim ose pasaktësi që vjen nga regjistrimi në terren, korrigjohet më pas në një kompjuter portativ, përmes përdorimit të një platforme hartografike, si për shembull, *Outdooractive*.

Neni 8 Kategoritë e shtigjeve dhe kriteret për klasifikimin e shtigjeve

1. Për qëllimin e zbatimit të kësaj rregulloreje, shtigjet klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- a) shteg i lehtë;
- b) shteg malor i moderuar;
- c) shteg malor i vështirë; dhe
- ç) rrugëkalim alpin.

2. Klasifikimi i një shtegu në një nga kategoritë e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, bazohet kryesisht në pjesën më të vështirë të shtegut. Për klasifikimin e shtegut në kategorinë përkatëse, bashkia ose dega rajonale e AKZM-së, bazohen në përkufizimet e dhëna në pikat 8, 11, 12 dhe 13, të nenit 3, të kësaj rregulloreje, si dhe te kriteret e mëposhtme:

- a) gjerësia e shtegut, kushtet e pjerrësisë dhe rreziku i rënies;
- b) nevoja për litarë ose kablllo mbrojtëse dhe frekuenca e tyre;



c) nevoja për përdorimin e duarve për të ruajtur ekuilibrin ose për të lëvizur;

ç) frekuenca e pjesëve të vështira të shtegut;

d) vështirësia e ngjitjes në pjesë të ndryshme të shtegut;

dh) vështirësia e rrugës në krahasim me nivelin e kërkuar të koordinimit.

Neni 9

Përcaktimi i kohës së ecjes

1. Bashkitë dhe degët rajonale të AKZM-së, përcaktojnë kohën e ecjes për çdo shteg ekzistues ose të ri, që kanë në përgjegjësi administrimi, sipas pikave 3, 4 dhe 5, të nenit 4, të kësaj rregulloreje.

2. Koha e ecjes për shtigjet e lehta përcaktohet duke u bazuar në standardin *DIN 33466*, si më poshtë:

a) 300 (treqind) metra lartësi-orë në ngjitje;

b) 500 (pesëqind) metra lartësi-orë në zbritje; dhe

c) 4 (katër) kilometra-orë, për gjatësi.

3. Për shtigjet në kategoritë e tjera, koha e ecjes përcaktohet duke u bazuar në një version të përshtatur të standardit *DIN 33466*, si më poshtë:

a) 400 (katërqind) metra lartësi-orë në ngjitje;

b) 600 (gjashtëqind) metra lartësi-orë në zbritje; dhe

c) 4 (katër) kilometra-orë, për gjatësi.

4. Për llogaritjen e kohës së ecjes, vlerës më të lartë, midis vlerës përkatëse për lartësi-orë në ngjitje ose zbritje dhe gjatësisë për orë, i shtohet vlera më e ulët midis tyre, që pjesëtohet me 2 (dy), sipas formulës në vijim:

a) “vlera më e lartë + vlera më e ulët/2 = koha e ecjes”

5. Koha e ecjes në shteg përcaktohet ndarazi për të dy drejtimet, si dhe për të dyja drejtimet së bashku.

6. Për shtigjet që karakterizohen nga terreni i vështirë, i cili e bën ecjen të ngadalshme, është e nevojshme të përshtatet koha e ecjes, duke e rritur këtë të fundit deri në 20 (njëzet) për qind, në varësi të terrenit.

Shembuj:

Shembulli 1. Llogaritja e kohës së ecjes, për ngjitjen e një shtegu malor në lartësinë 1000 m, me një gjatësi prej 6 km:

- ngjitje 1000 m = 2,5 orë

- 6 km gjatësi = 1,5 orë

Llogaritja e kohës së ecjes

2,5 orë (vlera më e lartë) + 1,5 orë (vlera më e ulët)/2 = 3 orë 15 minuta (koha e ecjes)

Shembulli 2. Llogaritja e kohës së ecjes, për zbritjen e një shtegu malor në lartësinë 900 m, me një gjatësi prej 12 km:

- zbritje 900 m = 1,5 orë

- 12 km gjatësi = 3 orë

Llogaritja e kohës së ecjes

3 orë (vlera më e lartë) + 1,5 orë (vlera më e ulët)/2 = 3 orë e 45 minuta (koha e ecjes)

Neni 10

Numërtimi i shtigjeve

1. Shtigjet identifikohen me numra tre- ose katërshifrorë. Shifra e parë dhe e dytë përfaqëson bashkinë ku ndodhet shtegu, ndërsa shifra e tretë dhe e katërt, vetë shtegun.

2. Numri që identifikon bashkinë ku ndodhet shtegu është një ose dyshifror, ndërsa numri që identifikon shtegun është gjithmonë dyshifror.

3. Numri që identifikon shtegun varion nga 1 (një) në 99 (nëntëdhjetë e nëntë) për çdo bashki. Shtegut që i vendoset një numër nga 1 (një) në 9 (nëntë), i shtohet një 0 (zero) përpara numrit.

4. Shtigjet që shtrihen në territoret e dy ose më shumë bashkive, marrin numrin e bashkisë ku shtegu ka gjatësinë më të madhe.

5. Shtigjet e shkurtra, që shfaqen si alternativa ose variante të shtigjeve kryesore, identifikohen me numrin e shtegut kryesor, të shoqëruar nga një shkronjë, sipas rendit alfabetik.

6. Kodet e bashkive të listuara sipas rendit alfabetik, janë përcaktuar me numra rendor në tabelën në shtojcën 1, që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Shembuj:

- shtegu nr. 1 në Bashkinë Belsh: numri identifikues i shtegut, 101;

- shtegu nr. 5 në Bashkinë Mallakastër: numri identifikues i shtegut, 3705;

- alternative e shtegut nr. 99 në Bashkinë Devoll: numri identifikues i shtegut, 699a.

Neni 11

Përpilimi i informacionit mbi shtegun

1. Bashkitë dhe degët rajonale të AKZM-së, përpilojnë informacionin e nevojshëm për çdo shteg ekzistues ose të ri, që kanë në përgjegjësi



administrimi, sipas pikave 3, 4 dhe 5, të nenit 4, të kësaj rregulloreje.

2. Informacioni për shtegun përfshin informacionin e përgjithshëm mbi shtegun dhe përshkrimin e rrugëkalimit.

3. Informacioni i përgjithshëm rreth shtegut përmban detaje të rëndësishme, për të ndihmuar personin që dëshiron të vizitojë shtegun të marrë vendimin për të kaluar apo jo në të, si dhe për ta ndihmuar këtë të fundit të planifikojë udhëtimin. Informacioni i përgjithshëm përmban:

a) përshkrimin e përgjithshëm të shtegut, i cili jep një panoramë për karakterin, pjesët më interesante dhe specifikat e shtegut (rreth pesë fjali). Përshkrimi i përgjithshëm duhet të formulohet në mënyrë të tillë që të përdoret edhe për qëllime marketingu;

b) sugjerime (fakultative) për udhëtime të tjera në zona në afërsi të shtegut, si dhe vende ku përdoruesit mund të ndalen për piçe freskuese;

c) informacion për kufizimet e zbatueshme, si p.sh., detyrimi për të pasur pajisje *GPS*, detyrimi për t'u pajisur me leje për të pasur akses në zona të caktuara etj.

ç) informacionin rreth mbërritjes në shteg, si më poshtë:

i. informacionin për udhëtimin për të arritur në shteg, përfshirë llojin e kërkuar të makinës, p.sh. automjet fuoristradë 4x4, apo makinë normale;

ii. informacionin për parkimin (përshkrimi i vendit ku mund të parkohen makinat, nëse është e aplikueshme, përfshirë koordinatat);

iii. informacionin për mundësinë e përdorimit të transportit publik;

d) të dhënat kryesore të shtegut:

i. kategoria e shtegut;

ii. koha e ecjes në shteg për të dy drejtimet, si dhe për të dyja drejtimit të bashku;

iii. gjatësia e shtegut në kilometra;

iv. ngjitja në metra;

v. zbritja në metra;

vi. pika më e lartë e shtegut në metra;

vii. pika më e ulët në metra.

4. Përshkrimi i rrugëkalimit ka për qëllim të sigurojë një udhërrëfyes të qartë dhe të saktë për gjetjen e shtegut në terren. Autoriteti përgjegjës përshkruan sa më saktë shtegun, në mënyrë që të lejojë gjetjen e shtegut në terren edhe në mungesë të shenjave apo tabelave drejtuese.

5. Fillimi dhe përfundimi i përshkrimit të rrugëkalimit, duhet të fillojë dhe mbarojë, nëse është

e mundur, në një strukturë akomoduese ose në një vendndodhje që mund të arrihet me makinë.

6. Përshkrimi i rrugëkalimit përfshin, por nuk kufizohet vetëm te:

a) detajet përkatëse në rast të kryqëzimit të shtigjeve të ndryshme, si numrin e shtigjeve dhe destinacionin e tyre;

b) informacione për burimet e ujit dhe strukturat mbështetëse (facilitetet);

c) veçoritë topografike të pjesëve kryesore të shtegut (i pjerrët/i rrafshët, luginë/kreshtë);

ç) llojin e shtegut (p.sh. shteg i ngushtë që kalon përmes pyllit);

d) nëse është e aplikueshme, mjetet apo kafshët me të cilat lejohet të kalohet në shteg, apo pjesë të tij (p.sh. kuaj, biçikleta apo mjete motorike).

7. Informacioni i përgjithshëm për shtegun dhe përshkrimi i rrugëkalimit, publikohen në platformën e shtigjeve.

Neni 12

Platforma e shtigjeve

1. Për qëllimet e publikimit të informacionit mbi shtigjet dhe promovimit të turizmit të ecjes, ministria përgjegjëse për turizmin krijon një platformë online, të dedikuar për publikimin e informacionit mbi shtigjet në Shqipëri.

2. Platforma e shtigjeve duhet të ketë këto karakteristika kryesore:

a) të jetë një faqe uebi qendrore, e qasshme nga publiku i gjerë;

b) të jetë e optimizuar për përdorim nga vizitorët e shtigjeve, duke ofruar një përvojë të kënaqshme të shfletimit dhe kërkimit;

c) të ketë një sistem të optimizuar për përdoruesit si *Outdooractive*, ose të ngjashëm me të;

ç) të jetë e optimizuar për motorët e kërkimit dhe të mos prezantohet si një nënfaqe e një faqeje tjetër uebi, por si një faqe më vete me një *URL* të qartë dhe të vetëshpjegueshme;

d) të ketë një sistem të bazuar në harta, që lejon vizualizimin e shtigjeve në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme;

dh) të përfshijë gjurmën *GPS* të shtigjeve, përshkrimet e rrugëkalimeve dhe informacionet e përgjithshme rreth tyre;

e) të përmbajë informacion të përditësuar mbi devijime ose mbyllje të përkohshme, të shtigjeve;



ë) të ofrojë informacion të përgjithshëm rreth ecjes në shtigje në Shqipëri, duke përfshirë këshilla për kohën më të mirë për ecje, informacion për ndihmën e shpejtë në raste emergjencash etj.;

f) të jetë e disponueshme në gjuhën shqipe dhe angleze;

g) të ofrojë mundësinë e përdorimit përmes një aplikacioni për *smartphone*, duke lejuar përdoruesit të kenë qasje të lehtë dhe të përditësuar në informacionin për shtigjet përmes telefonit të tyre.

KREU IV SHTIGJET E REJA, NDËRHYRJET NË SHTIGJE DHE SINJALISTIKA

Neni 13

Parime mbi projektimin dhe hapjen e shtigjeve

1. Autoriteti përgjegjës sipas pikave 3, 4 dhe 5, të nenit 4, të kësaj rregulloreje, përpiket gjithmonë, të shfrytëzojë dhe integrojë rrugë ekzistuese që janë krijuar nga kalimi i këmbësorëve ose kafshëve, ose nga ndërhyrja e drejtpërdrejtë e njeriut, në rastet e projektimit të shtigjeve të reja ose segmenteve të reja në shtigjet ekzistuese.

2. Autoriteti përgjegjës projektton dhe hap një shteg apo segment krejtësisht të ri, vetëm nëse nuk ekzistojnë rrugë ekzistuese dhe diçka e tillë është e domosdoshme.

3. Projektimi dhe hapja e shtigjeve të reja, si dhe segmenteve të reja në shtigjet ekzistuese, bëhet në përputhje me rregullat dhe udhëzimet e përcaktuara në këtë krye.

Neni 14

Rregulla të përgjithshme mbi projektimin dhe zbatimin

1. Projektimi i shtigjeve të reja, si dhe ndërhyrjeve në shtigjet ekzistuese, paraprihet nga një vlerësim i hollësishëm i aspekteve të rëndësishme që lidhen me vizitorët dhe mjedisin. Në rast konflikti të konsideratave mbi këto aspekte, prioritet i jepet mjedisit.

2. Autoriteti përgjegjës sipas pikave 3, 4 dhe 5, të nenit 4, të kësaj rregulloreje, identifikon strukturat mbështetëse (facilitetet) dhe pikat e rëndësishme të shtegut si pikat e vrojtimit të peizazhit, zonat e

kalimit të rrjedhave ujore, zonat historike, pjesët lidhëse me shtigje të tjera, burimet ujore etj.

3. Autoriteti përgjegjës shënon strukturat mbështetëse (facilitetet) dhe pikat e rëndësishme të shtegut në harta topografike ose ortofoto dhe përcakton mënyrën se si do të lidhen këto të fundit, duke marrë parasysh faktorë, si: terreni, pjerrësia etj.

4. Autoriteti përgjegjës kontakton dhe konsultohet me ekspertë, grupet e interesit dhe institucionet kompetente për të mësuar nëse ekzistojnë specie të ndjeshme ose të rrezikuara, zona kulturore ose historike, pjesë toke të brishta ose pengesa të tjera potenciale për hapjen e një shtegu të ri apo për realizimin e një ndërhyrjeje në një shteg ekzistues.

5. Procesi i konsultimit me ekspertët dhe institucionet kompetente, duhet të përcaktojë nëse është e nevojshme, ndërmarrja e një vlerësimi të ndikimit në mjedis në zonat me rrezik të mundshëm.

6. Autoriteti përgjegjës kontakton institucionet kompetente, për të mësuar përkatësinë pronësore të parcelave të tokës që preken nga shtegu apo ndërhyrja e propozuar, si dhe përdorimin e lejuar të tokës.

7. Autoriteti përgjegjës kontakton pronarët e parcelave të tokës, për të marrë pëlqimin e tyre lidhur me:

a) hapjen e shtegut të ri apo realizimin e një ndërhyrjeje në shtegun ekzistues;

b) të drejtën e kalimit në parcelat e tokës në pronësi të tyre.

8. Autoriteti përgjegjës organizon një dëgjese publike me grupet e interesit, lidhur me projektin e propozuar për hapjen e një shtegu të ri apo për realizimin e një ndërhyrjeje në një shteg ekzistues. Dëgjesa publike mbahet në bashkinë/bashkitë ku kalon shtegu objekt i projektit të propozuar. Personave pjesëmarrës i jepet mundësi e arsyeshme për të shprehur mendimet e tyre lidhur me projektin e propozuar.

9. Shtegu apo ndërhyrja në shtegun ekzistues, veçanërisht ngritja/ndërtimi i strukturave mbështetëse (faciliteteve) dhe atyre aksesore, si dhe vendosja e sinjalistikës vertikale dhe horizontale, duhet të zhvillohet në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi, për:

a) ruajtjen e trashëgimisë kulturore;

b) zonat e mbrojtura;

c) planifikimin dhe zhvillimin e territorit;



ç) veprimtaritë ndërtimore, përfshirë, në mënyrë të veçantë, qëndrueshmërinë antisizmike, mbrojtjen kundër zjarrit, si dhe ruajtjen e sigurisë dhe higjienës shëndetësore;

d) vlerësimin e ndikimit në mjedis.

10. Shtegu duhet të ketë një kalim që është i kënaqshëm dhe relativisht i sigurt për vizitorin.

11. Shtegu apo ndërhyrja në shtegun ekzistues duhet të projektohet dhe realizohet duke minimizuar impaktin në burimet natyrore të zonës përreth.

12. Shtegu apo ndërhyrja në shtegun ekzistues duhet të projektohet duke pasur parasysh mundësitë edukative, kulturore dhe piktoreske të zonës.

13. Shtegu apo ndërhyrja në shtegun ekzistues duhet të projektohet dhe realizohet duke marrë në konsideratë nevojat dhe zakonet e banorëve të zonës që përdorin apo mund të përdorin shtegun.

14. Në rastin e projektimit të një shtegu të ri apo segmenti në një shteg ekzistues, autoriteti përgjegjës udhëhiqet, nga konsideratat e mëposhtme:

a) shtegu përdor një korridor tërheqës vizualisht që integron sa më shumë pamje piktoreske dhe pika interesi të mundshme;

b) shtegu ofron peizazhe dhe eksperiencë të ndryshme duke kaluar në një varietet karakteristikash gjeografike, vegjetative dhe kulturore;

c) shtegu përfshin kalime ekzistuese, nëse ato plotësojnë standardet themelore të një shtegu;

ç) shtegu ofron lidhje me shtigje të tjera, zona rekreative, parqe, zona kulturore etj.;

d) shtegu kërkon mirëmbajtje minimale dhe ofron varietet ekologjik;

dh) shtegu shmang pjesët më të zhvilluara të zonave rurale;

e) shtegu reflekton atmosferën dhe ndjesinë e zonës përmes të cilës kalon;

ë) shtegu ofron një standard cilësie të lartë pa mbi ndërtuar, si dhe një nivel bazik sigurie, pa mënjnauar totalisht rrezikun;

f) shtegu ofron pjesë të aksesueshme pa ndryshuar karakterin e shtegut;

g) shtegu ka struktura mbështetëse (facilitete) të nevojshme.

Neni 15

Toka

1. Në përcaktimin e vendndodhjes ku do të kalojë shtegu, i jepet përparësi kalimeve në terrene që kanë më shumë qëndrueshmëri.

2. Autoriteti përgjegjës sipas pikave 3, 4 dhe 5, të nenit 4, të kësaj rregulloreje, është i detyruar të identifikojë dhe zgjedhë terrenin më të qëndrueshëm për shtegun.

3. Zonat me terren të dobët duhet të shmangen, nëse diçka e tillë është e mundur. Në rast se shtegu kalon përmes zonave të tilla, duhet të përdoren struktura aksesore, si p.sh. rrugë me dërrasa, për të minimizuar ndikimin.

4. Shtegu duhet të projektohet dhe të ndërtohet me kujdes, për të parandaluar ndikimin negativ në mjedis. Kalimi në shteg nuk duhet të shkaktojë erozion të tokës, zgjerim të rrugës, prishje të florës ose të karakteristikave të tjera natyrore të zonës.

5. Autoriteti përgjegjës duhet të mbajë parasysh normat mjedisore, qëndrueshmërinë dhe nevojat për mirëmbajtje gjatë gjithë fazave të projektimit dhe hapjes së shtegut.

Neni 16

Ligatinat

Autoriteti përgjegjës sipas pikave 3, 4 dhe 5, të nenit 4, të kësaj rregulloreje, duhet të shmangë kalimin e shtegut, në ligatina, përveç rasteve kur kalimi në to është i pashmangshëm apo paraqet një interes të veçantë për shtegun. Në këto raste, kalimi në ligatina duhet të realizohet në pjesën më të ngushtë të tyre dhe me ndihmën e strukturave aksesore, që kanë ndikimin më të vogël në mjedis.

Neni 17

Terrenet e pjerrëta

1. Projektimi dhe hapja e shtigjeve, në shpatë kodrash apo malesh me terrene të pjerrëta, duhet të realizohet për aq sa është e mundur, përreth faqes së majave, duke fituar lartësi gradualisht me kthesa të gjëra në formë U-je.

2. Shtegu nuk duhet të shkojë asnjëherë drejt majës edhe në zona që kanë pjerrësi mesatare.

3. Kthesat në formë U-je duhet të ofrojnë kalimin më të lehtë dhe më tërheqës për vizitorët e shtegut, si në ngjitje dhe në zbritje, në mënyrë që



këta të fundit të mos kalojnë shkurt, duke shmangur kthesat.

4. Shpeshtësia dhe lartësia e kthesave nuk duhet të jetë e lartë, për të parandaluar kalimet shkurt mbi kthesat.

5. Kthesat në formë U-je duhet të jenë të sheshta. Autoriteti përgjegjës sipas pikave 3, 4 dhe 5, të nenit 4, të kësaj rregulloreje, mund të bëjë, aty ku konsiderohet e nevojshme, ndërtime shtesë me struktura aksesore për realizimin e këtij qëllimi.

6. Në raste kur pjerrësia është më e ulët se 20 (njëzet) për qind, kthesa duhet të punohet si çdo pjesë tjetër e rrugës duke ndjekur një kurbë të gjatë.

Neni 18

Degëzimet e shtigjeve

1. Gjatë fazës së projektimit të shtegut, autoriteti përgjegjës sipas pikave 3, 4 dhe 5, të nenit 4, të kësaj rregulloreje, vlerëson nëse është e nevojshme, të krijohen degëzime nga shtegu kryesor me qëllim të sigurimit të qasjes në zona me interes të veçantë, si dhe zona kampimi ose strehimi.

2. Shtegu kryesor duhet të projektohet në mënyrë të tillë, që të ketë një distancë të mjaftueshme nga zonat me interes të veçantë, si dhe zonat e kampimit ose strehimit. Me qëllim parandalimin e kalimeve të improvizuara, këto zona nuk duhet të jenë plotësisht të dukshme nga shtegu kryesor.

3. Në rastet e zonave që paraqesin atraksion vizual, shtegu kryesor duhet të projektohet në mënyrë të tillë që të sigurojë pamjen direkt nga shtegu kryesor, me qëllim uljen e numrit të vizitorëve që zgjedhin të ndjekin degëzimin.

4. Zonat e kampimit ose strehimit duhet të vendosen, nëse është e mundur, në një degëzim jashtë shikueshmërisë së shtegut kryesor.

5. Zona e kampimit ose strehimit në shtigjet me frekuentim të lartë, duhet të jetë në një distancë të paktën 60 (gjashtëdhjetë) metra larg shtegut kryesor, përveç rasteve kur terreni ose pronësia e parcelave të tokës ku kalon shtegu e kufizojnë këtë.

6. Në rastet e zonave me frekuentim të ulët, distanca mund të jetë më e shkurtër, por kjo duhet të përshtatet në varësi të kushteve specifike.

Neni 19

Sipërfaqja e ecjes

Me qëllim sigurimin e sipërfaqeve të përshtatshme të ecjes, autoriteti përgjegjës sipas

pikave 3, 4 dhe 5, të nenit 4, të kësaj rregulloreje merr masa, për të:

1. Niveluar, kur është e nevojshme, me shat ose vegël tjetër, sipërfaqen e pa niveluar të ecjes, për të shmangur rrezikun e dëmtimit në të ardhmen dhe mbajtur sipërfaqen e ecjes në gjendje të mirë e funksionale;

2. Shmangur gropat dhe pjerrësitë anësore, në mënyrë që uji të mos mblidhet në shteg;

3. Larguar depozitimet e baltës në sipërfaqen e ecjes dhe depozitimet e dheut në skajin e jashtëm të shtegut dhe shpërndarë ato në shteg me qëllim krijimin e sipërfaqes së parashikuar për drenazhim (pjerrësia e brendshme, e jashtme, me majë);

4. Mbushur dhe rrafshuar brazdat, gropat, kanalet dhe dëmtimet e tjera në sipërfaqen e ecjes;

5. Ruajtur ose kthyer shpatet e pasme në këndin e pushimit (pjesët e pjerrëta në zbritje do të mirëmbahen ose restaurohen në këndin fillestar).

6. Prerë sa më thellë që të jetë e mundur, rrënjët e lirshme që zgjaten mbi sipërfaqen e ecjes së shtegut dhe mbushur gropat që mbeten nga heqja e rrënjëve me dhera dhe gurë;

7. Mbushur hapësirat në hyrje dhe dalje të urave/rrugëve me dërrasa, me dhera ose zall, me qëllim që sipërfaqja e shtegut të jetë në një nivel me sipërfaqen e urës ose të rrugës me dërrasa.

Neni 20

Gjerësia dhe lartësia e shtegut

1. Standardi mesatar për gjerësinë e shtegut është 1,2 (një presje dy) metra dhe standardi mesatar për lartësinë e shtegut është 2,4 (dy presje katër) metra.

2. Si përjashtim ndaj pikës 1, të këtij neni, devijimet nga këto standarde lejohen, kur ndryshimi i gjerësisë dhe lartësisë është i nevojshëm, për:

a) qëllime estetike;

b) t'iu përshtatur karakteristikave të zonës, zakoneve dhe nevojave të banorëve; apo për

c) të reduktuar kostot e ndërtimit dhe mirëmbajtjes së shtegut.

3. E gjithë gjerësia e shtegut duhet të kositet, nëse është e mundur, kur shtegu kalon përmes fushave ose lëndinave.

4. Në zona të caktuara (sidomos afër rrugëve), gjerësia e shtegut duhet të ngushtohet aty ku është e mundur, për një distancë të shkurtër (8–30 metra), në mënyrë që të dekurajohet përdorimi i paautorizuar i mjeteve motorike, kuajve etj.



5. Shtigjet që kalojnë në zona të pyllëzuara duhet të pastrohen nga degët që pengojnë lëvizjen e vizitorëve.

6. Kur shtegu kalon në zona me reshje të mëdha bore dhe përdoret gjatë dimrit, lartësia e përcaktuar të pikën 1, të këtij neni, duhet të jetë më e lartë.

Neni 21

Pjerrësia dhe tabani i shtegut

1. Pjerrësia e shtegut duhet të jetë e moderuar, me qëllim sigurimin e një shtegu të qëndrueshëm dhe të mirë mbajtshëm, që mundëson gjithashtu ecje të kënaqshme për vizitorët.

2. Pjerrësia duhet të jetë, kur është e mundur në të gjithë terrenet, më pak se 7 (shtatë) për qind.

3. Në zona me terren të pjerrët, grada e pjerrësisë së shtegut duhet të jetë, kur është e mundur, më pak se 10 (dhjetë) për qind.

4. Në zona me terren ranor, grada e pjerrësisë së shtegut duhet të jetë më pak se 7 (shtatë) për qind.

5. Në zona të sheshta, shtegu duhet të ketë një pjerrësi minimale, për të ndihmuar me kullimin e ujërave.

6. Pjerrësia e shtegut duhet të luhatet butësisht për të ofruar drenazhim natyral dhe eliminuar kalime të gjata monotone në pjerrësi që janë të lodhshme për vizitorët.

7. Një pjerrësi më e madhe se pjerrësitë e përcaktuara në këtë nen, mund të lejohet, në segmente të caktuara, me kusht që segmenti të jetë më pak se 30 (tridhjetë) metra dhe të merren masa kundër erozionit.

8. Për segmente shumë të pjerrët mund të përdoren shkallë, por përdorimi i tyre duhet konsideruar si mundësi e fundit, pasi mund të pengojë kalimin për disa vizitorë.

9. Pjerrësia llogaritet në përqindje duke pjesëtuar distancën vertikale me distancën horizontale dhe shumëzuar rezultatin me 100 (njëqind).

10. Për përcaktimin e pjerrësisë së shtegut përdoren pajisje specifike për matjen e pjerrësisë si klinometri.

11. Për shtigjet që ndërtohen përgjatë një faqe mali ose kodre është e rëndësishme të kihet parasysh edhe pjerrësia horizontale.

12. Shtegu duhet të ketë një nivel të moderuar pjerrësie horizontale, me kusht që diçka e tillë mos e bëjë shtegun të mundimshëm në ecje dhe të mos

bëhet pengesë për individët me lëvizshmëri të kufizuar.

13. Gjatë hapjes dhe ndërtimit të shtegut, përdoret aty ku është e mundur, materiali natyral nga punët e bëra, nëse ky i fundit është i mjaftueshëm për sipërfaqen e ecjes. Materiali që përbëhet nga sasi të mëdha plehu ose toke të punuar mbahet veçmas, për të mbuluar më vonë, gropa të mundshme në sipërfaqen e ecjes.

14. Përdorimi i ashklave të drurit lejohet, në pjesë relativisht të sheshta dhe të thata të shtegut, për të niveluar një sipërfaqe të ashpër dhe për të penguar rritjen e barërave dhe amortizimin e sipërfaqes natyrale. Ashklat e drurit nuk duhet të përdoren në terrene të pjerrëta dhe terrene që kanë probleme me lagështinë.

Neni 22

Drenazhimi

1. Autoriteti përgjegjës sipas pikave 3, 4 dhe 5, të nenit 4, të kësaj rregulloreje, sigurohet që shtigjet të jene të drenazuara në mënyrë të përshtatshme, aty ku është e nevojshme, për t'i mbrojtur ato nga dëmet që sjell erozioni.

2. Synimi i veprimtarive drenazhuese është kontrollimi ose drejtimi i rrjedhës së ujit përmes, nën, përgjatë ose përqark shtegut.

Neni 23

Strukturat aksesore të shtegut

1. Strukturat aksesore përdoren kryesisht për të adresuar problematika lidhur me sigurinë e vizitorëve dhe mbrojtjen e mjedisit.

2. Strukturat aksesore duhet të ndërtohen me materiale të qëndrueshme që harmonizohen me mjedisin përreth, në mënyrë që të kenë jetëgjatësi dhe të ruajnë gjendjen më natyrale të mundshme, të zonës ku vendosen.

3. Për projektimin dhe vendosjen e strukturave aksesore autoriteti përgjegjës, sipas pikave 3, 4 dhe 5, të nenit 4, bazohet në rregullat dhe udhëzimet në shtojcën 2, që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 24

Sinjalistika

1. Sinjalistika që përdoret në shtigje përbëhet nga sinjalistika vertikale dhe sinjalistika horizontale.



2. Më qëllim garantimin e uniformitetit, parashikimet për sinjalistikën në shtigje në këtë rregullore, janë të detyrueshme për shtigjet e reja, si dhe duhet të zbatohen në shtigjet ekzistuese kur është i nevojshëm zëvendësimi i sinjalistikës që është shumë larg standardeve të vendosura në këtë rregullore.

3. Për vendosjen ose zëvendësimin e sinjalistikës në shtigje autoriteti përgjegjës, sipas pikave 3, 4 dhe 5, të nenit 4, bazohet në rregullat dhe udhëzimet në shtojcën 3, që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

KREU V INSPEKTIMI DHE MIRËMBAJTJA E SHTIGJEVE

Neni 25

Rregulla të përgjithshme për inspektimin dhe mirëmbajtjen e shtigjeve

1. Ky krye përcakton rregullat për inspektimin dhe mirëmbajtjen e shtigjeve, me qëllim garantimin e sigurisë, dukshmërisë, dhe cilësisë së përgjithshme të shtigjeve, si dhe minimizimin e ndikimit që kanë këto të fundit në mjedis.

2. Rregullat në këtë krye, janë të detyrueshme për të gjitha shtigjet, të reja dhe ekzistuese.

3. Inspektimi dhe mirëmbajtja e shtigjeve bëhet jo më pak se një herë në vit dhe kryesisht në periudha të tilla si në pranverë, sapo shtegu të jetë i lirë nga dëborat.

4. Përveç inspektimit dhe mirëmbajtjes së rregullt, inspektimi dhe mirëmbajtja e shtigjeve është e detyrueshme:

- a) pas stuhive të forta apo shirave të dendur;
- b) në mesin e verës, nëse shtegu ka pjesë me bar të lartë, apo shkurre dhe ferra të dendura; dhe
- c) në fund të verës, nëse shtegu kalon në lëndina të hapura apo moçale.

5. Autoriteti përgjegjës, sipas pikave 3, 4 dhe 5, të nenit 4, të kësaj rregulloreje, informon ose konsultohet, nëse është e nevojshme, me pronarët e parcelave të tokës ku kalon shtegu, për veprimtaritë përkatëse për inspektimin dhe mirëmbajtjen e shtegut.

Neni 26

Inspektimi i shtigjeve

1. Autoriteti përgjegjës sipas pikave 3, 4 dhe 5, të nenit 4, të kësaj rregulloreje, inspekton shtigjet që ka në përgjegjësi administrimi dhe përpilon një raport në të cilin dokumenton gjendjen e secilit shteg, si dhe masat e marra të mirëmbajtjes. Informacioni që mbledhet dhe masat e mirëmbajtjes përcaktohen në modelet tip të raporteve, në shtojcën 4, që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

2. Përpilimi i raporteve bëhet, nëse është e mundur, nëpërmjet përdorimit të teknologjisë.

Neni 27

Mirëmbajtja e shtigjeve

1. Mirëmbajtja e shtigjeve përfshin veprime parandaluese dhe korrigjuese nga autoriteti përgjegjës, sipas pikave 3, 4 dhe 5, të nenit 4, të kësaj rregulloreje.

2. detyrat e autoritetit përgjegjës, në kuadër të mirëmbajtjes së shtigjeve, përfshijnë, por nuk kufizohen në:

a) prerjen e bimësisë apo degëve të pemëve, duke respektuar parashikimet për gjerësinë dhe lartësinë e shtegut në nenin 20, të kësaj rregulloreje;

b) kositjen e sipërfaqes së ecjes për përdorim dhe shikueshmëri sa më të mirë;

c) mbajtjen e sipërfaqes së ecjes pa pengesa ose rreziqe, si pemë të rrëzuara, rrëshqitje dheu, gurë të lëvizshëm etj., duke i larguar ato dhe rikthyer shtegun në gjendjen e mëparshme;

ç) mbajtjen e sipërfaqes së ecjes në gjendje të mirë dhe mbushjen e brazdave, hullive ose gropave, duke respektuar parashikimet në nenin 19, të kësaj rregulloreje;

d) mbajtjen e shtegut në gjendje të mirë, duke rindërtuar zona më të ngritura (trase) për të lehtësuar drenazhimin, në përputhje me parashikimet në pikën 3, të shtojcës 2, të kësaj rregulloreje;

dh) pastrimin dhe mirëmbajtjen e strukturave të kullimit duke respektuar parashikimet në shtojcën 2, të kësaj rregulloreje;

e) vlerësimin e qëndrueshmërisë së të gjitha strukturave aksesore gjatë shtegut, si dhe kryerjen dhe regjistrimin e çdo riparimi të nevojshëm, duke respektuar parashikimet në shtojcën 2, të kësaj rregulloreje;



ë) zëvendësimin ose rifreskimin e shenjave, në përputhje me parashikimet në pikat 2 dhe 3, të seksionit II, të shtojcës 3, të kësaj rregulloreje;

f) zëvendësimin ose pikturimin e piketave të terrenit, në përputhje me parashikimet në pikën 4, të seksionit II, të shtojcës 3, të kësaj rregulloreje;

g) riparimin, riinstalimin ose zëvendësimin e tabelave dhe shtyllave, duke respektuar parashikimet në seksionit I, të shtojcës 3, të kësaj rregulloreje;

gj) krijimin dhe caktimin e përkohshëm të një devijimi ose mbyllje të shtegut, derisa shtegu të jetë sërish në gjendjen e duhur;

h) informimin e ministrisë përgjegjëse për turizmin për devijime ose mbyllje të përkohshme të shtigjeve.

Neni 28

Devijimet dhe mbylljet e shtegut

1. Në rastet kur shtegu ka pësuar dëmtime të rënda që nuk mund të riparohen në pak kohë ose është bërë i pakalueshëm për ndonjë arsye tjetër, autoriteti përgjegjës, sipas pikave 3, 4 dhe 5, të nenit 4, të kësaj rregulloreje, duhet të krijojë një devijim nëpërmjet një rruge alternative që mundëson ecjen dhe ka afërsisht të njëjtat karakteristika si pjesa e dëmtuar apo e pakalueshme e shtegut.

2. Kur krijimi i devijimit sipas pikës 1, të këtij neni është i pamundur, autoriteti përgjegjës mbyll shtegun dhe nuk lejon kalimin në të.

3. Në rastet e krijimit të devijimeve apo mbylljeve të përkohshme të shtigjeve, autoriteti përgjegjës ndërmer veprimet e mëposhtme:

a) njofton menjëherë ministrinë përgjegjëse për turizmin për devijimin ose mbylljen dhe nëse është e mundur, për kohën sa pritët të vazhdojë;

b) njofton menjëherë strukturat vendore përgjegjëse për informacionin turistik dhe nëse është e nevojshme, komunitetin e zonës;

c) vendos brenda 48 (dyzet e tetë) orëve njoftime për devijimin ose mbylljen dhe nëse është e mundur, për kohën sa pritët të vazhdojë. Njoftimet vendosen në pikën e nisjes së shtegut dhe në kryqëzimin e fundit të shtegut, përpara sektorit të dëmtuar apo të pakalueshëm të tij; dhe

ç) vendos tabela udhëzuese dhe shënon devijimin në hartë dhe në gjurmën *GPS*, përfshirë sektorin e mbyllur të rrugës, në rast të devijimeve të përkohshme që parashikohen të përdoren më shumë se 2 (dy) muaj. Informacioni i përditësuar i

gjurmës *GPS*, së bashku me përshkrimin e përditësuar të rrugëkalimit, i dërgohen ministrisë përgjegjëse për turizmin.

4. Në ushtrim të detyrave të saj në funksion të publikimit të informacionit në platformën e shtigjeve, ministria përgjegjëse për turizmin:

a) njofton, përmes një shënimi, për devijimin ose mbylljen dhe nëse është e mundur, për kohën sa pritët të vazhdojë; dhe

b) përditëson informacionin mbi përshkrimin e rrugëkalimit dhe gjurmën *GPS* të shtegut, në rast të devijimeve të përkohshme, që parashikohen të përdoren më shumë se 2 (dy) muaj.

5. Kur devijimi ose mbyllja të mos jenë më të nevojshme dhe rrugëkalimi original i shtegut të jetë bërë sërish i kalueshëm dhe i përdorshëm, në përputhje me standardet e vendosura në këtë rregullore, autoriteti përgjegjës, sipas pikave 3, 4 dhe 5, të nenit 4, të kësaj rregulloreje, merr masa për të:

a) hequr njoftimet dhe tabelat e përkohshme udhëzuese të vendosura në terren;

b) njoftuar strukturat vendore përgjegjëse për informacionin turistik dhe nëse është e nevojshme, komunitetin e zonës;

c) njoftuar ministrinë përgjegjëse për turizmin dhe kërkuar heqjen e shënimeve dhe përditësimeve të vendosura në platformën e shtigjeve.

6. Në rastet kur shtegu ka pësuar dëmtime të rënda, të cilat nuk mund të riparohen duke e bërë shtegun e pakalueshëm, autoriteti përgjegjës, sipas pikave 3, 4 dhe 5, të nenit 4, të kësaj rregulloreje, njofton ministrinë përgjegjëse për turizmin dhe i propozon asaj mbylljen për një periudhë të pacaktuar të shtegut dhe nëse është e nevojshme, çregjistrimin e tij nga Regjistri Kombëtar i Shtigjeve.

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 29

Rregullat e sjelljes së vizitorëve të shtigjeve

1. Rregullat bazë të sjelljes, që duhen zbatuar nga gjithë vizitorët e shtigjeve kanë për qëllim mbrojtjen e parqeve dhe mjediseve të tjera natyrore, garantimin e sigurisë së vizitorëve, por edhe qëndrueshmërisë dhe jetëgjatësisë së shtigjeve dhe strukturave të tyre aksesore.

2. Në përputhje me parimet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, vizitorët duhet të:



a) planifikojnë paraprakisht dhe të përgatiten për udhëtimin;

b) udhëtojnë dhe ngrenë kamping në vendet e caktuara;

c) hedhin mbeturinat në vendet e përcaktuara dhe nëse nuk ka të tilla, t'i marrin me vete;

ç) lënë gjithçka siç e gjejnë;

d) reduktojnë sa më shumë ndikimin e zjarreve;

dh) respektojnë mjedisin, kafshët dhe bimët;

e) respektojnë vizitorët e tjerë;

ë) veshin këpucë dhe veshje të përshtatshme për kushtet e shtegut;

f) marrin me vete mjaftueshëm ujë dhe ushqime;

g) mos largohen nga shtegu dhe shijojnë tingujt e natyrës pa bërë zhurmë;

gj) sigurohen që të kenë kohë të mjaftueshme për ta përfunduar ecjen para muzgut;

h) informojnë gjithmonë dikë për planet e tyre; dhe

i) sigurohen që telefoni i tyre të ketë sinjal dhe mjaftueshëm bateri.

2. Në varësi të situatës e problemeve specifike të secilës zonë, autoriteti përgjegjës sipas pikave 3, 4 dhe 5, të nenit 4, të kësaj rregulloreje, mund të vendosë edhe rregulla të tjera, të cilat adresojnë shqetësime apo situata të veçanta në zonën përkatëse.

3. Autoriteti përgjegjës, vendos tabela mbi rregullat e sjelljes, në përputhje me përcaktimet e pikës 5, të seksionit I, të shtojcës 3, të kësaj rregulloreje, me qëllim informimin dhe edukimin e vizitorëve mbi rregullat e sjelljes gjatë ecjes nëpër shtigje dhe shmangien e veprimeve të padëshiruara.

Neni 30

Trajnimi dhe certifikimi i shtegmbajtësve

1. Personat përgjegjës për përmbushjen e detyrave që kanë të bëjnë me punët e terrenit, në pikën 3, të nenit 4, të kësaj rregulloreje, duhet të kenë përfunduar një kurs të detyrueshëm trajnimi dhe të jenë certifikuar, në përputhje me përcaktimet e këtij neni.

2. Trajnimi dhe certifikimi për shtegmbajtësit e shtigjeve kryhet nga Federata Shqiptare e Alpinizmit dhe Turizmit Malor, si dhe nga subjekte të tjerë, të licencuar nga institucionet kompetente.

3. Federata Shqiptare e Alpinizmit dhe Turizmit Malor dhe secili subjekt i licencuar për trajnimin dhe certifikimin e shtegmbajtësve janë përgjegjës për

bashkërendimin dhe mbarëvajtjen e procesit të trajnimit dhe certifikimit.

4. Programi i trajnimit dhe certifikimit miratohet nga Federata Shqiptare e Alpinizmit dhe Turizmit Malor bazuar në standardet ndërkombëtare dhe evropiane të Alpinizmit (UIAA dhe EUMA).

5. Programi i trajnimit dhe certifikimit përfshin:

a) objektivat e trajnimit;

b) përmbajtjen e strukturuar dhe të organizuar të trajnimit, që trajton dhe mbulon ndër të tjera, parashikimet e kësaj rregulloreje;

c) metodat e trajnimit;

ç) materialet që do të përdoren gjatë trajnimit; dhe

d) mënyrën e vlerësimit dhe certifikimit të kandidatëve.

Neni 31

Propozimi për kryerjen e punëve

1. Një person fizik ose juridik privat, me përvojë në turizmin e shtigjeve të ecjes, mund t'i propozojë autoritetit përgjegjës, sipas pikave 3, 4 dhe 5, të nenit 4, të kësaj rregulloreje, kryerjen pa shpërblim, të një apo më shumë prej punëve të mëposhtme:

a) regjistrimin digjital të një shtegu të ri apo ekzistues;

b) përcaktimin e kohës së ecjes në një shteg të ri apo ekzistues;

c) klasifikimin e një shtegu të ri apo ekzistues;

ç) përpilimin e informacionit për një shteg të ri apo ekzistues;

d) projektimin dhe hapjen e një shtegu të ri;

dh) projektimin dhe realizmin e një ndërhyrjeje në një shteg ekzistues;

e) vendosjen dhe zëvendësimin e strukturave aksesore në një shteg të ri apo ekzistues;

ë) vendosjen dhe zëvendësimin e sinjalistikës, në një shteg të ri apo ekzistues;

f) inspektimin dhe mirëmbajtjen e shtegut për një periudhë kohe të caktuar;

g) përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm, për regjistrimin e një shtegu të ri apo ekzistues dhe informacionit për të, në Regjistrin Kombëtar të Shtigjeve, si dhe dokumentacionit të nevojshëm për përditësimin e informacionit mbi një shteg të regjistruar.

2. Propozimit i bashkëngjitet dokumentacioni i mëposhtëm:



a) dokumentacioni i nevojshëm për identifikimin e propozuesit;

b) propozimi i detajuar mbi punën/t që propozohen të kryhen nga propozuesi, së bashku me kohën e propozuar për kryerjen e tyre;

c) një vlerësim i hollësishëm i të gjithë konsideratave dhe aspekteve të përcaktuara në kreun IV, të projekt rregullores, nëse propozimi ka për qëllim, projektimin dhe realizmin e një shtegu të ri apo një ndërhyrjeje në një shteg ekzistues;

ç) dokumentacioni përmes të cilit dëshmohet se propozuesi zotëron njohuritë, kualifikimet, kapacitetet dhe përvojën e nevojshme për zbatimin e propozimit, brenda afateve kohore të propozuara; dhe

d) nëse është e aplikueshme, dokumentacionin përmes së cilit dëshmohet se propozuesi ka siguruar apo disponon, mjetet e nevojshme financiare, për zbatimin në kohë të propozimit.

3. Autoriteti përgjegjës, sipas pikave 3, 4 dhe 5, të nenit 4, të kësaj rregulloreje, shqyrton propozimin dhe dokumentacionin e paraqitur, brenda 30

(tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të propozimit dhe dokumentacionit bashkëngjitur tij.

4. Në rast të konstatimit të mangësive në dokumentacionin e paraqitur, autoriteti përgjegjës njofton propozuesin, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të propozimit, për plotësimin e dokumentacionit.

5. Afati i parashikuar në pikën 3, të këtij neni, mund të shtyhet në mënyrë të arsyetuar, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike.

6. Në përfundim të procesit të shqyrtimit, autoriteti përgjegjës merr vendim për miratimin ose jo të propozimit.

7. Në rast të miratimit të propozimit, propozuesi është i detyruar të kryejë punën/t e propozuar/a, në përputhje me parashikimet e kësaj rregulloreje dhe marrëveshjes së lidhur me autoritetin përgjegjës.

8. Zbatimi i propozimit mbikëqyret nga autoriteti përgjegjës, sipas parashikimeve të marrëveshjes, që përcakton të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella midis këtij të fundit dhe propozuesit.

SHTOJCA 1

KODET E BASHKIVE NË FUNKSION TË NUMËRTIMIT TË SHTIGJEVE

Bashkia	Kodi i Bashkisë	Bashkia	Kodi i Bashkisë	Bashkia	Kodi i Bashkisë
Belsh	1	Këlcyrë	22	Përmet	43
Berat	2	Klos	23	Përrenjas	44
Bulqizë	3	Kolonjë	24	Pogradec	45
Cërrik	4	Konispol	25	Poliçan	46
Delvinë	5	Korçë	26	Pukë	47
Devoll	6	Krujë	27	Pustec	48
Dibër	7	Kuçovë	28	Roskovec	49
Dimal	8	Kukës	29	Rrogozhinë	50
Divjakë	9	Kurbin	30	Sarandë	51
Dropull	10	Lezhë	31	Selenicë	52
Durrës	11	Libohovë	32	Skrapar	53
Elbasan	12	Librazhd	33	Shijak	54
Fier	13	Lushnjë	34	Shkodër	55
Finiq	14	Malësi e Madhe	35	Tepelenë	56
Fushë-Arrëz	15	Maliq	36	Tiranë	57
Gramsh	16	Mallakastër	37	Tropojë	58
Gjirokastrë	17	Mat	38	Vau i Dejës	59
Has	18	Memaliaj	39	Vlorë	60
Himarë	19	Mirditë	40	Vorë	61
Kamzë	20	Patos	41		
Kavajë	21	Peqin	42		



SHTOJCA 2

RREGULLA DHE UDHËZIME MBI
PROJEKTIMIN DHE VENDOSJEN E
STRUKTURAVE AKSESORE NË SHTIGJE**1. Rugët me dërrasa**

a) Rugët me dërrasa përdoren në ato raste kur përdorimi i disa dërrasave, për të kaluar një sipërfaqe të mbuluar me ujë është i pamjaftueshëm.

b) Rugët me dërrasa përdoren zakonisht për të kaluar mbi një kënetë të thellë ose mbi një sipërfaqe ujore që ka pak luhajtje në nivel dhe rrjedhë.

c) Dërrasat vendosen pingul me drejtimin e rrugës dhe e gjithë struktura mbështetet nga shtylla të ankoruara në fundin e sipërfaqes ujore.

ç) Rugët me dërrasa mund të vendosen në lartësinë 60 (gjashtëdhjetë) deri 90 (nëntëdhjetë) centimetra mbi ujë, si një dok i zgjatur.

d) Rugët me dërrasa ndërtohen me material të përpunuar. Nëse rruga me dërrasa kalon mbi sipërfaqe me luhajtje të nivelit të ujit, atëherë shtyllat mbështetëse duhet të futen thellë në nënshtresë ose të ankorohen në beton për të evituar që rruga me dërrasa të ngrihet ose të deformohet.

dh) Rugët me dërrasa duhet të kenë struktura mbajtëse anësore për të ulur rrezikun e rënies në ujë.

e) Gjerësia e rrugës me dërrasa duhet të jetë të paktën 70 (shtatëdhjetë) centimetra, ndërsa vendosja e parmakut është fakultative.

2. Urat

a) Urat janë struktura për kalimin e rrjedhave ujore sezonale ose të përhershme, e luginave ose grykave të thata dhe pengesave të tjera, në një mënyrë të sigurt dhe ekologjike.

b) Vendosja e urave duhet të paraprihet nga një analizë e kujdesshme mbi aspekte që kanë të bëjnë kryesisht me kostot e ndërtimit dhe mirëmbajtjen e tyre, aspektet mjedisore, si dhe sigurinë e vizitorëve të shtegut. Mundësitë duhet të studiohen me imtësi. Në disa raste zhvendosja e shtegut mund të jetë më e sigurt dhe më pak e kushtueshme sesa ndërtimi i një ure.

c) Siguria për vizitorët dhe aspektet mjedisore janë arsyt kryesore për ndërtimin e një ure dhe konsiderata bazë që udhëheqin projektimin e saj.

ç) Ura duhet të ofrojë një ecje më të lehtë për një vizitor të ngarkuar.

d) Hapësira poshtë urës duhet të lejojë kalimin e ujit në plotën maksimale, duke u vendosur në lartësinë më të madhe të mundshme mbi nivelin e ujit.

dh) Nëse është e mundur, fundet e urës ankorohen në një grykë të ngushtë me brigje të lartë, për të eliminuar nevojën për të ndërtuar struktura të tjera.

e) Volumi i plotës dhe lartësisë së nevojshme për urën matet me përafërsi, duke vërtetuar dhe analizuar me kujdes sipërfaqen ujore dhe ambientin përreth.

ë) Për ndërtimin e urave duhen përdorur materiale cilësore dhe mjeshtëri e lartë gjatë ndërtimit.

f) Për projektimin e urave mund të përdoren modele të ndryshme, si: ura e thjeshtë (me trarë të latuar), ura me një hark, ura me shumë harqe, ura e varur, si dhe ura të tjera me dizajne të tjera më të komplikuar.

g) Lartësia dhe gjatësia e urës, si dhe mjedisi përreth, përcaktojnë llojin e urës që do ndërtohet, si dhe materialet që do të përdoren.

gj) Kur gjatësia e kalimit është më pak se 3 (tre) metra dhe ura nuk është subjekt përmbytjeje, një ose disa trarë të latuar mund të mjaftojnë. Në rast se gjatësia e kalimit është më shumë se 3 (tre) metra mund të vendoset një urë me një hark, që zakonisht kërkon ndërtimin e themeleve mbështetëse në çdo anë të urës, 2 (dy) deri në 3 (tre) binarë mbështetës druri të latuar ose laminuar, mbulesë etj. Në varësi të situatës mund të nevojitet të vendoset një parmak.

h) Në zona ku gjatësia e kalimit është tepër e gjatë, mund të nevojitet një urë me disa harqe, me një strukturë ndihmëse në mes të rrjedhës së ujit ose një urë e varur.

i) Ura nuk duhet të pengojë kalimin për shkak të ngushtësisë së saj. Gjerësia e urës duhet të jetë e tillë që të lejojë akses minimal, edhe në segmente që nuk janë projektuar për të qenë të kalueshëm nga kushdo.

j) Parmaku vendoset në ato raste kur konsiderohet i nevojshëm për sigurinë dhe rehatinë e vizitorëve. Vendimi nëse parmaku është i nevojshëm, si dhe nëse duhen vendosur 1 (një) ose 2 (dy) parmakë, merret pasi bëhet një analizë e kujdesshme e faktorëve, si: thellësia dhe shpejtësia e rrjedhës së ujit, lartësia mbi tokë ose ujë, gjatësia dhe gjerësia e urës, niveli i dëshiruar i eksperiencës, mundësia për rrëshqitje ose rënie, si dhe faktorët atmosferikë, si: akulli, bora, ngrica dhe shiu.

k) Kur parmaku është i nevojshëm, lartësia normale që ofron një nivel sigurie të pranueshëm për vizitorin është 1,05 (një presje zero pesë) metra nga sipërfaqja e ecjes.



l) Urat duhet të projektohen për të ofruar siguri për vizitorin, për të përballuar peshën e borës, përmbytjet etj. Për disa lloje urash projektimi nga arkitektë/inxhinierë është i detyrueshëm.

ll) Urat duhet të projektohen që të përballojnë një ngarkesë që plotëson ose tejkalon standardet aktuale të menaxhimit për dizajnet arkitekturore dhe strukturat inxhinierike për këmbësorët. Arkitektët dhe inxhinierët duhet të analizojnë elementet e dizajnit të propozuar (madhësia, fortësia, ngarkesa e borës, rrjedha maksimale për harkun etj.) dhe t'i përcaktojnë ato përpara ndërtimit të urës.

n) Autoriteti përgjegjës duhet të kërkojë që një inxhinier të zhvillojë ose rishikojë të gjitha planet e urave. Hapësira mbi ujëra të lundrueshme është zakonisht 1,5 (një presje pesë) metra mbi sipërfaqen e ujit;

nj) Urat duhet të mirëmbahen në mënyre periodike, për të siguruar qëndrueshmëri dhe parrezikshmëri. Strukturat e urës duhet pastruar dhe inspektuar për kalbje, bulonat duhen shikuar dhe shtrënguar etj.

o) Urat duhen kontrolluar me kujdes nga përfaqësuesit e autoritetit përgjegjës dhe të gjitha urat e mëdha (>7.5 m e gjatë dhe 1.5 m e lartë) duhen inspektuar nga persona të kualifikuar të paktën çdo 3 (tre) vjet. Kontrolli duhet të dokumentohet.

3. Trasetë

a) Trasetë përdoren kur ka mjaftueshëm gurë dhe zhavorr dhe shtegu mund të ngrihet mbi zona me drenazh të dobët. Përdorimi i traseve përforcon kalimin dhe është një teknikë e efektshme kur rruga nuk ka kullim të mirë.

b) Trasetë ndërtohen shpesh duke përcaktuar në fillim gjerësinë e shtegut me rreshta paralele gurësh ose dërrasash që shërbejnë për të mbajtur mbushjen.

c) Procesi i mbushjes duhet të fillojë me gurë mesatarë, që lejojnë kalimin e ujit poshtë rrugës. Mbushja vazhdon me gurë të vegjël, zhavorr ose një kombinim materialesh për të krijuar ngritjen dhe një sipërfaqe të sheshtë ecje.

ç) Shtresa e sipërme duhet të arrijë një lartësi 5 (pesë) centimetra mbi ngritjen e gurëve dhe dërrasave, për të siguruar kullim të mirë dhe për të lejuar stabilizimin.

d) Në secilën anë të kalimit mund të ndërtohet edhe një kanal për të përmirësuar kullimin. Materiali i gërmuar nga kanalet mund të përdoret për të mbushur sipërfaqen e trasesë.

4. Kanalet kulluese transversale

a) Kanalet kulluese transversale krijohen kur një pjesë e shkurtër e shtegut ndërtohet me një pjerrësi të kundërt nga pjerrësia e mëparshme. Përdorimi i tyre nuk prish estetikën e peizazhit, ka kosto të pranueshme për mirëmbajtjen dhe kontrollin e erozionit, si dhe prish monotoninë e zbritjeve ose ngjitjeve të gjata.

b) Kanalet kulluese transversale janë më të përshtatshme për segmente në faqe kodrinore ose malore.

c) Kanalet kulluese transversale janë më të efektshme kur ndërtohen që në fillim, së bashku me shtegun.

ç) Kanalet kulluese transversale mund të përdoren për të adresuar problemet në pjesë të vogla problematike, nëse terreni e lejon ndërtimin e tyre.

d) Kanalet kulluese transversale duhet të vendosen në terren, pa rënë shumë në sy. Shpeshtësia e tyre duhet të variojë, për të bërë ecjen më interesante.

5. Tombinot

a) Tombinot përdoren për kalimin e rrjedhave të ujit poshtë shtegut.

b) Tombinot janë një alternativë shumë e mirë, në krahasim me urat, për të lejuar kalimin e ujit nga rrëke ose burime të vogla dhe të përhershme ujore.

c) Tombinot janë më të efektshme në zona kullimi natyrale ku nevojitet germim minimal.

ç) Tombinot mund të përdoren dhe në zona të sheshta për kullim të kryqëzuar poshtë traseve me kanale anësore, për të reduktuar efektin e tyre.

d) Tombinot mund të kenë kosto më të ulëta ndërtimi dhe mirëmbajtje se një urë, janë më pak imponuese, si dhe në shumicën e rasteve janë më të thjeshta për t'u ndërtuar.

dh) Materialet që mund të përdoren për ndërtimin e tombinove janë guri, druri, plastika, metali i valëzuar ose materiale të tjera të përshtatshme. Me rritjen e madhësisë së rrymave, duhet kërkuar ndihmë nga ekspertë për të siguruar që nënkalimi është i mjaftueshëm për rrjedha maksimale.

e) Tombinot duhen instaluar me një pjerrësi të lehtë drejt rrymës rreth 2 (dy) për qind dhe duhen shtruar siç duhet për të siguruar rendiment të vazhdueshëm.

ë) Nëse për tombinot përdoren tuba plastike apo metali, ata duhet të mbulohen, nëse është e mundur, me një minimum prej 15 (pesëmbëdhjetë) centimetrash dheu (pa gurë të mprehtë).

f) Diametri tubave që përdoren mund të variojë, por rekomandohet të jetë jo më pak se 30 (tridhjetë) centimetra, për të eliminuar probleme të shpeshta bllokimi.




Figura 0.1. Pamja anësore e tombinos



Figura 0.2. Pamja e tërthortë e tombinos

6. Kalimi me dërrasa

a) Kalimi me dërrasa përdoret për të kaluar disa lloje pellgësh, moçalesh të cekët, ose ligatinash të pyllëzuara.

b) Për kalimin me dërrasa përdoren dërrasa të trajtuara apo lëndë drusore e marrë nga zona.

c) Kalimi me dërrasa duhet të ofrojë një sipërfaqe të fortë dhe jetëgjatë.

ç) Në pjesën e ecjes, dërrasat duhet të jenë paralele me drejtimin e shtegut dhe dërrasat mbështetëse të tyre të vendosen drejt e në tokë.

d) Kalimi me dërrasa varion nga 3 (tre) metra deri në 30 (tridhjetë) metra gjatësi.

dh) Materiali i përdorur për kalimin me dërrasa mund të jetë i përpunuar ose natyral, ose një kombinim mes tyre.

e) Dërrasat mbështetëse rekomandohen të jenë prej druri natyral të qëndrueshëm, ndërsa sipërfaqja e ecjes rekomandohet të përbëhet nga dërrasa të mëdha të trajtuara që janë rezistente ndaj kalbjes.

ë) Përcaktimi i materialit drusor varet nga disa faktorë, si: distanca nga vendi ku mund të merret materiali, mundësia për të transportuar materiale në zonë, disponueshmëria e materialeve natyrale, aftësitë e nevojshme për të latuar drurin, koha e dëshiruar mes zëvendësimeve etj.

f) Pas zgjedhjes së vend-kalimit dhe pastrimit të shtegut, hapi i parë është vendosja e dërrasave mbështetëse. Dërrasat mbështetëse vendosen drejt e mbi tokën e lagësht dhe variojnë në gjatësi nga 1 (një) metër deri në 2 (dy) metra, sipas nivelit të mbështetjes që ofron vetë zona.

g) Dërrasat e ecjes vendosen mbi dërrasat

mbështetëse dhe fiksohen me gozhda të mëdha. Nëse përdoret dru natyral, duhet bërë një dhëmbëzim ose montim që të mos lëvizin.

gj) Kalimet me dërrasa ndërtohen në segmente prej 2,4 (dy presje katër) metrash deri në 3 (tre) metra dhe vendosen njëri pas tjetrit me një distancë jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) centimetra nga fundi i një segmenti dhe fillimi i një segmenti tjetër. Kur përdoren dërrasa të përpunuara, fundi i tyre qëndron mbi dërrasën mbështetëse, shpesh pa hapësira midis segmenteve. Në disa raste, mund të duhet një dërrasë mbështetëse në mes, nëse dërrasat përkulen më shumë.

h) Shtegu nga të dy anët e kalimit me dërrasa duhet të jetë i qëndrueshëm dhe i thatë, përndryshe, pika e zbritjes mund të bëhet e butë dhe me baltë dhe mund të kërkojë ndërtimin e një strukture të re.

i) Në disa raste, mund të jetë e nevojshme të vendosen pllaka prej guri në pikat e zbritjes, për të ndihmuar tokën të përballojë impaktin e vizitorëve.

j) Kalimi me dërrasa nuk duhet të përdoret në zonat me rrezik përmytje. Në këto zona, duhet të konsiderohet zhvendosja e shtegut ose përdorimi i një rruge me dërrasa.




Figura 0.3. Kalim me dërrasa

7. Muret mbajtës

a) Muret mbajtës janë struktura prej guri ose druri, të projektuara për të stabilizuar shpatet anësore të shtegut.

b) Muret mbajtës përdoren për të ndaluar rrëshqitjen e dheut kur shtegu kalon në shpate kodrinore me pjerrësi më të madhe se 40 (dyzet) për qind ose 50 (pesëdhjetë) për qind.

c) Për ndërtimin e mureve mbajtës përdoren gurë të qëndrueshëm, të fortë dhe jo të rrumbullakët, për shkak të jetëgjatësisë dhe aftësisë bllokuese. Nëse nuk mund të përdoret guri, këshillohet të përdoret dru i përpunuar që i reziston kalbjes.

ç) Themeli i murit mbajtës duhet të vendoset mbi tokë ose gurë të qëndrueshëm, për të siguruar një mur të sigurt dhe të fortë.

d) Trashësia e murit mbajtës duhet të jetë të paktën sa gjysma e lartësisë së murit ose minimumi 60 (gjashtë dhjetë) centimetra, nëse lartësia e murit është më pak se 150 (njëqind e pesëdhjetë) centimetra.

dh) Pjesa e jashtme e murit mbajtës duhet të ketë një pjerrësi për nga brenda prej të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) për qind deri në 25 (njëzet e pesë) për qind.

e) Përreth, nën ose përmes murit nevojitet drenazhim që uji të mos mblidhet mbrapa tij dhe të krijojë presion që mund të shkatërrojë vetë murin.



Figura 0.4. Mur mbajtës

8. Pllakat prej guri

a) Pllakat prej guri përdoren për të forcuar kalimin përmes zonave të shkurtra të lagështa ose gropave prej balte. Pllakat prej guri përdoren zakonisht për kalimin e rrjedhjeve të vogla ujore që kanë nevojë vetëm për disa pllaka.

b) Pllakat prej guri mund të përdoren vetëm ku toka është e qëndrueshme dhe e parrezikuar nga erozioni.

c) Pllaka prej guri duhet të jenë, nëse është e mundur, të mëdha e të sheshta dhe të vendosen mirë në tokë që të jenë të qëndrueshme e mos shkaktojnë humbjen e ekuilibrit të vizitorëve.

ç) Pllakat prej guri nuk duhet të përdoren në rrjedha të lundrueshme, ose të populluara me peshq, pasi mund të krijojnë një barrierë artificiale për rrjedhën e ujit ose mund të modifikojnë habitatin e peshqve.

d) Pllakat prej guri nuk duhet të përdoren nëse krijojnë një pengesë aksesit apo bëhen të rrëshqitshme nga uji dhe myshku, duke paraqitur rrezik rënie për vizitorët. Në këto raste, përdorimi i pllakave të gurit duhet të shmanget, ose duhet të konsiderohet vetëm si një zgjidhje e përkohshme derisa të ndërtohet një urë.

9. Mbikalimet

a) Mbikalimet janë struktura aksesore që përdoren për të kaluar një gardh.

b) Vendosja e mbikalimeve lehtëson kalimin e vizitorëve dhe minimizon dëmin ndaj gardhit.

c) Nëse gardhi duhet të vendoset në parcela në pronësi private, pronari i parcelës së tokës duhet të konsultohet.



Figura 0.5. Mbikalim

10. Shkallët

a) Shkallët ose shkallaret e mëdha (një seri e lidhur platformash) duhet të shmangen dhe mund të përdoren vetëm kur janë alternativa e vetme e përshtatshme për kalimin nga një pikë në pikën tjetër të shtegut.

b) Shkallët mund të përdoren vetëm në raste ku zona ka barriera topografike të pashmangshme, kur një skarpatë shumë e pjerrët ndan dy kalime me pjerrësi të moderuar, ose ndarja e pronësisë së parcelave të tokës kufizon vendin për ndërtimin e shtegut, duke detyruar kalimin e një kodre me një pjerrësi shumë më të lartë se ajo e pranueshme.

11. Ujëkullueset

a) Ujëkullueset janë struktura prej guri ose druri që përdoren për të devijuar ujin nga shtegu.

b) Në disa raste, ujëkullueset mund të jenë zgjidhja e vetme për të devijuar ujin.

c) Në rastet kur pritet që uji të rrjedhë përgjatë shtegut, ujëkullueset duhet të instalohen menjëherë dhe të mos pritet derisa të ndodhë erozioni.

ç) Distanca mes ujëkullueseve duhet të jetë e tillë që të mbajë në minimum shpejtësinë dhe sasinë e ujit që rrjedh përgjatë shtegut.

d) Numri dhe hapësira mes ujëkullueseve varet nga sasia e ujit që kalon në shteg, nga pjerrësia e shtegut, mënyra e ndërtimit dhe disponueshmëria e vendeve për të devijuar ujin.

dh) Vendosja e ujëkullueseve diktohet nga terreni. Ujëkullueset vendosen në mënyrë të tillë që uji i devijuar të mos rikthehet në shteg. Nëse kjo nuk arrihet, pengesat nuk duhen të instalohen.

e) Nevoja për vendosjen e pengesave diktohet nga pjerrësia e shtegut dhe sasia e ujit që kalon në shteg. Pengesat vendosen poshtë çdo pike ku një sasi e madhe uji hyn në shteg. Në pjerrësi konstante, pengesat duhet të vendosen afër majës për të devijuar ujin përpara se të shkaktojë dëme, me pengesa të tjera pas saj për të minimizuar rrymën e ujit.

ë) Pasi vendi dhe hapësira e pengesave është caktuar, duhet ndërtuar një hendek përgjatë shtegut me një kënd prej 45 (dyzet e pesë) gradë.

f) Hendeku duhet të jetë i thellë të paktën sa gjysma e diametrit të pengesës prej druri ose të lartësisë së pengesës prej guri.

g) Pengesa duhet të jetë të paktën 10 (dhjetë) centimetra mbi nivelin e tokës nga ana në ngjitje, 30 (tridhjetë) centimetra në anën e faqes së malit/kodrës dhe 15 (pesëmbëdhjetë) centimetra më tej shpatit, në zbritje të shtegut.

gj) Pengesa duhet të fiksohet në vend duke përdorur teknika të ndryshme, p.sh., me hunj të gjetur në zonë që përdoren për të fiksuar në vend pengesën.

h) Nëse përdoren materiale natyrore për shufrat, një degë me diametër 5 (pesë) deri në 8 (tetë) centimetra duhet të pritët në pjesë prej 45 (dyzet e pesë) centimetrash të gjata. Shufrat futen në tokë në secilën anë të pengesës, me majat e tyre pjerrët ndaj pengesës për ta fiksuar në vend. Shufrat duhen të jenë të sheshta me pengesën dhe pjesa e tepërt duhet prerë për të parandaluar pengime në ecje ose lëvizjen e tyre nga goditjet.

i) Në pjesën e shtegut në ngjitje, rruga duhet të gërmohet e nivelohet për disa metra. E gjithë toka dhe gurët e gërmuar duhet të vendosen në pjesën e shtegut, poshtë ujëkullueses duke e niveluar me majën e saj.

j) Ujëkullueset i nënshtrohen intervaleve të rregullta të mirëmbajtjes. Dheu ose mbetjet e grumbulluara në ujëkullueset duhet të pastrohet të paktën çdo vit.




Figura 0.6. Ujëkulluese

SHTOJCA 3 RREGULLA DHE UDHËZIME MBI VENDOSJEN DHE ZËVENDËSIMIN E SINJALISTIKËS NË SHTIGJE

I. SINJALISTIKA VERTIKALE

1. Sinjalistika vertikale dhe llojet e saj

a) Sinjalistika vertikale nënkupton tërësinë e tabelave të fiksuara në tokë ose në sende ekzistuese të paluajtshme, me qëllim të ofrimit të informacionit për shtegun dhe rregullat e sjelljes që duhen zbatuar.

b) Sinjalistika vertikale përbëhet nga:

- tabelat me informacion të përgjithshëm;
- tabelat e shtigjeve tematike;
- tabelat e drejtimit;
- tabelat e vendndodhjeve;
- tabelat e rregullave të sjelljes; dhe
- tabelat e tjera.

2. Tabela me informacion të përgjithshëm (info boards)

a) Tabelat me informacion të përgjithshëm (info boards) përdoren për t'u ofruar vizitorëve informacion të nevojshëm, interesant dhe tërheqës, si, por pa u kufizuar tek, informacioni për hyrjen në shteg, informacioni për rregullat e sjelljes së vizitorëve apo informacioni për karakteristikat mjedisore, peizazhore, historike dhe kulturore të zonës ku kalon shtegu.

b) Tabelat me informacion të përgjithshëm vendosen në pikat kryesore të hyrjes së shtegut, si dhe në vende të tjera të përshtatshme, si p.sh., në zona parkimi afër shtegut ose vende pranë qendrave të vizitorëve. Vendndodhja e tabelave me informacion të përgjithshëm duhet të jetë gjithmonë e shënuar në hartë.

c) Materiali i përdorur për tabelat me informacion të përgjithshëm duhet të jetë alumin dhe trashësia e tij 0,5 (zero presje pesë) centimetra.

ç) Tabelat me informacion të përgjithshëm duhet të kenë formë drejtkëndore ose një formë tjetër që i përshkruan konceptin e shtegut.



d) Madhësia e tabelave me informacion të përgjithshëm përcaktohet duke u udhëhequr nga konsiderata që kanë lidhje me vendin ku vendosen tabelat dhe informacionin për shtigje të caktuara.

dh) Tabelat me informacion të përgjithshëm, përmbajnë së paku, informacionin e mëposhtëm:

i. hartën topografike të zonës për ecje në këmbë (shkalla 1:25,000 ose 1:50,000) që përfshin:

- emrin dhe numrin e shtegut/shtigjeve, përfshirë segmente të një shtegu me distancë të gjatë;

- pikat e shërbimit (të shënuara në hartë), strehat ose struktura të tjera mbështetëse (p.sh. qendra urgjencash apo ndihme të parë, vende me defibrilatorë etj.);

- legendën me shpjegime për shenjat dhe simbolet e përdorura në hartë;

ii. përshkrimin bazë të shtegut/shtigjeve (gjatësia, kategoria, koha e ecjes etj.);

iii. informacion tjetër shtesë të dobishëm për vizitorët (p.sh. për fshatrat apo vende të tjera të interesante që ndodhen afër apo përgjatë shtegut/shtigjeve);

iv. informacionin për shpëtimin në male;

v. përshkrimin dhe informacionin e përgjithshëm për karakteristikat e shtegut/shtigjeve (e zbatueshme vetëm për shtegun/shtigjet tematike);

vi. informacionin për rregullat që duhen zbatuar nga vizitorët.

2.1 Shtigjet tematike dhe tabelat për to

a) Me qëllim nxjerrjen në pah të karakteristikave të ndryshme të zonës, autoriteti përgjegjës sipas pikave 3, 4 dhe 5, të nenit 4, të kësaj rregulloreje, mund të krijojë shtigje me tema të veçanta për të shpjeguar mjedisin e zonës, për të informuar mbi lloje/specie të veçanta (bimë ose kafshë) ose për të përshkruar karakteristikat gjeologjike, historike ose kulturore të një zone të caktuar.

b) Autoriteti përgjegjës vendos tabela të përshtatshme me qëllim të ofrimit të informacionit për shtegun tematik.

c) Për tabelat e shtigjeve tematike nuk përdoret një model i standardizuar.

ç) Tabelat e shtigjeve tematike duhet të kenë një pamje tërheqëse që i përshtatet temës përkatëse.

3. Tabelat e drejtimit

a) Tabelat e drejtimit janë infrastruktura bazë për t'u orientuar lehtësisht në shteg. Tabelat e drejtimit tregojnë drejtimin për në destinacione, si dhe ofrojnë informacione të tjera për shtegun, si:

kategoria e tij, koha e ecjes në shteg, numri i shtegut etj.

b) Tabelat e drejtimit vendosen në pikat e fillimit të shtigjeve, në kryqëzime dhe pika të tjera të rëndësishme.

c) Materiali i tabelave të drejtimit duhet të jetë alumin dhe trashësia e tyre 0,5 (zero presje pesë) centimetra.

ç) Si përjashtim ndaj shkronjës “c”, të kësaj pike, materiali i tabelave që vendosen në vende të larta, që nuk janë lehtësisht të arritshme, duhet të jetë dibond.

d) Tabelat e drejtimit duhet të jenë në formë shigjete për të treguar drejtimin (majtas ose djathtas).

dh) Tabelat e drejtimit duhet të kenë një gjatësi prej 60 (gjashtëdhjetë) centimetra, 6 (gjashtë) centimetra prej të cilave lihen për majën e shigjetës.

e) Lartësia e lejuar për tabelat e drejtimit varion nga 8 (tetë) centimetra për tabelat me një rresht deri në 20 (njëzet) centimetra për tablat me tre rreshta.

ë) Tabelat e drejtimit duhet të kenë ngjyrë të verdhë përpara dhe mbrapa, me kodin *RAL 1023*.

f) Tabelat e drejtimit duhet të kenë veshje me mbrojtje UV ose llak të pastër.

g) Shkronjat e përdorura në tabelat e drejtimit duhet të jenë të gdhendura dhe me ngjyrë të zezë, me kodin *RAL 9005*.

gj) Fonti i përdorur për shkronjat në tabelat e drejtimit duhet të jetë *arial* ose font ekuivalent si p.sh., *liberation sans*.

h) Madhësia e fontit të shkronjave që përdoren për të shkruar destinacionin dhe kohën e ecjes duhet të jetë 1,7 (një presje shtatë) centimetra.

i) Madhësia e fontit të shkronjave që përdoren për të shkruar objektivin e ndërmjetëm dhe numrin e shtegut duhet të jetë 1,35 (një presje tridhjetë e pesë) centimetra.

j) Madhësia e fontit të shkronjave që përdoren për të shkruar autoritetin përgjegjës për mirëmbajtjen e shtegut duhet të jetë 1 (një) centimetër.

k) Kategoria e shtegut duhet të shënohet në tabela me një pikë, me diametër 2 (dy) centimetra dhe ngjyrë sipas shkronjave “I”, “II” dhe “m” të kësaj pike.

l) Për shtigjet e lehta ngjyra e pikës duhet të jetë bojë qielli, me kodin *RAL 5015*.

ll) Për shtigjet malore të moderuara ngjyra e pikës duhet të jetë e kuqe, me kodin *RAL 3020*.

m) Për shtigjet malore të vështira dhe rrugëtimet alpine ngjyra e pikës duhet të jetë e zezë, me kodin *RAL 9005*.

n) Destinacioni duhet të përsëritet në secilën tabelë drejtimi. Nëse ekziston edhe një emërtim vendas për destinacionin, përveç emrit të përdorur në harta, të dy emërtimet duhet të shënohen në tabelë (emërtimi vendas në kllapa).

nj) Objektivi i ndërmjetëm është fakultativ dhe shënohet në tabelat e drejtimit vetëm në rastet kur shtigje të ndryshme të çojnë në të njëjtin destinacion.

o) Destinacionet dhe emërtimet e tjera që përdoren, duhet të jenë të njëtrajtshëm në të gjithë tabelat e drejtimit përgjatë shtegut dhe duhet të jenë në harmoni me emërtimet në shtigjet fqinje.

p) Koha e ecjes vendoset vetëm në tabelat e drejtimit që vendosen në pikat nevralgjike të shtegut, si p.sh., në fillim të tij.

r) Format i përdoret në tabelat e drejtimit për specifikimin e kohës është: x:xx (p.sh. 0:55 orë);

rr) Numri i shtegut apo segmentit të shtegut ku duhet kaluar për të arritur në destinacion, shënohet gjithmonë në anën e djathtë të tabelës së drejtimit;

s) Nëse ka disa shtigje apo segmente shtigjesh ku duhet kaluar për të arritur në destinacion, në tabelën e drejtimit shënohen të gjithë numrat e tyre përkatës;

sh) Tabelat e drejtimit përmbajnë emrin e autoritetit përgjegjës për mirëmbajtjen e shtegut;

t) Tabelat e drejtimit mund të përmbajnë edhe piktograme për të shfaqur grafikisht një informacion të caktuar në mënyrë që të kursehet hapësirë.

Zonëparkimi 	Pikëshërbimi 	Teleferik 	Shteg tematik për milingona 
Stacion treni 	Stacion autobusi 	Burim uji 	Shteg tematik për pemë 

Figura 0.7. Shembuj piktogramesh të ndryshme

Difficulty	Destination	Interim goal (optional)	Pictogram(s) (optional)	Walking time (optional)	
●	Example Saddle (via XX Pasture)		 	0:55 h	222
●	Very Long Name Very Far Away Peak			3:30 h	222, 2214, 2335
●	Maja Template			6:15 h	222, 229
	Name of Region				
	Region (optional wayholder)		Logo special trail (optional)		Trail number

Figura 0.8. Shembull table drejtimi me elementet e saj

3.1 Specifikimet organizative për vendosjen e tabelave të drejtimit

a) Tabelat e drejtimit duhet të vendosen në pikën e fillimit të një shtegu, në çdo kryqëzim të shtigjeve, si dhe pika të tjera të rëndësishme.

b) Vendi ku vendoset tabela e drejtimit duhet të jetë afër kryqëzimit në mënyrë që drejtimit të jenë lehtësisht të kuptueshme, por të paktën 50 (pesëdhjetë) deri 60 (gjashtëdhjetë) centimetra larg nga skaji i jashtëm i shtegut.

c) Vendi ku vendoset tabela e drejtimit duhet të jetë sa më i dukshëm edhe nga larg.

ç) Vendi ku vendoset tabela e drejtimit nuk duhet të mbulohet nga bimësia.

d) Tabela e drejtimit dhe shtylla ku vendoset ajo duhet të fiksohen fort që mos të rrotullohen apo të bien.

dh) Tabelat e drejtimit nuk duhet të pengojnë dukshmërinë e tabelave zyrtare të qarkullimit rrugor.

e) Tabelat e drejtimit nuk duhet të pengojnë përdorime të tjera të shtegut (p.sh. trafikun bujqësor)

ë) Para vendosjes së tabelave në gardhe private, mure shtëpish etj., duhet t'i merret leje pronarit.

f) Nëse ka rrugë të tjera në të njëjtën shteg (p.sh. shtigje tematike, shtigje për biçikleta malore) këto rrugë mund të shënohen me piktograme në tabelat e drejtimit ose me tabela të veçanta që vendosen poshtë tabelave të drejtimit.

g) Në zona me bar apo kullota, tabelat e drejtimit duhet të mbrohen me tela me gjemba, gardhe druri, apo forma të tjera të përshtatshme.

4. Tabelat e vendndodhjeve

a) Tabela e vendndodhjeve përdoren për të treguar kryesisht emrin e vendit në të cilin është vendosur tabela. Tabelat e vendndodhjeve vendosen në pika të rëndësishme të shtegut, të cilat janë emërtuar në harta ose në nyje të tjera të rëndësishme të shtigjeve, duke treguar në çdo rast vend ndodhjen.

b) Materiali i përdorur për tabelat e vendndodhjeve duhet të jetë alumin dhe trashësia e tij 0,3 (zero presje tre) centimetra;

c) Si përjashtim ndaj shkronjës “b”, të kësaj pike, materiali i tabelave të vendndodhjeve që vendosen në vende të larta, që nuk janë lehtësisht të arritshme, duhet të jetë dibond;

ç) Tabelat e vendndodhjeve duhet të kenë formë drejtkëndore;

d) Tabelat e vendndodhjeve duhet të jenë 20 (njëzet) centimetra të gjata dhe 10 (dhjetë) centimetra të larta;

dh) Tabelat e vendndodhjeve duhet të kenë ngjyrë të bardhë, përpara dhe mbrapa, me kodin, *RAL 9003*;

e) Shkronjat e përdorura në tabelat e vendndodhjeve duhet të jenë të gdhendura dhe me ngjyrë të zezë, me kodin *RAL 9005*;

ë) Tabelat e vendndodhjeve duhet të kenë veshje me mbrojtje UV ose llak të pastër;

f) Fonti i përdorur për shkronjat në tabelat e vendndodhjeve duhet të jetë *arial* ose font ekuivalent si p.sh. *liberation sans*;

g) Madhësia e fontit të shkronjave që përdoren për të shkruajtur vendndodhjen duhet të jetë 2 (dy) centimetra;

gj) Madhësia e fontit të shkronjave që përdoren për të shkruajtur lartësinë mbi nivelin e detit duhet të jetë 1,5 (një presje pesë) centimetra;

h) Madhësia e fontit të shkronjave që përdoren për të shkruajtur koordinatat *GPS* dhe numrin e emergjencës duhet të jetë 1 (një) centimetër dhe *bold*.

i) tabelat e vendndodhjeve përmbajnë informacion, për:

i. vendndodhjen (emërtimi i marrë nga hartat dhe nëse ky i fundit nuk disponohet, emërtimi i përdorur nga komuniteti vendas);

ii. lartësinë mbi nivelin e detit;

iii. koordinatat *GPS* (*WGS84*, sistemi dhjetor);

iv. numrin e urgjencës.



Figura 0.9. Shembull table vendndodhje me elementet e saj

5. Tabelat e rregullave të sjelljes

a) Tabelat e rregullave të sjelljes përdoren për të treguar detyrimin për të zbatuar rregulla të caktuara nga vizitorët, me qëllim informimin dhe edukimin e vizitorëve mbi rregullat e sjelljes gjatë ecjes nëpër shtigje dhe shmangien e veprimeve të padëshiruara.

b) Tabelat e rregullave të sjelljes duhet të vendosen kryesisht në pikat kryesore të hyrjes në

shtigje, pranë qendrave të vizitoreve, si dhe në pikat ku shtegu hyn apo i afrohet zonave ku është e ndaluar hyrja apo një veprim tjetër.

c) Rregullat në tabela duhet të shkruhen me mirësjellje. Për tabelat e rregullave të sjelljes mund të përdoren dhe piktograme.

ç) Për tabelat e rregullave të sjelljes nuk përdoret një model i standardizuar.

6. Tabelat e tjera

a) Për qëllimin e mirë orientimit të grupeve të ndryshme, në shtigje mund të vendosen edhe tabela të tjera përveç tabelave në pikat 1 deri 5, të kësaj shtojce, që përdoren zakonisht për të sinjalizuar mundësinë e përdorimit të rrugës me mjete ose me kafshë, si p.sh., tabelat për biçikletat malore (*mountainbikes*).

b) Për formën dhe madhësinë e tabelave të tjera zbatohen parametrat e përcaktuara shkronjat “ç” dhe “d”, të pikës 4, të kësaj shtojce.

c) Tabelat e tjera përmbajnë piktogramin përkatës në anën e majtë dhe një shigjetë që tregon drejtimin në anën e djathtë.




Figura 0.10. Shembull tabele tjetër

7. Vendosja dhe instalimi i sinjalistikës vertikale

a) Tabelat pjesë e sinjalistikës vertikale vendosen në një lartësi të tillë që të sigurojë shikueshmëri maksimale nga çdo drejtim dhe të mos shqetësojnë ose të vënë në rrezik vizitorët ose kalimtarët.

b) Tabelat pjesë e sinjalistikës vertikale fiksohen në shtylla ose në sende ekzistuese të paluajtshme, me përjashtim të pemëve dhe objekteve me vlera mjedisore, historike, kulturore, ose arkitekturore.

c) Vendosja e shtyllave duhet të shmangët, nëse ekziston një opsion i mirë për të vendosur tabelën përkatëse në një send ekzistues (shtyllë tjetër ekzistuese, mur etj.).

ç) Shtyllat që përdoren për vendosjen e sinjalistikës vertikale janë tuba prej alumini ose çeliku të galvanizuar me diametër 6 (gjashtë) centimetra, lartësi 250 (dyqind e pesëdhjetë) deri 300 (treqind) centimetra dhe trashësi murri 0,3 (zero presje 3) centimetra.

d) Për nguljen e shtyllave në tokë rekomandohet të përdoren ganxha (spiranca spirale) toke të galvanizuara nga tub i presuar me të ftohtë dhe gjatësi 80 (tetëdhjetë) centimetra ose 100 (njëqind) centimetra, në varësi të nënshtresës.



Figura 0.11. Ganxha (spiranca spirale) toke

dh) Pasi ganxha (spiranca spirale) të jetë futur në tokë, shtylla mund të futet në ganxhë. Përfaqësuesit e autoritetit përgjegjës mund të përdorin zhavorr nëse shtylla lëviz djathtas ose majtas për të fiksuar atë. Duke goditur lehtë shtyllën me një çekiq, zhavorri ngurtësohet dhe shtylla qëndron fort.

e) Përdorimi i bazamenteve me beton që ngrin shpejt për fiksimin e shtyllave në terren, bëhet vetëm në rastet të jashtëzakonshme kur pesha, distanca e tabelës nga themeli, apo faktorë të tjerë, e kërkojnë domosdoshmërisht një fiksion të tillë.

ë) Për mbërthimin e tabelave të drejtimit në shtyllë përdoren kapëse/klapa të posaçme.

f) Nëse në shtyllë apo në një send tjetër të paluajtshëm vendoset me shumë se një tabelë, duhet të respektohet rendi në vijim për vendosjen e tyre (nga lart poshtë):

- i. tabelat e drejtimit;
- ii. tabelat e tjera (p.sh. tabela për biçikleta malore, tabela për ecje në distanca të gjata); dhe
- iii. tabelat e vendndodhjeve.

g) Pozicioni i tabelave në shtyllë përcaktohet sipas rregullave të mëposhtme:



i. buza e sipërme e tabelës që vendoset më lart ndodhet 5 (pesë) centimetra poshtë majës së shtyllës;

ii. midis tabelave në shtyllë lihet një distancë që varion nga 2 (dy) centimetra deri në 4 (katër) centimetra.

II. SINJALISTIKA HORIZONTALE

1. Sinjalistika horizontale

a) Sinjalistika horizontale është tërësia e shenjave të vendosura në tokë, në trungjet e pemëve, në shkëmbinj, ose në sende të tjera të paluajtshme, që kanë për qëllim kryesor të tregojnë drejtimin e vazhdimësisë së shtegut.

2. Rregullat për vendosjen e shenjave

a) Shenjat pikturohen ose vendosen në shkëmbinj, në trungjet e pemëve, gardhe ose në sende të tjera të paluajtshme ekzistuese dhe në mungesë të tyre në sende të tjera që vendosen nga autoriteti përgjegjës në buzë të shtegut.

b) Vendi ku pikturohet ose vendoset shenja duhet të garantojë maksimumin e shikueshmërisë nga të dyja drejtimit.

c) Nëse është e nevojshme për një orientim më të mirë shenjat vendosen për secilin drejtim.

ç) Nëse është e mundur, vendi ku vendoset shenja duhet të jetë në nivelin e syve dhe këndi i shenjës në raport me shtegun të jetë 90 (nëntëdhjetë) gradë.

d) Shenjat përsëriten përgjatë shtegut duke respektuar kriteret e mëposhtme:

i. nëse shtegu është qartësisht i identifikueshëm, i dukshëm dhe pa devijime, është e mjaftueshme të vendosen shenja çdo 200 (dyqind) metra, por në asnjë rast, në një distancë më të vogël;

ii. në rast se rruga e shtegut nuk është e dukshme dhe lehtësisht e identifikueshme është e nevojshme të garantohet shikueshmëria e çdo shenje nga shenja që e pason atë. Frekuenca e vendosjes së shenjave varet nga zona, karakteristikat mjedisore dhe dukshmëria e shtegut;

iii. në terrene të hapura që janë të prirura ndaj mjegullës dhe mund të kenë për rrjedhojë shikueshmëri të dobët, shenjat nuk duhet të jenë asnjëherë më shumë se 100 (njëqind) metra larg njëra-tjetres;

iv. në kryqëzimet me shtigje të pashënuara, distanca nga shenja në shenjë duhet të jetë shumë e shkurtër pas kryqëzimit (që drejtimi i ecjes të jetë i qartë). Nëse nuk është e mundur të vendoset shenja,

në raste përjashtimore mund të vizatohet një shigjetë;

v. shenjat duhet të përmbajnë herë pas here edhe numrin e shtegut (p.sh. çdo shenjë e 10-të).

3. Format, madhësia, ngjyra dhe materiali që përdoret për shenjat që shënjojnë shtegun

a) Shenjat që përdoren për të shënjuar shtegun duhet të kenë formë drejtkëndore me madhësi 20 (njëzet) centimetra x 14 (katërmëdhjetë) centimetra.

b) Shenjat që përdoren për të shënjuar shtegun duhet të kenë dy vija horizontale me ngjyrë të kuqe me kodin, *RAL 3020* dhe një vijë në mes të tyre me ngjyrë të bardhë me kodin, *RAL 9003*.

c) Trashësia e vijave me ngjyrë të kuqe duhet të jetë 4 (katër) centimetra kurse ajo e vijës së bardhë 6 (gjashtë) centimetra.

ç) Numri i shtegut vendoset në mes të vijës së bardhë (e zbatueshme vetëm për shenjat që i vendosen numra).

d) Orientim i vijave të shenjës duhet të jetë në drejtim të shtegut.

dh) Materialet e përdorura për shenjat që pikturohen ose vendosen duhet të jenë bojëra të lehta të vajit rezistente ndaj dritës, shirita ngjites rezistentë ndaj dritës, shenja prej fletësh alumini të holla dhe të përkulshme, apo shenja prej materiali tjetër të përshtatshëm.

e) Me qëllim zbatimin e këtyre parashikimeve përfaqësuesit e autoritetit përgjegjës duhet të pajisen me të gjitha mjetet e nevojshme të punës, si: furça, furça teli, kruajtëse për lëvore, sharra dore, hollues, leckë, qese plastike, doreza, shkop për retushimin e numrave të shtigjeve në vijën e bardhë, çekiq dhe gozhdë për shenjat me material alumini, si dhe numra të zinj që ngjiten dhe janë rezistentë ndaj motit të keq.



Figura 0.12. Shenjat

4. Piketat e terrenit

a) Piketat e terrenit përdoren për të zëvendësuar shenjat e shtegut, nëse nuk është e mundur për të identifikuar vende të përshtatshme për vendosjen e

tyre, duke marrë parasysh nevojën për të siguruar shikueshmëri të mjaftueshme. Piketat e terrenit vendosen zakonisht në sipërfaqe të mëdha toke pa sende natyrore të paluajtshme në të cilat është e mundur të vendosen shenja.

b) Materiali që përdoret për piketat e terrenit duhet të jetë dru larashi ose një dru tjetër i ngjashëm.

c) Piketat e terrenit duhet të kenë një diametër 6 (gjashtë) deri 8 (tetë) centimetra dhe një lartësi 100 (njëqind) deri 120 (njëqind e njëzet) centimetra, nga të cilat pjesa që futet nën tokë është rreth 30 (tridhjetë) deri 40 (dyzetë) centimetra.

ç) Si përjashtim ndaj shkronjës “c”, të kësaj pike, nëse zona ka apo pritet të ketë bimësi të lartë, piketat duhet të jenë më të larta.

d) Piketat e terrenit duhet të kenë seksion të rrumbullakët ose katror dhe majë të mprehtë për t'u futur në tokë.

dh) Piketat e terrenit futen në tokë në një thellësi prej jo më pak se një e treta e lartësisë maksimale mbi tokë.

e) Piketa e terrenit pikturohen në pjesën e sipërme me flamur të kuq-bardhë-kuq.

ë) Për frekuencën e vendosjes së pikave të terrenit, zbatohen rregullat e përcaktuara në shkronjën “d”, të pikës 2, të këtij seksioni.

f) Barinjtë dhe anëtarët e tjerë të komunitetit që jeton në zonë, duhet të informohen nga autoriteti përgjegjës për ekzistencën, kuptimin dhe rëndësinë e piketave.




Figura 0.13. Piketat e terrenit

SHTOJCA 4 MODELET TIP TË RAPORTEVE TË INSPEKTIMIT

TABELA NR. 1. RAPORTI I SHTEGUT

Numri i shtegut		Shtegu i aksesueshëm	Po	Jo
Seksioni i shtegut		Ridrejtimi përmes		
Data e inspektimit	nga: deri:	Shtegu i aksesueshëm përsëri në datë		
Shtegmbajtësi				

Problematikat	Masat e mirëmbajtjes	Komente/shënime	Nr. i fotove
Shenjat			
Nuk janë të dukshme për shkak të humbjes së ngjyrimit	Rifreskimi i shenjave		
Mungojnë (p.sh. shenjat në pemët dhe gurët e rënë)	Pikturimi ose vendosja e shenjave të reja		
Nuk janë të dukshme për shkak të mbulimit me bimësi	Kositje dhe krasitje shkurresh, pemësh dhe barërash		
Piketat e terrenit			
Nuk janë të dukshme pasi kanë humbur ngjyrimin	Ripikturimi i piketave		
Mungojnë ose janë të thyera	Zëvendësimi i piketave		
Janë rrëzuar në tokë	Riinstalimi duke përdorur nëse është e nevojshme një mënyrë më të mirë instalimi për të siguruar qëndrueshmëri		
Të pamjaftueshme në numër (piketa shtesë të nevojshme)	Porositja dhe vendosja e piketave shtesë		
Tabelat			
Mungojnë ose janë të shkatërruara	Porositja dhe zëvendësimi i tabelave; Nëse konsiderohet e nevojshme, të instalohet gardh me tela me gjemba përreth për të shmangur shkatërrimin nga kafshët dhe të bisedohet me banorët e zonës për rëndësinë e ruajtjes dhe mos dëmtimit të sinjalistikës vertikale		



Tabelat janë të varura poshtë ose të kthyer	Fiksimi i tabelës ose shtyllës mbajtëse (në varësi të arsyes)		
Shtylla mbajtëse e tabelës mungon ose është dëmtuar	Porositja dhe zëvendësimi i shtyllës mbajtëse. Nëse konsiderohet e nevojshme, të bisedohet me banorët e zonës për rëndësinë e ruajtjes dhe mos dëmtimit të sinjalistikës vertikale		
Shtylla mbajtëse e tabelës është rrëzuar	Riinstalimi i shtyllës. Nëse konsiderohet e nevojshme, të instalohet gardh me tela me gjemba përreth për të shmangur shkatërrimin nga kafshët dhe të bisedohet me banorët e zonës për rëndësinë e ruajtjes dhe mos dëmtimit të sinjalistikës vertikale		
Bimësia			
Rritja e bimësisë duke ngushtuar shtegun apo ulur shikueshmërinë	Kositja e barit, krasitja e shkurreve dhe pemëve, prerja e degëve të pemëve dhe pastrimi i shtegut		
Sipërfaqja e ecjes			
Dëmtim i anëve të shtegut	Bllokimi i përkohshëm i shtegut nëse është i nevojshëm; Rregullimi i anëve të shtegut; Zëvendësimi i izoluesve të anëve të shtegut; Përmirësimi i kullimit; Instalime gjeotekstile		
Sipërfaqe e rrëshqitshme	Në varësi të situatës: Përmirësimi i kullimit; Hedhje zhavorri; Krijimi i shkallëzimeve në sipërfaqen e ecjes		
Gropa me ujë dhe baltë	Pastrimi dhe përmirësimi i kanaleve të ujit dhe kullimit; Tharje e pjesëve të lagështa dhe hedhje e shtresës bazë; Vendosja e një rrugë kalimi me dërrasa në ligatina		
Dëmtim nga erozioni	Përmirësimi i kullimit		
Gropa ose zhveshje e sipërfaqes	Mbushja e sipërfaqes dhe përmirësimi i kullimit		
Gjurmët të tjera jashtë shtegut duke krijuar sipërfaqe tjetër ecje	Përmirësimi i shtegut kryesor duke i shtuar tabelat drejtuese për kalimin në shteg		
Informacioni të tjera të përgjithshme nëse është e sigurt për të kaluar	Mbyllje e përkohshme e shtegut nëse është e nevojshme		
Zona buferike /mjedis i rrezikshëm			
Pemë të rrëzuara	Largimi i pemës dhe mbyllja e përkohshme e zonës ku punohet		
Gurë të lëvizshëm mbi shtegun	Largimi i gurëve dhe mbyllja e përkohshme e zonës ku punohet		
Rënie të shpeshta gurësh nga shkëmbinjtë mbi shteg	Mbyllja e segmentit të shtegut deri në zgjidhjen e problemit		
Argjinaturat			
Vende të lagështa, krisje dhe kanale të krijuara nga erozioni, gërryerje nga poshtë, rrëshqitje të dheut etj.	Përmirësimi i kullimit dhe marrja e masave për fortifikimin e argjinaturës		
Litarët mbajtës			
Litari është i dëmtuar	Zëvendësimi i litarit dhe mbyllje e shtegut deri në zgjidhjen e problemit		
Ganxha toke që janë të lirshme ose janë dëmtuar. Prani ndryshku ose gurësh përreth gropës së ganxhave	Zëvendësimi ose fiksimi i ganxhave të tokës dhe mbyllja e shtegut deri në zgjidhjen e problemit		



Struktura: gardhe, parmakë, mbrojtëse, porta, tavolina, stola, zona pushimi etj.			
Pjesë druri të lagështa, të kalbura ose të deformuara	Zëvendësimi i tyre me lloje druri rezistentë dhe marrja e masave për rritjen e qëndrueshmërisë dhe jetëgjatësisë së drurit		
Pjesët metalike të gërryera, të thyeshme ose të deformuara	Zëvendësimi i tyre		
Ganxha toke të dëmtuara ose të lirshme	Rregullimi dhe vendosja më e mirë, ose zëvendësimi i tyre		
Urat dhe rrugët me dërrasa			
Dobësim i themeleve	Riparimi ose zëvendësimi i themeleve		
Sipërfaqe e rrëshqitshme e ecjes	Përshtatja e veshjes së sipërfaqes së ecjes		
Blokimet nga trungjet aluviale	Largimi i drurëve notues dhe depozitimi i tyre në zonën e bregut; vlerësimi i mundësisë së ngritjes së urës në një lartësi më të madhe		
Vrima në sipërfaqen e ecjes	Blokimet e vrimave dhe rinovimi i sipërfaqes së ecjes		
Shkallët			
Shufra dhe kunjat përforcuese dalin jashtë nga shkallët	Ngulja e shufrave dhe kunjave përforcuese		
Shkallë të lëvizshme	Vendosja e shufrave dhe kunjave përforcuese		
Sipërfaqe e rrëshqitshme ose e gërryer e ecjes	Përshtatja e veshjes së sipërfaqes së ecjes		
Mbeturinat			
Prani e mbeturinave	Largimi i mbeturinave; nëse është e nevojshme, të vendosen tabela me informacione që përdoruesit t'i marrin mbeturinat me vete		

TABELA NR. 2. RAPORT NË RASTET E DËMTIMEVE TË RËNDA TË SHTEGUT

Numri i shtegut		Shteg i aksesueshëm	Po	Jo
Seksioni i shtegut		Ridrejtimit përmes		
Data e inspektimit		Shtegu i aksesueshëm përsëri në datë		
Shtegmbajtësi				

Përshkrim i detajuar i dëmit

Propozimi për masat që duhen marrë

**URDHËR****Nr. 602, datë 5.8.2024**

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E GJERMANISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës; në nenet 42 dhe 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha

kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre, duke përjashtuar mishin e vulosur në një konteiner hermetik me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja Administrative e nivelit të parë	Ndarja Administrative e nivelit të dytë	Ndarja Administrative e nivelit të tretë
Baden-Württemberg	Emmendingen	Nördlicher Kaiserstuhl
Brandenburg	Barnim	Britz-Chorin-Oderberg,
Brandenburg	Dahme-Spreewald	Lieberose/Oberspreewald
Brandenburg	Frankfurt (Oder),	Frankfurt (Oder)
Brandenburg	Märkisch-Oderland	Lebus
Brandenburg	Märkisch-Oderland	Bad Freienwalde (Oder),
Brandenburg	Märkisch-Oderland	Golzow
Brandenburg	Oberspreewald-Lausitz	Großräschen
Brandenburg	Oberspreewald-Lausitz	Ruhland
Brandenburg	Oberspreewald-Lausitz	Senftenberg
Brandenburg	Oberspreewald-Lausitz	Altdöbern
Brandenburg	Oder-Spree	Odervorland
Brandenburg	Oder-Spree	Scharmützelsee
Brandenburg	Oder-Spree	Schlaubetal
Brandenburg	Oder-Spree	Eisenhüttenstadt
Brandenburg	Oder-Spree	Brieskow-Finkenheerd
Brandenburg	Oder-Spree	Beeskow
Brandenburg	Oder-Spree	Rietz-Neuendorf
Brandenburg	Spree-Neiße	Schenkendöbern
Brandenburg	Spree-Neiße	Spremberg
Brandenburg	Spree-Neiße	Guben
Brandenburg	Spree-Neiße	Forst (Lausitz)
Brandenburg	Spree-Neiße	Döbern-Land
Brandenburg	Spree-Neiße	Neuhausen/Spree
Brandenburg	Spree-Neiße	Drebkau
Brandenburg	Uckermark	Schwedt/Oder
Brandenburg	Uckermark	Gartz (Oder)
Brandenburg	Uckermark	Oder-Welse
Brandenburg	Uckermark	Angermünde
Brandenburg	Spree-Neiße	Peitz
Brandenburg	Uckermark	Prenzlau
Brandenburg	Dahme-Spreewald	Lübben (Spreewald)
Brandenburg	Cottbus	Cottbus
Mecklenburg-Vorpommern	Ludwigslust-Parchim	Parchimer Umland
Mecklenburg-Vorpommern	Ludwigslust-Parchim	Eldenburg Lüz
Mecklenburg-Vorpommern	Ludwigslust-Parchim	Grabow
Mecklenburg-Vorpommern	Rostock	Krakow am See
Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Greifswald	Pasewalk*
Niedersachse	Emsland	Twist
Niedersachsen	Emsland	Emsbüren
Niedersachsen	Cloppenburg	Garrel
Sachsen	Bautzen	



Sachsen	Görlitz	Weißwasser/O.L
Sachsen	Görlitz	Diehsa
Sachsen	Görlitz	Bad Muskau
Sachsen	Görlitz	Rietschen
Sachsen	Görlitz	Markersdorf
Sachsen	Görlitz	Boxberg/O.L
Sachsen	Görlitz	Schleife
Sachsen	Görlitz	Niesky
Sachsen	Görlitz	Reichenbach/O.L
Sachsen	Görlitz	Ostritz
Sachsen	Görlitz	Weißer Schöps/Neiße
Sachsen	Meißen	Thiendorf
Sachsen	Meißen	Ebersbach
Sachsen	Meißen	Moritzburg
Sachsen	Meißen	Schönfeld
Sachsen	Meißen	Radeburg
Sachsen	Meißen	Weinböhla
Sachsen	Meißen	Niederau
Sachsen	Nordsachsen	Wermsdorf
Sachsen	Sächsische Schweiz -Osterzgebirge	Lohmen/Stadt Wehlen
Sachsen	Bautzen	Radibor
Sachsen	Bautzen	Königswartha
Sachsen	Bautzen	Neschwitz
Sachsen	Bautzen	Elsterheide*
Sachsen	Bautzen	Spreetal*
Schleswig-Holstein	Nordfriesland	Südtondern
Schleswig-Holstein	Kiel	Kiel
Hessen	Groß-Gerau	Biebesheim am Rhein*
Hessen	Groß-Gerau	Stockstadt am Rhein*
Hessen	Groß-Gerau	Riedstadt*
Hessen	Groß-Gerau	Groß-Gerau*
Hessen	Groß-Gerau	Trebur*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre, mishin e vulosur në një konteiner hermetik me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Gjermanisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të pa infektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tri muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të

paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tri muajt para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muajt vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur, në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në



nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11, të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tri muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërtetohet se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur, në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10, të Kodit Terrestrial të OIE-së.

2.4 Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërtetohet se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) janë vlarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3, të Kodit Terrestrial të OIE-së në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15. dhe 15.1.16, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të nenëve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16, të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin, me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**



a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajes afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajes afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajes afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 582, datë 29.7.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajes afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Gjermanisë”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari

URDHËR

Nr. 603, datë 5.8.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E UKRAINËS

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës; në nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre, duke përjashtuar mishin e vulosur në një konteiner hermetik me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja Administrative e nivelit të parë	Ndarja Administrative e nivelit të dytë	Ndarja Administrative e nivelit të tretë
Chernihiv	Ripkyns'kyi*	
Chernihiv	Chernivets'ka*	
Chernihiv	Nizhyns'kyi*	
Chernihiv	Kozelets'kyi*	
Chernihiv	Pryluts'kyi*	
Chernihiv	Nosivs'kyi	
Chernihiv	Sribnians'kyi*	
Chernihiv	Mens'kyi*	
Chernivtsi	Hlybets'kyi*	
Chernivtsi	Zastavnets'kyi*	
Donets'k	Slovians'kyi*	
Kharkiv	Krasnokuts'kyi*	
Kharkiv	Novovodolaz'kyi*	
Kiev	Obukhivs'kyi*	
Kiev	Vyshhorods'kyi*	
Kiev	Boryspil's'ka*	
Kiev	Ivankivs'kyi*	
Kiev	Holosiivs'kyi*	
Kiev	Rokytnians'kyi*	
Kiev	Pereiaslav-Khmel'nyts'kyi*	
Kiev	Bilotserkivs'kyi*	
Kiev	Kaharlyts'kyi*	
Kiev	Tarashchans'kyi*	
Kirovohrad	Dobrovelychkivs'kyi*	



Kirovohrad	Kirovohrads'kyi*	
Kirovohrad	Novoukrans'ky*	
Kirovohrad	Svitlovods'kyi*	
Zhytomyr	Zhytomyrs'ka*	
Zhytomyr	Berdychivs'kyi*	
Volyn	Volodymyr-Volyns'kyi*	
Kherson	Beryslavs'kyi*	
Kherson	Novovorontsovs'kyi*	
Mykolayiv	Mykolaevs'kyi*	
Mykolayiv	Berezans'kyi*	
Mykolayiv	Berezhnivats'kyi*	
Odessa	Kotovs'kyi*	
Poltava	Kobeliats'kyi*	
Poltava	Kozel'shchyns'kyi*	
Poltava	Poltavs'kyi*	
Sumy	Lebedyns'kyi*	
Sumy	Romens'kyi*	
Vinnitsya	Iampil's'kyi*	

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre, mishin e vulosur në një konteiner hermetik me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Ukrainës, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të pa infektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tri muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tri muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenin 15.1.28 deri

në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur, në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11, të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenin 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur, në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10, të Kodit Terrestrial të OIE-së.

2.4 Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur, në përputhje me nenin 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit.



Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3, të Kodit Terrestrial të OIE-së, në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16, të Kodit Terrestrial të OIE-së, ose;

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit, për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 584, datë 29.7.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Ukrainës”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.



5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari

URDHËR
Nr. 604, datë 5.8.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E ITALISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre duke përfshirë mishin e vulosur në një kontejner hermetik me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Lazio	Roma*	
Lazio	Rieti*	
Liguria	Genova*	
Liguria	Savona*	
Liguria	La Spezia	Varese Ligure*
Piemonte	Alessandria*	
Piemonte	Novara	Treccate*

Piemonte	Torino*	
Piemonte	Asti*	
Sardegna	Nuoro*	
Sardegna	Sassari*	
Campania	Salerno	Casaleto Spartano*
Campania	Salerno	Casalbuono*
Campania	Salerno	Buonabitacolo*
Calabria	Reggio Di Calabria*	
Lombardia	Pavia*	
Lombardia	Milano	Besate*
Lombardia	Milano	Vernate*
Emilia-Romagna	Piacenza*	
Emilia-Romagna	Parma*	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre, mishin e vulosur në një kontejner hermetik me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Italisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare, duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartment (zonë) pa prezencë të murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare, duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muajt para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muajt vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të



përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11, të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare, duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10, të Kodit Terrestrial të OIE-së.

2.4 Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare, duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare, duhet të vërtetojë që:**

a) janë vlarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16, të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë



përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare, duhet të vërtetohet që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartment pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 526, datë 10.7.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Italisë”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit

dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

**ÇËSHTJA PAKAKOSTANDINI KUNDËR
SHQIPËRISË**
(kërkesa nr. 7568/08)

VENDIM

STRASBURG
18 korrik 2024

Ky është vendim përfundimtar, por mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktorial.

Në çështjen Papakostandini kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si Komiteti i përbërë nga:

Peeter Roosma, *President,*

Andreas Zünd,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë,*

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendëskancelare në detyrë e Seksionit,*

pas diskutimit me dyer të mbyllura, më 27 qershor 2024,

mori vendimin e mëposhtëm, i cili miratohet po në atë datë:

PROCEDURA

1. Çështja vjen pas depozitimit në Gjykatë të një kërkesë kundër Shqipërisë, sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa), më 18 janar 2008.

2. Qeveria Shqiptare (qeveria) u njoftua për kërkesën.

FAKTET

3. Detajet e kërkuarve dhe informacion, në lidhje me kërkesën jepen në tabelën bashkëngjitur.



4. Kërkuesi u ankua për tejkalimin e kohëzgjatjes së procesit civil.

I. PRONËSIA DHE QIRADHËNIA E PARCELËS PÛRKATËSE TË TOKËS

5. Më 17 tetor 1995 Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (Komisioni) Durrës njohu pronësinë e trashëguar të kërkuesit dhe anëtarëve të tij të familjes mbi një parcelë toke me sipërfaqe 10000 m², dhe të ndodhur brenda një zone që menaxhohej nga Shtëpia e Pushimit të Ushtarakëve Durrës, një shoqëri shtetërore nën përgjegjësinë e Ministrisë së Mbrojtjes. Komisioni, gjithashtu, urdhëroi kthimin e parcelës të kërkuesit dhe familja e tij.

6. Më 12 dhjetor 1995, kërkuesi regjistroi pronësinë e tij në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP); megjithatë, Shtëpia e Pushimit të Ushtarakëve vazhdoi të administronte parcelën e tokës, duke ia dhënë atë me qira një pale të tretë më 24 prill 1999.

7. Gjykata e Rrethit Durrës pranoi kërkesën e kërkuesit për të ndryshuar vendimin e Komisionit të vitit 1995. Më 14 qershor 2000, ajo njohu pronësinë e trashëguar të kërkuesit dhe bashkëpronarëve mbi një parcelë tjetër toke me sipërfaqe 6000 m² dhe urdhëroi kthimin e saj.

II. PROCEDURA PÛR KOMPENSIMIN PÛR QIRANË E PARCELËS SË TOKËS

8. Më 18 gusht 2000, kërkuesi me bashkëpronarët e parcelës së tokës filluan procesin ligjor kundër Shtëpisë së Pushimit të Ushtarakëve dhe Ministrisë së Mbrojtjes, duke pretenduar shumat që pala e tretë i kishte paguar të paditurve sipas kontratës së qirasë.

9. Më 6 shkurt dhe 27 qershor 2001, gjykata e shkallës së parë dhe e apelit, përkatësisht, vendosën në favor të paditësve. Këto vendime u prishën më 20 mars 2002, nga Gjykata e Lartë e cila e ktheu çështjen për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Gjykata e Lartë vendosi që gjykatat më të ulëta duhej të kishin ftuar në proces qiramarrësin.

10. Më 30 shtator 2002, Gjykata e Rrethit Durrës miratoi kërkesën e kërkuesit për masë sigurimi dhe ngriu 187.485 dollarë (USD) që i takonin Shtëpisë së Pushimit të Ushtarakëve. Më tej vendosi të pezullojë procesin deri në vendimin e gjykatës së brendshme në procese paralele, ku u kundërshtua pronësia e kërkuesit mbi parcelën e tokës (shihni paragrafin 18 më poshtë).

11. Masa e sigurimit u hoq më 30 janar 2003, kur Gjykata e Apelit Durrës, gjithashtu, la në fuqi vendimin për pezullimin e procesit. Procesi rifilloi më 25 maj 2008. Më pas, disa seanca gjyqësore u shtynë sepse anëtarët e familjes së kërkuesit, bashkëpaditës në proces, nuk u njoftuan me fletëthirrje.

12. Më 15 prill 2009, gjykata pezulloi procesin për të lejuar anëtarët e familjes së kërkuesit që të nxirrnin një akt trashëgimie, në lidhje me një familjar që kishte ndërruar jetë, një bashkëpaditës.

13. Edhe pse vendimi për vazhdimin e procesit doli më 9 shtator 2009, seanca e kësaj date u shty sepse mungonte gjyqtari. Dy seancat e radhës u ricaktuan për të njëjtën arsye.

14. Më 16 mars 2010, Shtëpia e Pushimit të Ushtarakëve kërkoi pezullimin e procesit sepse po bënte riorganizim të brendshëm dhe nuk ishte e qartë se cili subjekt do ta pasonte. Gjykata pranoi kërkesën dhe pezulloi procesin.

15. Procesi rifilloi më 2 nëntor 2012.

16. Më 23 janar 2013, gjykata vuri re që kërkuesi nuk u paraqit, pa ndonjë arsye të fortë, dhe ndërpreu procesin në lidhje me atë.

17. Ndërmjet 23 janarit dhe 30 tetorit 2013, gjykata u mbështet në të njëjtat shkaqe për të ndërprerë procesin në lidhje me paditësit e mbetur.

III. PROCESET NË LIDHJE ME SHFUQIZIMIN E PRONËSISË SË KÛRKUESIT

18. Më 22 tetor 2001, Shtëpia e Pushimit të Ushtarakëve paditi kërkuesin përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me kërkesën për të prishur vendimin e Komisionit të vitit 1995.

19. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës pezulloi procesin, më 7 tetor 2002, sepse vlerësoi që paditësi kishte filluar proces të ngjashëm dhe të ndërlidhur përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ky vendim u la në fuqi në apel më 12 dhjetor 2002, nga Gjykata e Apelit Durrës.

20. Më 11 mars 2004, Gjykata e Lartë gjeti që nuk kishte arsye për të pezulluar procesin dhe e ktheu çështjen për shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor.

21. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, më 17 korrik 2006, prishi pjesërisht vendimin e Komisionit të vitit 1995. Ajo vendosi që kërkuesi duhet të dëmshpërblehet në një nga mënyrat e parashikuara në ligj, në lidhje me 10000 m² në vend të kthimit të pronës.



22. Më 21 janar 2008, Gjykata e Apelit e ndryshoi atë vendim dhe vendosi që kërkuksi të dëmshpërblehej në një nga mënyrat e parashikuara në ligj, në lidhje me 10000 m² në vend të kthimit të pronës.

23. Më 24 tetor 2012, Gjykata e Lartë i prishi ato vendime dhe e rrëzoi padinë kundër kërkuksve si të pabazuar. Ajo e gjeti të ligjshëm dhe të vlefshëm vendimin e Komisionit të vitit 1995.

LEGJISLACIONI

I. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

24. Kërkuksi u ankua që kohëzgjatja e dy proceseve civile nuk ishte në përputhje me kërkesën e “kohës së arsyeshme”. Ai u mbështet në paragrafin 1, të nenit 6 të Konventës.

A. Parimet e zbatueshme

25. Gjykata thekson se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së proceseve duhet të vlerësohet duke pasur parasysh rrethanat e çështjes dhe duke iu referuar kritereve të mëposhtme: kompleksitetit të çështjes, sjelljes së kërkuksit dhe autoriteteve përkatëse, dhe atë që ishte në diskutim për kërkuksin në mosmarrëveshje (shihni *Frydlander kundër Francës* [DHM], nr. 30979/96, § 43 GJEDNJ 2000-VII).

26. Në çështjet kryesuese *Luli dhe të tjerë kundër Shqipërisë* (nr. 64480/09 dhe 5 të tjera, 1 prill 2014) dhe *Mishgioni kundër Shqipërisë* (nr. 18381/05, 7 dhjetor 2010), Gjykata tashmë ka gjetur shkelje, në lidhje me probleme të ngjashme me ato në këtë çështje.

B. Vlerësimi i Gjykatës

1. Procese për pretendimin e kërkuksit për kompensim

27. Procesi filloi më 18 gusht 2000 (shihni paragrafin 8 më sipër) dhe përfundoi më 23 janar 2013 (shihni paragrafin 16 më sipër). Prandaj, ai zgjati disi më shumë se dymbëdhjetë vjet dhe pesë muaj përpara tri niveleve të juridiksionit ku çështja u shqyrtua në katër raunde procesesh.

28. Objekti kryesor përpara gjykatave të brendshme nuk ishte veçanërisht kompleks dhe kërkonte vetëm vendimin për të drejtën e kërkuksit, për shumat që të paditurit kishin mbledhur për dhënien me qira të parcelës së tokës tek një palë e tretë.

29. Vonesa në fillim ndodhi për faktin se vendimi i parë i gjykatës së faktit dhe të apelit u rrëzuan në ankimin përpara Gjykatës së Lartë (shihni paragrafin 9 më sipër). Edhe pse nuk i takon Gjykatës që të analizojë cilësinë e vendimmarrjes së gjykatave të

brendshme, kthimi i çështjeve për rishqyrtim zakonisht urdhërohet si rezultat i gabimeve të kryera nga gjykatat më ulëta, përsëritja e këtyre urdhrave brenda një procesi tregon një të metë të rëndë në sistemin gjyqësor. Gjithashtu, kjo e metë i ngarkohet autoriteteve dhe jo kërkuksve (shihni *Vlad dhe të tjerë kundër Rumanisë*, nr. 40756/06 dhe 2 të tjerë, § 133, 26 nëntor 2013, me referenca të mëtejshme).

30. Një vonesë e konsiderueshme prej pothuajse gjashtë vjet ndodhi si pasojë e pezullimit të procesit për shkak se pronësia e kërkuksit u kundërshtua në procese paralele (shihni paragrafin 10 më sipër dhe *Gjonbocari dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, nr. 10508/02, §§66–67, 23 tetor 2007, në lidhje me paaftësinë e autoriteteve të brendshme për të menaxhuar si duhet shumëfishimin e proceseve për të njëjtën çështje). Një tjetër vonesë prej një viti e gjysmë rezultoi nga pezullimi i dytë i procesit për të lejuar të paditurin që të bëjë një riorganizim të brendshëm (shihni paragrafët 14 dhe 15 më sipër).

31. Asnjë nga këto vonesa nuk i atribuohet kërkuksit dhe ndryshe nga pretendimi i qeverisë, ai konkluzion nuk ndryshohet nga fakti që proceset në fund u ndërprejnë për shkak se kërkuksi nuk u paraqit në gjykatë. As qeveria nuk parashtroi ndonjë shpjegim tjetër për vonesën.

2. Proceset në lidhje me kundërshtimin e pronësisë së kërkuksit

32. Procesi përkatës filloi më 22 tetor 2001 (shihni paragrafin 18 më sipër) dhe përfundoi më 24 tetor 2012 (shihni paragrafin 23 më sipër). Kështu, ai zgjati njëmbëdhjetë vjet përpara tre shkallëve të juridiksionit.

33. Gjykata vëren se vendimet e gjykatës së faktit dhe apelit nuk qëndruan përpara Gjykatës së Lartë (shihni paragrafët 20 dhe 29 më sipër). Pas vendimit të Gjykatës së Lartë për të kthyer çështjen, gjykatës së rrethit ju deshën dymbëdhjetë muaj të tjerë për të vendosur për çështjen (shihni paragrafin 21 më sipër). Tetëmbëdhjetë muaj më vonë, gjykata e apelit nxori vendimin e dytë dhe katër vjet e shtatë muaj më vonë Gjykata e Lartë dha vendimin përfundimtar për atë çështje (shihni paragrafët 22 dhe 23 më sipër).

34. Kërkuksi nuk kontribuoi në asnjë nga këto vonesa. Gjithashtu, çështja nuk ishte komplekse dhe qeveria nuk pretendoi të kundërtën.



3. Konkluzion

35. Pas shqyrtimit të të gjithë materialit të paraqitur, Gjykata nuk ka gjetur ndonjë fakt ose argument që mund të justifikojë kohëzgjatjen e përgjithshme të dy proceseve të përshkruara më sipër. Duke pasur parasysh praktikën e saj gjyqësore për temën, Gjykata vlerëson se në këtë çështje kohëzgjatja e proceseve ishte e tejkualuar dhe nuk plotësonte kërkesën e “kohës së arsyeshme”.

36. Prandaj, ankimi është i pranueshëm dhe tregon shkelje të paragrafit 1, të nenit 6, të Konventës.

II. ANKIMET E MBETURA

37. Gjithashtu, kërkuesi u ankua për shkelje të nenit 1, të Protokollit nr.1, të Konventës, në lidhje me qiradhënien e pronës së tij nga autoritetet tek palët e treta. Gjithashtu, sipas nenit 13 të Konventës, ai u ankua që nuk kishte pasur ndonjë zgjidhje efektive për ankimet e tij sipas Konventës.

38. Duke pasur parasysh faktet e çështjes, parashtrimet e palëve, dhe gjetjet e saj, Gjykata vlerëson se ka shqyrtuar pyetjen kryesore ligjore të ngritur në këtë çështje. Kështu ajo vëren që nuk ka pse të marrë një vendim të veçantë për këto ankime (shihni *Qendra për Burime Ligjore në emër të Valentin Câmpeanu kundër Rumanisë* [DHM], nr. 47848/08, § 156, GJEDNJ 2014).

III. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

39. Duke pasur parasysh dokumentet në dispozicion dhe praktikën e saj gjyqësore (shihni, në veçanti, *Luli dhe Mishgioni*, të dy të cituar më sipër),

Gjykata e vlerëson të arsyeshme dhënien e shumave të treguara në tabelën bashkëngjitur.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht,

1. *Shpall* të pranueshëm ankimin sipas paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës, në lidhje me tejkalimin e kohëzgjatjes së dy proceseve civile dhe *vendos* që nuk ka nevojë të shqyrtojë veçmas ankimet e kërkuarit, sipas nenit 13 të Konventës dhe nenit 1, të Protokollit nr. 1;

2. *Vendos* që është gjetur shkelje e paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës, në lidhje me tejkalimin e kohëzgjatjes së dy proceseve civile;

3. Vendos

a) që shteti i paditur t'i paguajë kërkuarit, brenda tre muajve, shumën e treguar në tabelën bashkëngjitur, që do të konvertohet në monedhën e shtetit të paditur me normën në fuqi në datën e shlyerjes;

që nga mbarimi i afatit tremujor të sipërpërmendur deri në shlyerje, të paguhet interes i thjeshtë për shumën e mësipërme sipas normës së njëjtë me normën marxhinale të kreditimit të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë përqindje.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 18 korrik 2024, sipas rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Viktoria Maradudina
ZËVENDËSKANCELARE
NË DETYRË

Peeter Roosma
PRESIDENT

SHTOJCË

Kërkesa që paraqet ankimin sipas paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës (tejkalimi i kohëzgjatjes së procesit civil)

Kërkesa nr. data e paraqitjes	Emri i kërkuarit, viti i lindjes	Fillimi i procesit	Mbarimi i procesit	Kohëzgjatja e plotë	Shuma e caktuar për dëmin jopasuror dhe kosto, dhe shpenzime për kërkuar (në euro) ¹
7568/08 18.1.2008	Minella PAPAKOSTANDINI	18.8.2000	23.1.2013	11 vjet e 10 muaj përpara katër shkallëve të juridiksionit	4.700
		22.10.2001	24.10.2012	11 vjet përpara tri shkallëve të juridiksionit	

¹ Plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet kërkuarit.



GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

**ÇËSHTJA SPAHIU DHE TË TJERË
KUNDËR SHQIPËRISË**

(*kërkesa nr. 79452/17 dhe 2 të tjera – shihni listën
bashkëngjitur*)

VENDIM

STRASBURG
18 korrik 2024

*Ky është vendim përfundimtar, por mund t'i
nënshtrohet rishikimit redaktorial.*

Në çështjen Spahiu kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
(Sek-sioni i Tretë), e mbledhur si Komitet i
përbërë nga:

Peeter Roosma, *President,*

Andreas Zünd,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë,*

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendëskancelare në
detyrë e Seksionit,*

pas diskutimit me dyer të mbyllura, më 27
qershor 2024,

mori vendimin e mëposhtëm, i cili miratohet
po në atë datë:

PROCEDURA

1. Çështja vjen pas depozitimit në Gjykatë të
kërkesave kundër Shqipërisë, sipas nenit 34 të
Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive
Themelore të Njeriut (Konventa), në data të
ndryshme të treguara në tabelën bashkëngjitur.

2. Qeveria Shqiptare (qeveria) u njoftua për
kërkesat.

FAKTET

3. Lista e kërkuessve dhe detajet përkatëse të
kërkesave jepen në tabelën bashkëngjitur.

4. Kërkuessit u ankuan për mosekzekutimin ose
ekzekutimin me vonesë të vendimeve të
brendshme. Kërkuessit në kërkesat nr. 79452/17
dhe 39155/18 paraqitën, gjithashtu, ankime të
tjera sipas dispozitave të Konventës.

LEGJISLACIONI

I. BASHKIMI KËRKESAVE

5. Duke pasur parasysh objektin e ngjashëm të
kërkesave, Gjykata e shih të përshtatshme t'i
shqyrtojë ato së bashku në një vendim të vetëm.

II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6
§ 1 TË KONVENTËS

6. Kërkuessit u ankuan kryesisht për
mosekzekutimin ose ekzekutimin me vonesë të
vendimeve të brendshme të dhëna në favor të
tyre. Shprehimisht ose në thelb ata u mbështetën
në paragrafin 1, të nenit 6 të Konventës.

7. Gjykata përsërit që ekzekutimi i një vendimi
të dhënë nga një gjykatë duhet të konsiderohet si
pjesë e pandarë e “seancës gjyqësore” për qëllime
të nenit 6. Gjithashtu, ajo i referohet praktikës
gjyqësore, në lidhje me mosekzekutimin ose
ekzekutimin me vonesë të vendimeve të
brendshme të formës së prerë (shihni *Hornsby
kundër Greqisë*, nr. 18357/91, 40, *Raporte të
vendimeve* 1997 II).

8. Në çështjet kryesuese *Qufaj Co sh.p.k. kundër
Shqipërisë* nr. 54268/00, 18 nëntor 2004 dhe *Gjyli
kundër Shqipërisë* nr. 32907/07, 29 shtator 2009,
Gjykata tashmë ka gjetur shkelje, në lidhje me
probleme të ngjashme me ato në këtë çështje. Së
fundmi, në *Elgakoti sh.p.k dhe të tjerë kundër
Shqipërisë* [Komiteti], nr. 63986/10 dhe 5 të tjera,
6 korrik 2023, dhe *Alsula dhe të tjerë kundër Shqipërisë*
[Komiteti], nr. 63975/10 dhe 3 të tjera,
30 nëntor 2023, Gjykata theksoi parimet e
caktuara, në lidhje me ekzekutimin me vonesë ose
mosekzekutimin e vendimeve të brendshme në
çështje të punësimit në Shqipëri.

9. Në kërkesën nr./79452/17, qeveria
parashtroi që vendimi i 25 marsit 2014, i Gjykatës
Administrative Tiranë, për të cilin kishin filluar
procedurat e ekzekutimit në korrik 2014, dhe që
urdhëronte transferimin e kërkuessit në një
pozicion tjetër, ishte ekzekutuar më në fund më 9
shkurt 2018, pra pothuajse në më shumë se tre vjet
e gjysmë.

10. Në kërkesën 39155/18, qeveria parashtroi
se vendimi i 30 marsit 2015, i Gjykatës
Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që
urdhëronte Inspektoratin Teknik Qendror që të
kthente kërkuessen në pozicionin e saj të
mëparshëm dhe t'i paguante pagat e prapambetura
nga data e shkarkimit deri në momentin e kthimit,
ishte ekzekutuar plotësisht më 18 dhjetor 2018.
Kërkuesses ju paguan pagat e prapambetura deri në
datën e daljes së saj në pension. Megjithatë, ajo
nuk u kthye në detyrë, sepse doli në pension sipas
kërkesave të brendshme. Prandaj, vendimi u
ekzekutua përafërsisht në njëzet muaj.



11. Kërkuesit, në kërkesat nr. 79452/17 dhe 39155/18, nuk i kundërshtuan parashtrimet e qeverisë.

12. Prandaj, Gjykata gjen që vendimet përkatëse në favor të kërkuesve ishin ekzekutuar ose nuk ishin më të ekzekutueshme, të paktën pjesërisht, në një datë specifike për shkak të ndryshimit të rrethanave (për detaje të mëtejshme shihni tabelën bashkë-ngjitur).

13. Në lidhje me kërkesën nr. 2248/19, qeveria vëren që vendimi i datës 28 prill 2014, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i cili urdhëronte Departamentin e Administratës Publike të kthente kërkuesen në pozicionin e saj të mëparshëm dhe t'i paguante pagat e prapambetura nga momenti i shkarkimit deri në momentin e kthimit, ishte ekzekutuar pjesërisht më 4 korrik 2018, kur ajo u emërua në një pozicion të ri, dhe pjesërisht më 2 qershor 2022, kur autoritetet i paguan të gjitha pagat e prapambetura. Qeveria i paraqiti Gjykatës një vendim përmbartimor për përfundimin e ekzekutimit sepse vendimi ishte ekzekutuar plotësisht.

14. Më 28 shkurt 2024, kërkuesja njoftoi Gjykatën që ajo nuk është kthyer akoma në detyrë dhe që duhej të kishte marrë pagat e prapambetura, dhe t'i ishin ofruar pozicione që përputheshin me ato të përcaktuara në vendimin e 28 prillit 2014. Megjithatë, kërkuesja nuk parashtroi që kishte kundërshtuar vendimin e përmbartimit për përfundimin e procedurave të ekzekutimit sepse e kishte konsideruar vendimin plotësisht të ekzekutuar.

15. Në këto rrethana dhe nisur nga fakti që kërkuesja nuk kundërshtoi në nivel të brendshëm vendimin e përmbartimit për përfundimin e ekzekutimit, Gjykata pranon parashtrimet e qeverisë që procedura e ekzekutimit kishte përfunduar më 2 qershor 2022, kur kërkueses i ishte paguar pjesa e mbetur e pagave të prapambetura dhe përmbartuesi kishte përfunduar procedurën e ekzekutimit për ekzekutimin e plotë. Prandaj, procedura e ekzekutimit zgjati pothuajse pesë vjet.

16. Pas shqyrtimit të materialit që ju paraqit dhe duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në çështjet kryesuese *Qufaj Co sh.p.k.* dhe *Gjyli*, të dyja të cituara më sipër, Gjykata nuk ka gjetur ndonjë fakt ose argument që mund ta bindë atë të dalë në

një konkluzion të ndryshëm për pranueshmërinë dhe themelin e ankimeve të tyre. Duke pasur parasysh praktikën e saj gjyqësore për temën, Gjykata vlerëson se në këtë çështje autoritetet nuk i kanë bërë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të ekzekutuar në kohë vendimet në favor të kërkuesve.

17. Prandaj, këto ankime janë të pranueshme dhe tregojnë shkelje të paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës.

III. ANKIMET E MBETURA

18. Kërkuesit, në kërkesat nr. 79452/17 dhe 39155/18, u ankuan edhe sipas nenit 13 të Konventës, për mungesën e zgjidhjes së brendshme për të siguruar zbatimin e vendimeve të brendshme në favor të tyre. Duke pasur parasysh faktet e çështjes, parashtrimet e palëve dhe gjetjet e saj më sipër, Gjykata vlerëson se ka shqyrtuar pyetjen kryesore ligjore të ngritur në këto kërkesa. Kështu ajo gjen që nuk ka pse të marrë një vendim të veçantë për ankimet e mbetura të kërkuesve (shihni *Qendra për Burime Ligjore në emër të Valentin Câmpeanu kundër Rumanisë* [DHM] nr. 47848/08, § 156, GJEDNJ 2014, dhe *Habilaj kundër Shqipërisë* [Komiteti] nr. 2480/10, § 14, 15 shtator 2022).

IV. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

19. Duke pasur parasysh dokumentet në dispozicion dhe praktikën e saj gjyqësore (shihni, në veçanti, *Qufaj Co sh.p.k.*, cituar më sipër, §§ 46–48, dhe *Gjyli*, gjithashtu të cituar më sipër, §§ 62–76), Gjykata e vlerëson të arsyeshme dhënien e shumave të treguara në tabelën bashkëngjitur.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht,

1. *Vendos* të bashkojë kërkesat;

2. *Shpall* të pranueshme ankimet, në lidhje me ekzekutimin me vonesë të vendimeve të brendshme, sipas nenit 6 të Konventës dhe *vendos* që nuk ka nevojë të shqyrtojë ankimet e mbetura të ngritura në kërkesat nr. 79452/17 dhe 39155/18;

3. *Vendos* që këto kërkesa tregojnë shkelje të paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës, në lidhje me ekzekutimin me vonesë të vendimeve të brendshme;

*4. Vendos*

a) që shteti i paditur t'i paguajë kërkesve, brenda tre muajve, shumën e treguar në tabelën bashkë-ngjitur, që do të konvertohet në monedhën e shtetit të paditur, me normën në fuqi në datën e shlyerjes;

që nga mbarimi i afatit tremujor të sipërpërmendur deri në shlyerje, të paguhet interes i thjeshtë për shumat e mësipërme, sipas normës së njëjtë me normën marxhinale të kreditimit të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë përqindje.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 18 korrik 2024, sipas rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Viktoriya Maradudina
ZËVENDËSKANCELARE
NË DETYRË

Peeter Roosma
PRESIDENT



SHTOJCË

Lista e kërkesave që paraqesin ankimet sipas paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës
(mosekzekutimi ose ekzekutimi me vonesë i vendimeve të brendshme)

Nr.	Kërkesa nr. data e paraqitjes	Emri i kërkuesit, viti i lindjes	Emri dhe vendndodhja e përfaqësuesit	Legjislacioni i brendshëm përkatës	Data e fillimit të periudhës së mosekzekutimit	Data e mbarimit të periudhës së mosekzekutimit, kohëzgjatja e procedurave të ekzekutimit	Dëshmipërblimi i brendshëm	Shuma e dhënë për dëmin jopasuror për kërkues (në euro) ²	Shuma e dhënë për kosto dhe shpenzime për kërkesën (në euro) ³
1.	79452/17 10.11.2017	Sadik SPAHIU 1979	Sheta Xhevdet Tiranë	Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, 25.3.2014	29.7.2014	9.2.2018 3 vite dhe 6 muaj, dhe 12 ditë	Gjykata Administrative e Tiranës <i>via</i> vendimin nr./ 1200, të 25 marsit 2014, urdhëroi shfuqizimin e vendimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në lidhje me transferimin e kërkuesve në një pozicion dhe qytet tjetër.	2.100	250
2.	39155/18 9.8.2018	Marjeta ARMIRI 1957		Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, 30.3.2015	12.4.2017	18.12.2018 1 vite dhe 8 muaj, dhe 7 ditë	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 1696, të 30 marsit 2015, urdhëroi Inspektoratin Teknik Qendror që të kthente kërkuesen në pozicionin e saj të mëparshëm dhe t'i paguante asaj pagat e prapambetura nga data e shkarkimit deri në kthimin e saj.	900	-

² Plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet kërkuesve.

³ Plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet kërkuesve.



Nr.	Kërkesa nr. data e paraqitjes	Emri i kërkuesit, viti i lindjes	Emri dhe vendndodhja e përfaqësuesit	Legjislacioni i brendshëm përkatës	Data e fillimit të periudhës së mosekzekutimit	Data e mbarimit të periudhës së mosekzekutimit, kohëzgjatja e procedurave të ekzekutimit	Dëshmipërblimi i brendshëm	Shuma e dhënë për dëmin jopasuror për kërkues (në euro) ²	Shuma e dhënë për kosto dhe shpenzime për kërkesën (në euro) ³
3.	2248/19 3.1.2019	Valbona SHEGANI - VOCAJ 1977	Mujo - Bodo Vjosa Tiranë	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, 21.9.2015	11.7.2017	2.6.2022 4 vite dhe 10 muaj, dhe 23 ditë	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin e 28 prillit 2014, urdhëroi Departamentin e Administratës Publike që të kthente kërkuesen në pozicionin e mëparshëm dhe t'i paguante asaj pagat e prapambetura nga data e shkarkimit deri në kthimin e saj në detyrë. Vendimi u ndryshua nga Gjykata Administrative e Apelit më 21.9.2015, me urdhurin e kthimit në një pozicion të ngjashëm, nëse nuk mundësohej kthimi në pozicionin e mëparshëm.	3.000	250



GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 29264/16
Piro KUKO kundër Shqipërisë
dhe 3 kërkesa të tjera
(shihni tabelën bashkëngjitur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 13 qershor 2024 si Komitet i përbërë nga:

Peeter Roosma, *President*,

Andreas Zünd,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*,

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendëskancelare në detyrë e Seksionit*,

Duke pasur parasysh kërkesat e mësipërme të depozituara në datat e ndryshme të treguara në tabelën bashkëngjitur,

Duke pasur parasysh deklaratat e paraqitura nga Qeveria e paditur ku Gjykatës i kërkohet të çregjistrojë kërkesat nga lista e çështjeve,

Pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

FAKTE DHE PROCEDURA

Lista e kërkesve jepet në tabelën bashkëngjitur.

Ankimet e kërkesve sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës në lidhje me tejkalimin e kohëzgjatjes së procesit civil i janë komunikuar qeverisë shqiptare (“Qeveria”).

LEGJISLACIONI

Duke pasur parasysh objektin e ngjashëm të kërkesave, Gjykata e sheh të përshtatshme t’i shqyrtojë ato së bashku në një vendim të vetëm.

Pas komunikimit të çështjeve, Qeveria informoi Gjykatën që ajo propozonte të bënte një deklaratë të njëanshme me qëllim zgjidhjen e problemeve të ngritura në këto ankime. Më tej, ajo i kërkoj Gjykatës të çregjistronte kërkesën në përputhje me nenin 37 të Konventës.

Qeveria pranoi tejkalimin e kohëzgjatjes së procesit civil. Ajo u ofrua që t’i paguajë kërkesve shumat e detajuara në tabelën bashkëngjitur dhe ftoi Gjykatën të çregjistrojë kërkesat nga lista e çështjeve në përputhje me paragrafin 1(c) të nenit 37 të Konventës. Shumat duhet të konvertohen në monedhën e Shtetit të paditur me kursin e

këmbimit të datës së pagesës dhe duhet të paguhet brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës. Në rast të mospagimit të këtyre shumave brenda periudhës tremujore të lartpërmendur, Qeveria merr përsipër të paguajë një interes të thjeshtë nga mbarimi i kësaj periudhe deri në momentin e shlyerjes, me një normë të barabartë me normën e marxhinale të kreditimit të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë përqindje.

Pagesa do të përbëjë zgjidhjen përfundimtare të çështjeve.

Kërkesve ju dërguan kushtet e deklaratave të njëanshme të Qeverisë disa javë përpara datës së këtij vendimi. Gjykata nuk ka marrë përgjigje nga kërkesit për pranimin e kushteve të deklaratave të njëanshme.

Gjykata vëren që neni 37 § 1 (c) e mundëson çregjistrimin e një çështjeje nga lista e saj:

“... për çdo arsye tjetër që, sipas Gjykatës, nuk justifikon vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës”.

Kështu, ajo mund të çregjistrojë kërkesën sipas nenit 37 § 1 (c) bazuar në një deklaratë të njëanshme nga një Qeveri e paditur edhe nëse kërkesit dëshirojnë vazhdimin e shqyrtimit të çështjes (shihni në veçanti, *Tahsin Acar kundër Turqisë* vendimi (kundërshtime paraprake) [DHM], nr. 26307/95, §§ 75-77, GJEDNJ 2003-VI).

Gjykata ka krijuar praktikë gjyqësore të qartë dhe të gjerë në lidhje me ankimet për tejkalimin e kohëzgjatjes së proceseve civile (shihni për shembull, *Luli dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, nr. 64480/09 dhe 5 të tjera, 1 prill 2014, dhe *Mishgjoni kundër Shqipërisë*, nr. 18381/05, 7 dhjetor 2010).

Duke pasur parasysh pranimet që përmban deklarata e Qeverisë, si edhe shumën e propozuar të kompensimit – që është në përputhje me shumat e dhëna në çështje të ngjashme – Gjykata vlerëson që nuk justifikohet më tej vazhdimi i shqyrtimit të kërkesave (neni 37 § 1 (c)).

Nisur nga vlerësimet e mësipërme, Gjykata është e bindur që respektimi i të drejtave të njeriut siç përcaktohet në Konventë dhe protokollet e saj nuk kërkon që ajo të vazhdojë të shqyrtojë kërkesat (neni 37 § 1 *in fine*).

Në përfundim, Gjykata thekson që nëse Qeveria nuk përmbush kushtet e deklaratës së saj të njëanshme, kërkesat mund të futen përsëri në listë në përputhje me paragrafin 2 të nenit 37 të



Konventës (shihni *Josipović kundër Serbisë* (vendim), nr. 18369/07, 4 mars 2008).

Nisur nga sa më sipër, është me vend që çështja të çregjistrohet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht, *vendos* të bashkojë kërkesat; *mban parasysh* kushtet e deklaratave të Qeverisë së paditur dhe të rregullimeve për të siguruar përmbushjen e angazhimeve të përmendura në to;

vendos të çregjistrojë kërkesat nga lista e saj e çështjeve në përputhje me nenin 37 § 1 (c) të Konventës.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 4 korrik 2024.

Viktoriya Maradudina
ZËVENDËSKANCELARE
NË DETYRË

Peeter Roosma
PRESIDENT

SHTOJCË

*Lista e kërkesave që paraqesin ankimet sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës
(Tejkalimi i kohëzgjatjes së procesit civil)*

Nr.	Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkuarit Viti i lindjes	Emri dhe vendndodhja e përfaqësuesit	Data e marrjes së deklaratës së Qeverisë	Data e marrjes së komenteve të kërkuarve, nëse ka	Shuma e caktuar për dëmin jo pasuror dhe kosto dhe shpenzime për kërkuar (në euro) ⁴
1	29264/16 15.6.2016	Piro KUKO 1948		15.9.2023	31.10.2023	1.000
2	56999/16 26.9.2016	Levent BREGU 1977	Bregu Marjana Berat	15.9.2023	-	3.000
3	547/17 20.12.2016	Keti ZGURI 1964		15.9.2023	-	1.200
4	37653/18 23.7.2018	Sokol CUKANI 1972	Meneri Suela Tiranë	15.9.2023	-	1.000

VENDIM

Nr. 54, datë 9.7.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj kryetare;
Marsida Xhaferllari anëtare;
Fiona Papajorgji anëtare;
Elsa Toska anëtare;
Sonila Bejtja anëtare;
Sandër Beci anëtar;
Ilir Toska anëtar;
Genti Ibrahimimi anëtar;
Marjana Semini anëtare,

me sekretare Enina Kotoni, në datën 27.5.2024, mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen nr. 2 (Nj) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë,

përfaqësuar nga deputetët Gazmend Bardhi dhe Dhurata Çupi dhe avokati Marash Logu.

SUBJEKT I INTERESUAR: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Mimoza Arbi dhe Antonela Veshi, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i ligjit nr. 106, datë 21.12.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8891, datë 2.5.2002, ‘Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit’”.

Pezullimi i zbatimit të ligjit nr. 106, datë 21.12.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8891, datë 2.5.2002, ‘Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit’”.

BAZA LIGJORE: Nenet 77, pika 2, 131, pika 1, shkronja “a” dhe 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 25 i Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Rregullorja*); nenet 27, 49, 50 dhe 51, të ligji nr. 8577, datë 10.2.200 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

⁴ Plus çdo taksë që mund t’u ngarkohet kërkuarve.



GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Tre deputetë të Kuvendit, bazuar në nenin 81, pika 1, të Kushtetutës, kanë depozituar tri nisma ligjore për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit” (*ligji për komisionet hetimore*). Qëllimi i ndryshimeve të propozuara ishte zbatimi efektiv i këtij ligji, përshtatja e tij me qëndrimet e Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) për komisionet hetimore, si dhe përcaktimi i një kornize të qartë ligjore për veprimtarinë e këtyre komisioneve, për sa u përket objektit, çështjeve të veçanta dhe parimeve kushtetuese që duhen respektuar për ngritjen e tyre.

2. Në seancën plenare të datës 21.12.2023, Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 106/2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8891, datë 2.5.2002, ‘Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit’” (*ligji ndryshues*), sipas nismës së propozuar nga njëri prej deputetëve nismëtarë. Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 13, datë 19.1.2024 dhe ka hyrë në fuqi në datën 3.2.2024.

3. Në datën 1.3.2024, kërkuari, një grup prej 33 deputetësh të Kuvendit, në cilësinë e subjektit kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve, i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të ligjit ndryshues, duke pretenduar se dispozitat e tij sjellin pasoja në të drejtën kushtetuese të pakicës parlamentare për ngritjen e komisioneve hetimore parlamentare, në kundërshtim me nenin 77, pika 2, të Kushtetutës, si dhe kanë kërkuar edhe pezullimin e zbatimit të tij deri në hyrjen në fuqi të vendimit përfundimtar të Gjykatës.

4. Në datën 8.3.2024, përfaqësuesi i kërkuarit ka paraqitur përpara Gjykatës kërkesë për përshejtimin e shqyrtimit të kësaj çështjeje, duke

argumentuar se për shkak të së drejtës së pakicës parlamentare të prekur nga dispozitat e kundërshtuara, ashtu edhe një prej funksioneve themelore të Kuvendit, ai i kontrollit efektiv të qeverisjes, çështja mbart një interes të veçantë publik. Në mbështetje të kësaj kërkesë është parashtruar edhe se në Kuvend është depozituar një kërkesë për ngritjen e një komisioni hetimor, që mund të preket nga zbatimi i dispozitave të ligjit ndryshues, ashtu si edhe kërkesat e ardhshme, por edhe se legjislatura aktuale është në vitin e fundit dhe zgjatja në kohë e shqyrtimit të çështjes mund të dëmtojë efektivisht hetimin parlamentar të vënë në lëvizje nga pakica parlamentare.

5. Me vendimin e datës 18.4.2024, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

6. **Kërkuari**, në mënyrë të përmblodhur, ka parashtruar:

6.1 *Për pezullimin e zbatimit të ligjit ndryshues:*

Zbatimi i ligjit prek të drejtat e deputetëve të opozitës (*jo më pak se një e katërta e deputetëve*). Aktualisht në Kuvend është depozituar një kërkesë për ngritjen e një komisioni hetimor për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike, pranimi ose refuzimi i së cilës është tërësisht në diskrecionin e shumicës parlamentare, por edhe nëse kërkesa pranohet, hetimi parlamentar do të pengohet efektivisht, duke cenuar jo vetëm të drejtën kushtetuese të pakicës parlamentare, por edhe një prej funksioneve themelore të Kuvendit.

6.2 *Për themelin e çështjes:*

6.2.1 *Nuk është respektuar procedura e miratimit të dispozitave objekt kërkesë*, pasi në kundërshtim me nenin a/5 të rregullores, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (*Komisioni i Ligjeve*), nëpërmjet platformës *zoom*, ka vendosur miratimin vetëm me praninë e deputetëve të shumicës parlamentare. Shqyrtimi në seancë plenare nuk i është nënshtruar asnjë debati, diskutimi ose konsensusi të këtyre ndryshimeve që prekin një të drejtë kushtetuese të opozitës, dhe, gjithashtu, është miratuar pa qenë pjesë e kalendarit të punimeve të miratuar nga Konferenca e Kryetarëve, vetëm me votat e shumicës



parlamentare. Opozita parlamentare kishte depozituar, gjithashtu, një projektligj për disa shtesa dhe ndryshime po në ligjin për komisionet hetimore, i cili nuk është përfshirë për shqyrtim në komisionet parlamentare dhe në seancë plenare.

6.2.2 *Është cenuar e drejta e pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor*, në kundërshtim me nenin 77, pika 2, të Kushtetutës, pasi dispozitat e ligjit ndryshues kanë reflektuar pjesërisht standardet e jurisprudencës kushtetuese, duke mos vendosur asnjë rregull për standardin kushtetues të “*formulimit alternativ*”, që ka të bëjë me detyrimin e shumicës që të mos debatojë dhe pengojë ngritjen e komisionit hetimor, por nëse ajo vlerëson se objekti i propozuar i hetimit cenon parimet kushtetuese, ka detyrimin të ofrojë formulim alternativ të tij. Kjo mungesë i jep mundësi shumicës parlamentare të vlerësojë në diskrecionin e saj përmbushjen ose jo të parimeve kushtetuese dhe pa bërë ndonjë përpjekje për konsensus, të rrëzojë kërkesat për ngritjen e komisioneve hetimore.

6.2.3 *Është cenuar e drejta për transparencë dhe llogaridhënie*, pasi neni 6 i ligjit ndryshues, i cili ka ndryshuar nenin 12 të ligjit për komisionet hetimore, bie ndesh me qëllimin kryesor që ka ngritja e një komisioni hetimor, konkretisht njohjen dhe verifikimin e një fenomeni, ngjarjeje ose veprimtarie të caktuar. Në thelb të veprimtarisë së komisioneve hetimore qëndron transparenca për median, opinionin publik dhe qytetarët ndaj zhvillimi i mbledhjeve me dyer të mbyllura vetëm me votat e shumicës është në kundërshtim me këto parime. Shumica do të vlerësojë se kur duhet të bëhet transparencë për aspekte të caktuara të veprimtarisë së komisionit dhe në cilat raste do të veprohet në mungesë transparence, ndërkohë që kjo dispozitë duhej të kufizohej vetëm në rastet kur të dhënat e trajtuara përbëjnë informacion të klasifikuar “*sekret shtetëror*”, siç ka qenë praktika e përhershme e punës së komisioneve. Në të kundërt, një vendimarrje e tillë duhet t'i nënshtrohet një shumice të cilësuar.

6.2.4 *Është cenuar e drejta e pakicës parlamentare për hetim efektiv*, pasi dispozitat e ligjit ndryshues kanë vendosur hetimin parlamentar nën kontrollin e shumicës pasi, edhe në rast të ngritjes së komisionit hetimor, ushtrimi i kontrollit efektiv parlamentar bëhet i pamundur për sa kohë shumica parlamentare vendos për zhvillimin e mbledhjeve me dyer të mbyllura, për marrjen e provave dhe për thirrjen e dëshmitarëve. Neni 7 i ligjit ndryshues, që ka

ndryshuar nenin 13 të ligjit për komisionet hetimore, bën që marrja e provave dhe thirrja e dëshmitarëve të ngelen në vullnetin e shumicës parlamentare, e cila ka edhe numrin më të madh të anëtarëve në komision. Një mekanizëm i tillë do të zhbëjë të drejtën e pakicës parlamentare për kryerjen e një hetimi efektiv, pasi të dhënat dhe dëshmitë që do të administrohen nga komisioni do të jenë tërësisht në diskrecionin e shumicës, në ndryshim kjo nga përcaktimet e mëparshme të këtij neni, që parashikonte se marrja e provave dhe thirrja e dëshmitarëve nga çdo anëtar i komisionit pranohej pa votim. Kurse neni 9 i ligjit ndryshues kërkon marrjen e lejes nga prokuroria ose gjykata për pyetjen si dëshmitarë të personave që janë thirrur ose do të thirren nga organet e drejtësisë për proceset penale. Nga ana tjetër, dhënia e së drejtës dëshmitarit për të refuzuar përgjigjen, në çdo rast që ai vlerëson se vetë ose persona të lidhur me të mund të ekspozohen ndaj hetimeve, mund të përdoret për të refuzuar transparencën dhe llogaridhënien.

7. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka propozuar:

7.1 *Për pezullimin e zbatimit të ligjit objekt kërkesë:*

Pretendimi për pezullimin e zbatimit të ligjit të kundërshtuar nuk përfshihet në asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 45, i ligjit nr. 8577/2000, për sa kohë që dispozitat e kundërshtuara nuk cenojnë parimin kushtetues të sigurisë juridike dhe as nga kërkuessit nuk është ngritur ndonjë argument ose pretendim për shkelje të këtij parimi.

7.2 *Për themelin e pretendimeve:*

7.2.1 Pretendimet në drejtim të procedurës së miratimit të aktit ndryshues janë të pabazuara. Nismat ligjore të të tre deputetëve për disa shtesa e ndryshime në ligjin për komisionet hetimore janë futur automatikisht në programin e punës së Kuvendit. Në programin e veprimtarisë së Komisionit të Ligjeve, si dhe në rendin e ditës të mbledhjes së datës 19.12.2023, janë përfshirë nismat e tre deputetëve. Duke qenë se ato propozonin ndryshime për të njëjtin akt ligjor duhej të procedohej me bashkimin e tyre. Në kushtet kur dy nga deputetët nismëtarë nuk janë paraqitur, dhe në mungesë të prezantimit të propozimeve të tyre, konform rregullave, Komisioni i Ligjeve kishte detyrimin të procedonte vetëm me nismën e paraqitur nga njëri prej tyre. Për sa i përket zhvillimit të mbledhjes në platformën *zoom*, kjo është bërë për



shkak të pamundësisë së zhvillimit të saj fizikisht dhe sipas nenit a/5 të Rregullores së Kuvendit.

7.2.2 Në lidhje me *të drejtën e pakicës parlamentare për ngritjen e një komisioni hetimor*, dispozitat e kundërshtuara nuk cenojnë nenin 77, pika 2, të Kushtetutës. Në rastet e kërkesave të depozituara nga pakica parlamentare, anëtarët e Konferencës së Kryetarëve kanë vlerësuar nëse ato lidhen me “*çështje të veçantë*”, pra çështje me rëndësi të veçantë shtetërore/publike dhe në vijim është kërkuar rishikimi i objektit të veprimtarisë sipas jurisprudencës së Gjykatës. Diskutimi parlamentar është fokusuar në respektimin e parimeve kushtetuese në objektin e veprimtarisë së komisionit hetimor, me qëllim për të gjetur konsensus deri në arritjen e një vendimmarrje. Interpretimi që Gjykata i ka bërë nenit 77, pika 2, të Kushtetutës në lidhje me kuptimin e shprehjes “*çështjet e veçanta*”, është reflektuar në ndryshimet e ligjit për komisionet parlamentare.

7.2.3 Në lidhje me *të drejtën për transparencë dhe llogaridhënie*, ndryshimet e ligjit për komisionet hetimore lidhur me zhvillimin e mbledhjes së komisionit me dyer të mbyllura nuk prekin përcaktimet e përgjithshme që parashikojnë se mbledhjet, si rregull, janë të hapura. Edhe nëse ligji i ndryshuar nuk do të parashikonte rastet e zhvillimit të mbledhjeve me dyer të mbyllura, kjo do të ndodhte sa herë që komisioni do të ndodhej në kushtet e parashikuara nga shkronja “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të nenit 6 të ligjit ndryshues.

7.2.4 Kjo dispozitë është në përputhje të plotë me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, parashikimet e Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe Rregulloren e Kuvendit. Parashikimet e nenit 7 të ligjit ndryshues, të cilat kërkojnë marrjen e vendimeve të ndërmjetme me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të komisionit, korrigjojnë një kontradiktë të ligjit të vjetër, i cili, nga njëra anë, parashikonte se provat merren me vendim të ndërmjetëm dhe, nga ana tjetër, se çdo anëtar i komisionit ka të drejtë të kërkojë çfarëdolloj prove. Marrja e provave dhe thirrja e dëshmitarëve me vendim të ndërmjetëm disiplinon punën e komisionit dhe shmang kontradiktat në marrjen e provave.

7.2.5 Në lidhje me *të drejtën e pakicës parlamentare për betim efektiv të lidhur me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve*, parashikimet e nenit 9 të ligjit ndryshues në lidhje me thirrjen e dëshmitarëve, janë reflektim i

praktikës parlamentare të funksionimit të komisioneve hetimore, gjatë së cilës është konstatuar se komisionet dalin jashtë natyrës së tyre dhe konfundojnë objektin e hetimit parlamentar me atë të hetimit penal, ashtu sikundër kjo mënyrë sjelljeje ka bërë që Kuvendi të shfaqet si një organ që ka epërsi ndaj të tjerëve. Dëshmitarët mund të refuzojnë të japin informacion në përgjigje të pyetjeve, nëse kjo do t'i ekspozonte ata ose personat e lidhur ndaj rrezikut të hetimit, sipas një procesi të rregullt ligjor.

III

Procesi në gjykimin kushtetues

A. Për masën e pezullimit

8. Kërkuesi, së bashku me kërkesën për shfuqizimin e ligjit ndryshues ka kërkuar edhe pezullimin e zbatimit të tij deri në dhënien e vendimit përfundimtar nga Gjykata. Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës, me vendimin e datës 23.4.2024, ka vendosur njëzëri shqyrtimin e kërkesës për pezullim në seancë plenare dhe shqyrtimin e çështjes me përparësi.

9. Për të mbështetur kërkesën për pezullimin e zbatimit të ligjit, kërkuesi ka pretenduar se zbatimi i tij prek të drejtat e deputetëve të opozitës për ngritjen e komisioneve hetimore, por edhe një prej funksioneve themelore të Kuvendit. Ai ka parashtruar se pakica parlamentare ka depozituar në Kuvend një kërkesë për ngritjen e komisionit hetimor për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike, e cila, për shkak të ligjit ndryshues, ka mbetur tërësisht në diskrecionin e shumicës parlamentare. Edhe nëse komisioni hetimor do të ngrihet nga Kuvendi, ligji ndryshues pengon efektivitetin e hetimit parlamentar.

10. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se kërkesa për pezullim është e pabazuar, pasi nuk jemi në kushtet e cenimit të parimeve kushtetuese dhe kërkuesi nuk ka ngritur ndonjë argument ose pretendim në këtë drejtim. Sipas tij, kërkesa për pezullim nuk përfshihet në asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 45, i ligjit nr. 8577/2000.

11. Sipas nenit 45, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata, kryesisht ose me kërkesë të palëve, kur vlerëson se zbatimi i ligjit ose aktit mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërore, shoqërore ose të individëve, sipas rastit, me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve ose në seancë plenare, urdhëron



pezullimin e tij. Pezullimi vazhdon derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës të hyjë në fuqi. Vlerësimi i Gjykatës për të vendosur masën e pezullimit ka të bëjë ekskluzivisht me rëndësinë (seriozitetin) dhe pariparueshmërinë e pasojave që vendimi i kundërshtuar mund të prodhojë deri sa Gjykata të shprehet në mënyrë përfundimtare për themelin e kërkesës. Në kushtet kur pezullimi është një masë e jashtëzakonshme, vendosja e tij lidhet me vlerësimin e pasojave ose efekteve të zbatimit të aktit, të cilat duhet jo vetëm të jenë reale, pra në realizim e sipër, por edhe të rënda, në atë masë që shkojnë tej masës normale të kufizimit, në veçanti në pikëpamje të urgjencës.

12. Gjykata vëren, fillimisht, se ajo ka pranuar kërkesën e paraqitur nga përfaqësuesi i kërkuarit për shqyrtimin e kësaj çështjeje me përparësi, për shkak të interesit dhe rëndësisë që ajo mbart. Duke mbajtur në konsideratë këtë fakt, si dhe pretendimet ku kërkuari ka mbështetur kërkesën për pezullimin e zbatimit të ligjit ndryshues, të cilat, në thelb, janë të njëjta me ato të kërkesës për përshpejtim, Gjykata arriti në përfundimin se në rastin konkret nuk plotësohen kërkesat e nenit 45 të ligjit nr. 8577/2000, në drejtim të pariparueshmërisë së pasojave dhe urgjencës për ndërhyrje, për sa kohë kërkuari nuk ka arritur të provojë pasojat e rënda dhe reale të ardhura nga zbatimi i aktit objekt kërkesë. Për rrjedhojë, Gjykata, me shumicë votash, vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullim si të pabazuar.⁵

IV

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

B. Për legjitimitimin e kërkuarit

13. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me vënien në lëvizje të një procesi kushtetues. Kushtetuta, në nenin 134, pika 1, të saj ka përcaktuar në mënyrë shteruese rrethin e subjekteve kushtetuese që legjitimohen për të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues. Subjekti kushtetues, jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit, është i parashikuar në nenin 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës dhe nenin 49, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, të cilat i njohin atij të drejtën për nisjen e kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së

ligjit, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës. Gjykata ka pranuar se interesi publik i këtyre funksionarëve publikë është i prezumuar, pasi një kërkesë e tyre vë në lëvizje një kontroll abstrakt e objektiv të aktit normativ dhe interesi që kërkohet të mbrohet lidhet me respektimin e parimeve kushtetuese dhe me funksionimin e rregullt të shtetit të së drejtës (*shih vendimet nr. 35, datë 15.6.2023; nr. 18, datë 7.7.2022; nr. 55, datë 27.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Mbi bazën e këtij standardi, Gjykata çmon se kërkuari, një grup prej 33 deputetësh të Kuvendit, në cilësinë e subjektit kushtetues, jo më pak se një të pestës së deputetëve, legjitimohet *ratione personae* për vënien në lëvizje të kontrollit abstrakt të pajtueshmërisë me Kushtetutën të ligjit ndryshues.

15. Për sa i takon legjitimitimit *ratione temporis*, Gjykata konstaton se ligji ndryshues është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 13, datë 19.1.2024 dhe ka hyrë në fuqi në datën 3.2.2024, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 1.3.2024, pra brenda afatit dyvjeçar të parashikuar nga neni 50, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000.

16. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuarit janë ngritur si në drejtim të procedurës parlamentare për miratimin e ligjit ndryshues, ashtu edhe në drejtim të përmbajtjes së tyre, për sa i përket ushtrimit të së drejtës kushtetuese të pakicës parlamentare për të kërkuar ngritjen e një komisioni hetimor për të shqyrtuar një çështje të veçantë.

17. Për sa i përket pretendimit për mosrespektimin e procedurës së miratimit të ligjit ndryshues, kërkuari e ka lidhur me mosrespektimin e parashikimeve të nenit 5/a të Rregullores, duke parashtruar se shqyrtimi i projektligjit është realizuar nga Komisioni i Ligjeve në mbledhje online nëpërmjet platformës *zoom*, vetëm me praninë e deputetëve të shumicës parlamentare, si dhe me shqyrtimin në seancë plenare pa iu nënshtruar asnjë debati, diskutimi ose konsensusi, si dhe pa qenë pjesë e kalendarit të punimeve të miratuar nga Konferenca e Kryetarëve për periudhën 27.11.2023–22.12.2023, duke u miratuar vetëm me votat e shumicës parlamentare.

18. Gjykata në jurisprudencën e saj, bazuar në parimin e autonomisë parlamentare, ka theksuar se

⁵ Gjyqtare Sonila Bejtja votoi për pranimin e kërkesës për pezullim.



mosrespektimi i Rregullores e bën veprimtarinë parlamentare antikushtetuese vetëm nëse janë prekur dispozita të nivelit kushtetues që gjejnë pasqyrim në të, ndërsa për çështje të tjera Rregullorja nuk mund të jetë objekt kontrolli kushtetues (*shih vendimet nr. 48, datë 19.6.2024; nr. 35, datë 10.10.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Mbi bazën e këtij standardi, Gjykata thekson se ajo ka kompetencë të shqyrtojë pretendimet në drejtim të procedurës së ndjekur nga Kuvendi për miratimin e ligjeve, vetëm nëse ato kanë të bëjnë me aspekte të nivelit kushtetues, duke mos u ndalur në aspektet e tjera me natyrë të përgjithshme. Lidhur me këto të fundit, Gjykata vë në dukje se sipas parimit të autonomisë parlamentare, Kuvendi ka të drejtën ekskluzive për të rregulluar organizimin e tij, rolin e deputetëve, strukturën dhe procedurat e brendshme (*shih vendimin nr. 1, datë 16.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Referuar të dhënave të disponueshme në faqen zyrtare të Kuvendit rezulton se në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve të datës 23.11.2023, është miratuar kalendari i punimeve të Kuvendit për periudhën 27 nëntor–22 dhjetor 2023, në të cilin janë përfshirë nismat e paraqitura nga deputetët. Sipas raportit të Komisionit të Ligjeve të datës 19.12.2023, ai ka marrë në shqyrtim vetëm nismën e paraqitur nga deputetja e shumicës parlamentare, e cila ka qenë e pranishme në mbledhje dhe ka prezantuar projektligjin me ndryshimet e propozuara prej saj. Për dy nismat e tjera, të paraqitura nga deputetët e pakicës, Komisioni i Ligjeve është shprehur se, bazuar në nenet 26, pika 7, 27, pika 5/1, 69 dhe 71, të Rregullores do të procedohej me shqyrtimin e të tria nismave, dhe duke qenë se ato përmbanin propozime për ndryshime në të njëjtin akt ligjor, ka vendosur të procedohej me bashkimin e tyre. Në vijim për shkak të mosparaqitjes së dy nismëtarëve të pakicës, për rrjedhojë në mungesë të prezantimit të propozimeve të tyre, komisioni ka proceduar me marrjen në shqyrtim vetëm të nismës së paraqitur nga deputetja e pranishme, e shumicës parlamentare (*shih faqen 8 të raportit të Komisionit të Ligjeve*).

21. Ligji ndryshues i ligjit për komisionet hetimore, pas miratimit, u dekretua nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 15, datë 18.1.2024, i cili, në cilësinë e organit interpretues të Kushtetutës, mbajti qëndrim publik lidhur me pretendimet për shkeljet procedurale në miratimin e tij. Sipas

Presidentit të Republikës, shkeljet procedurale nuk përbëjnë shkak të vetëmjaftueshëm për kthimin e ligjit për shqyrtim. Procedura e shqyrtimit dhe e miratimit të projektligjeve është çështje e Rregullores së Kuvendit, kontrolli i zbatimit të së cilës kryhet nga organet e brendshme të Kuvendit, të ngarkuara nga vetë Rregullorja për këtë qëllim. Sipas tij, është fakt publik se në instancat e brendshme të Kuvendit nuk është depozituar asnjë kërkesë me pretendime për shkelje procedurale të lidhura me këtë ligj. Shkeljet procedurale mund të formojnë lëndë për kontrollin kushtetues vetëm nëse shkeljet procedurale ngrihen në nivelin e shkeljeve kushtetuese. Asnjëra nga shkeljet procedurale të pretenduara nuk ngrihet në nivelin e një shkeljeje procedurale kushtetuese dhe, për pasojë, sipas Presidentit, kjo nuk e bën ligjin antikushtetues.

22. Për sa më sipër, Gjykata vëren se kërkuesi nuk ka ngritur ndonjë pretendim për cenimin e standardeve dhe parimeve kushtetuese në drejtim të ushtrimit të nismës ligjvënëse nga dy deputetët e pakicës parlamentare, madje nuk ka paraqitur asnjë argument nëse mosrespektimi i procedurës së nismës ligjvënëse ka prekur kushtetutshmërinë e ligjit të kundërshtuar. Ndërsa për sa u takon argumenteve që lidhen me mënyrën e zhvillimit të mbledhjeve (në platformën *online*, pa pjesëmarrjen e deputetëve të pakicës dhe pa konsensusin politik të tyre), Gjykata çmon se ato kanë të bëjnë me aspekte të brendshme të veprimtarisë së Kuvendit në shqyrtimin dhe miratimin e nismave ligjore të deputetëve. Si të tilla, ato i përkasin autonomisë parlamentare të Kuvendit dhe nuk i nënshtrohen kontrollit kushtetues, ndaj pretendimi i kërkuarit për mosrespektimin e procedurës së miratimit të ligjit të kundërshtuar, në formën se si janë paraqitur argumentet prej tij, nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata.

23. Në lidhje me përmbajtjen e ndryshimeve të ligjit për komisionet hetimore, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuarit bazohen në nenet 77, pika 2 dhe 23 të Kushtetutës dhe kanë të bëjnë me të drejtën e një të katërtës së deputetëve për të kërkuar caktimin e komisionit hetimor, në drejtim të ngritjes dhe funksionimit të tij, kjo e fundit e lidhur me hetimin efektiv parlamentar dhe me parimin e transparencës dhe llogaridhënies. Për rrjedhojë, duke qenë se këto pretendime janë me natyrë



kushtetuese, Gjykata vlerëson të analizojë në vijim bazueshmërinë e tyre në themel.

24. Po kështu, Gjykata vlerëson se edhe pse kërkuksi në objektin e kërkesës ka kërkuar shfuqizimin në tërësi të ligjit ndryshues, pretendimet për përmbajtjen e ligjit kanë të bëjnë me nenet 4, 6, 7 dhe 9 të tij. Konkretisht: i. pretendimi që lidhet me ngritjen e komisioneve hetimore ka të bëjë me nenin 4; ii. pretendimi që lidhet me funksionalitetin e Kuvendit në drejtim të hetimit efektiv të Kuvendit ka të bëjë me nenet 7 dhe 9, dhe pretendimi që lidhet me funksionalitetin në drejtim të transparencës publike dhe llogaridhënien ka të bëjë me nenin 6 të ligjit objekt shqyrtimi. Megjithatë për qëllime të gjykit kushtetues ajo do të shohë në mënyrë integrale edhe dispozitat e tjera të ligjit ndryshues, për aq sa ato ndikojnë në analizën e Gjykatës për dispozitat e mësipërme të ligjit ndryshues.

C. Për themelin e pretendimeve

C.1 Për ngritjen e komisioneve hetimore

25. Kërkuksi ka pretenduar se në kundërshtim me nenin 77, pika 2, të Kushtetutës dispozitat e ligjit ndryshues kanë reflektuar pjesërisht standardet e jurisprudencës kushtetuese, duke mos vendosur asnjë rregull për standardin kushtetues të “*formulimit alternativ*”, që ka të bëjë me detyrimin e shumicës që të mos debatojë dhe pengojë ngritjen e komisionit hetimor, por nëse ajo vlerëson se objekti i propozuar i hetimit cenon parimet kushtetuese, ka detyrimin të ofrojë formulim alternativ të tij. Sipas kërkuksit, kjo mungesë i jep mundësi shumicës parlamentare të vlerësojë në diskrecionin e saj përmbushjen ose jo të parimeve kushtetuese dhe pa bërë ndonjë përpjekje për konsensus, të rrëzojë kërkesat për ngritjen e komisioneve hetimore.

26. Subjekti i interesuar ka prapësuar se dispozitat e kundërshtuara nuk cenojnë nenin 77, pika 2, të Kushtetutës. Sipas tij, ndryshimet ligjore reflektojnë standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese, që bëjnë të qartë se hetimi parlamentar nuk është me natyrë penale, çfarë do të thotë çështje e veçantë, cili është objekti i hetimit dhe cilat janë parimet themelore, mbi të cilat zhvillohet hetimi parlamentar. Po sipas këtij subjekti, ndryshimet ligjore krijojnë hapësira për të gjetur konsensus midis grupit të deputetëve që kërkojnë komision hetimor dhe pjesës tjetër të deputetëve.

27. Sipas nenit 77, pika 2, të Kushtetutës, Kuvendi ka të drejtë dhe, me kërkesë të një të

katërtës së të gjithë anëtarëve të tij, është i detyruar të caktojë komision hetimi për të shqyrtuar një çështje të veçantë.

28. Gjykata ka interpretuar përmbajtjen e kësaj dispozite kushtetuese duke u shprehur se komisionet hetimore janë mjet efektiv kontrolli që veprojnë vetëm brenda hapësirës kontrolluese të parlamentit, të cilat ngrihen për çështje të veçanta, të lidhura në mënyrë funksionale me pushtetin e ligjvënësit. Ngritja e komisioneve hetimore parlamentare, kur kërkohet nga një e katërta e deputetëve, është e detyrueshme. Objekti dhe fusha e veprimit të komisioneve hetimore duhet të respektojnë parimet kushtetuese, duke mos cenuar pavarësinë dhe duke mos penguar veprimtarinë e organeve të pushteteve të tjera. Parimet kushtetuese, përfshirë edhe ai i ndarjes e balancimit ndërmjet pushteteve, përbëjnë standarde kushtetuese mbi të cilat ngrihen dhe funksionojnë komisionet hetimore parlamentare (*shih vendimin nr. 18, datë 14.5.2003, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Në jurisprudencën kushtetuese është vënë theksi në mënyrë të posaçme tek e drejta e pakicës parlamentare për të kërkuar komision hetimor. Në një regjim parlamentar nuk është shumica ajo që vëzhgon qeverisjen, por kjo konsiderohet tashmë si detyrë e opozitës. Prandaj kjo e drejtë e pakicës për të ngritur komisione hetimore, e garantuar me Kushtetutë, duhet të mbetet gjithmonë e paprekur (*shih vendimin nr. 30, datë 16.5.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Gjykata ka pohuar se e drejta për të ushtruar hetim parlamentar nuk mund të jetë e pakufizuar. Kufizimi i saj lidhet me detyrimin që objekti i hetimit të respektojë parimet dhe standardet kushtetuese (*shih vendimin nr. 57, datë 23.7.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Me qëllim që objekti i hetimit të respektojë parimet dhe standardet kushtetuese, Gjykata ka pohuar se duhet të përmbushen këto kushte: i. çështja duhet të ketë të bëjë me funksionin ligjvënës dhe funksione të tjera për të cilat ai është i autorizuar të marrë masa ligjore; ii. objekti i hetimit duhet të fokusohet në çështje ose në subjekte konkrete; iii. duhet të ekzistojnë të dhëna ose indicie të mjaftueshme që dëshmojnë për ekzistencën e një çështjeje, për të cilën është i nevojshëm hetimi (*shih vendimet nr. 22, datë 5.5.2010; nr. 20, datë 4.5.2007, të Gjykatës Kushtetuese*). Përveç sa më sipër, Gjykata ka identifikuar edhe një kusht tjetër, sipas të cilit shumica parlamentare, në rastet kur pretendon se



cenohen standardet dhe parimet kushtetuese në objektin e hetimit, është e detyruar të propozojë formulime alternative, duke i dhënë mundësinë pakicës të riformulojë kërkesën e saj (*shih vendimin nr. 30, datë 16.5.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Po kështu, Gjykata rritet edhe standardet në lidhje me forcën detyruese të vendimeve të saj. Në kuptim të neneve 124 dhe 132 të Kushtetutës, zbatimi i këtyre vendimeve është detyrim kushtetues. Ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme, janë përfundimtare dhe si të tilla përbëjnë jurisprudencë kushtetuese, për rrjedhojë kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit (*shih vendimet nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 49, datë 3.7.2017; nr. 15, datë 1.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Bazuar në nenin 77, pika 2, të Kushtetutës dhe standardet e mësipërme, Gjykata evidenton se komisioni hetimor parlamentar ngrihet dhe funksionon në emër të Kuvendit, që do të thotë se titullar i së drejtës së hetimit parlamentar është Kuvendi, ndërsa komisioni hetimor vepron si organ ndihmës i tij, ndaj cenimi i standardeve për ngritjen dhe funksionimin e komisionit hetimor passjell edhe cenimin e funksionit të Kuvendit për hetim parlamentar. E drejta për informim dhe për kontroll parlamentar rrjedh nga legjitimiteti i drejtpërdrejtë demokratik i Kuvendit, si përfaqësues i popullit, ndërkohë që, nga ana tjetër, sa më i thellë të jetë kontrolli parlamentar ndaj veprimtarisë së organeve shtetërore, aq më i fortë është edhe legjitimiteti demokratik i tyre.

33. Duke iu rikthyer rastit konkret, Gjykata vëren se neni 4 i ligjit ndryshues për komisionet hetimore ka riformuluar pikën 1 të nenit 5 të ligjit bazë, duke parashikuar se “*Kuvendi është i detyruar të miratojë ngritjen e komisionit kur objekti i hetimit respekton parimet dhe standardet kushtetuese, si: a) çështja duhet të ketë të bëjë me funksionin ligjvënës dhe funksione të tjera të Kuvendit; b) objekti i hetimit duhet të fokusohet në çështje ose në subjekte konkrete; c) duhet të ekzistojnë të dhëna ose indicie të mjaftueshme për ekzistencën e çështjes për të cilën kërkohet ngritja e komisionit hetimor*”.

34. Gjykata konstaton se ndonëse në pamje të parë teksti i nenit 4 përmban një normë urdhëruese për ngritjen e komisioneve hetimore, duke iu referuar përmbajtjes së tij rezulton se në fakt ajo lejon Kuvendin të mos pranojë kërkesën për ngritjen e komisionit hetimor nëse objekti nuk

përputhet me standardet dhe parimet e përcaktuara në të. Në këtë mënyrë, Gjykata vlerëson të ndalet në analizën e kësaj dispozite për të verifikuar nëse ajo cenon detyrimin kushtetues për ngritjen e komisionit hetimor dhe për rrjedhojë, edhe vetë funksionin e Kuvendit për hetim parlamentar.

35. Gjykata vëren se neni 4 ka përcaktuar tre parime dhe standarde kushtetuese, të cilat duhet të respektohen nga objekti i hetimit parlamentar. Sipas tyre, objekti i hetimit duhet të jetë çështje që ka të bëjë me funksionin ligjvënës dhe funksione të tjera të Kuvendit; të fokusohet në çështje ose subjekte konkrete; dhe duhet të ekzistojnë të dhëna ose indicie të mjaftueshme për ekzistencën e çështjes, për të cilën kërkohet ngritja e komisionit hetimor. Duke i ballafaquar këto kërkesa të ligjit me standardet e zhvilluara nga jurisprudenca kushtetuese për objektin e hetimit parlamentar, Gjykata vëren se ligjvënësi ka reflektuar literalisht vetëm një pjesë të standardeve kushtetuese që duhet të përmbushë objekti i hetimit, pra jo plotësisht ato. Në këtë dispozitë mungon rregulli i bashkëpunimit kushtetues luajal midis shumicës dhe pakicës parlamentare, sipas të cilit kur shumica konstaton se objekti i hetimit rrezikon standardet dhe parimet kushtetuese, atëherë ajo ka detyrimin të propozojë formulime alternative, duke i dhënë pakicës mundësinë për të riformuluar objektin e hetimit.

36. Në lidhje me këtë mungesë të dispozitës ligjore, Gjykata rritet se mosveprimi i ligjvënësit për miratimin e një dispozite ligjore mund të kthehet në një boshllëk ligjor që nuk pajtohet me Kushtetutën nëse mungesa e normës ligjore cenon parimet kushtetuese ose liritë dhe të drejtat themelore. Antikushtetutshmëria për shkak të boshllëkut ligjor vërehet edhe kur organi ligjvënës nuk vepron për të respektuar një vendim të Gjykatës. Megjithatë, jo në çdo rast vendimi i Gjykatës duhet të sjellë reagimin e ligjvënësit për miratimin e rregullimeve të reja ligjore, pasi edhe mosveprimi i ligjvënësit mund të jetë një mënyrë e zbatimit të vendimit të Gjykatës. Kjo, ndonjëherë, mund të jetë një zgjidhje praktike ose mund të jetë e nevojshme (*shih vendimin nr. 4, datë 15.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Gjykata vlerëson të theksojë, fillimisht, se në dallim nga sa më sipër, ajo ndodhet para një rasti të veçantë, për sa kohë ka të bëjë me nismën e ligjvënësit për të miratuar norma ligjore për rregullimin e një çështjeje konkrete, me qëllim



reflektimin e standardeve të jurisprudencës kushtetuese, pa pasur ai një detyrim të shprehur të përcaktuar nga kjo Gjykatë. Në këto raste, Gjykata verifikon nëse jurisprudenca e saj është reflektuar e plotë në ligj, në të kundërt, nëse reflektimi i pjesshëm (i fragmentarizuar) ka krijuar ose jo premisa për ekzistencën e boshllëkut ligjor, si rast përjashtimor, me pasoja jokushtetuese në të drejtën e pakicës parlamentare të garantuar nga neni 77, pika 2, i Kushtetutës.

38. Gjykata, pa vënë në dyshim forcën detyruese të vendimeve të saj lidhur me katër kushtet e hetimit parlamentar, evidenton se mënyra se si ka vepruar ligjvënësi në rastin konkret ka krijuar boshllëk ligjor, pasi duke reflektuar në mënyrë të fragmentarizuar standardet kushtetuese për objektin e hetimit, ka krijuar paqartësi për zbatimin e nenit 4 të ligjit ndryshues nga subjektet të cilave u drejtohet (subjektit që kërkon ngritjen e komisionit hetimor dhe shumicës parlamentare që vendos). Paqartësia e normës ligjore lidhet me faktin që, ndonëse standardet kushtetuese paraqiten me vlerë të njëjtë për ngritjen e komisioneve hetimore, ligjvënësi ka zgjedhur të parashikojë shprehimisht vetëm kërkesat që duhet të përmbushë objekti i hetimit, duke zbehur rëndësinë e parimit të bashkëpunimit luajal. Kjo paqartësi vështirëson kuptimin e normës dhe rrezikon të krijojë, rast pas rasti, mosmarrëveshje kompetencash, si dhe vë në dyshim standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese, me pasoje cenimin e së drejtës kushtetuese të pakicës për ngritjen e komisioneve hetimore dhe të funksionit të Kuvendit për hetim parlamentar.

39. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se, bazuar në parimet e shtetit të së drejtës dhe të hierarkisë së normave, dispozitat kushtetuese, të cilat interpretohen në mënyrë përfundimtare nga jurisprudenca e Gjykatës, kanë përparësi dhe zbatohen drejtpërdrejt. Në këtë mënyrë, nëse pushteti ligjvënës zgjedh të mos miratojë norma juridike që u përgjigjen zhvillimeve të jurisprudencës kushtetuese, atëherë ky fakt nuk përbën shkak të vetëmjaftueshëm për antikushtetutshmëri në formën e boshllëkut ligjor. Në këtë rast vepron parimi i forcës detyruese të vendimeve të Gjykatës, i sanksionuar në nenin 132 të Kushtetutës dhe rendi juridik nuk mund të konsiderohet se ka boshllëk ligjor.

40. Ndryshe paraqitet situata kur ligjvënësi zgjedh të ndërhyjë me norma pozitive, duke

miratuar ligje për të reflektuar standardet e jurisprudencës kushtetuese. Në këtë rast, për ligjvënësin lindin detyrime të veçanta për të siguruar zbatimin korrekt/të saktë të jurisprudencës kushtetuese, me qëllim që të eliminohen paqartësitë ose papajtueshmëritë midis frymës së ligjit dhe zbatimit të tij në praktikë, dhe ruajtjen e besimit publik te legjislacioni i miratuar.

41. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar, gjithashtu, domosdoshmëria që paraqet për funksionimin normal të shtetit të së drejtës shmangia e ometimit ligjor, pasi mosveprimi i ligjvënësit në përgjigje të këtij vakumi mund të çojë në një krizë në sistemin e demokracisë përfaqësuese (*shih vendimet nr. 38, datë 9.12.2022; nr. 4, datë 15.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Ekzistenca e ometimit ligjor sjell cenimin e parimeve kushtetuese dhe, në këtë mënyrë, është detyrë e ligjvënësit të plotësojë këtë boshllëk në të ardhmen (*shih vendimet nr. 5, datë 27.1.2017; nr. 75, datë 19.4.2002; nr. 76, datë 25.4.2002, të Gjykatës Kushtetuese*).

42. Gjykata, pa marrë përsipër dhe pa pasur qëllim që të përcaktojë, përmes këtij vendimi, se çfarë elementesh duhet të përmbajë formulimi alternativ, vlerëson të theksojë se palët, si pakica, ashtu edhe shumica parlamentare, janë të detyruara që, bazuar në parimin e bashkëpunimit dhe respektit të ndërsjellë, ashtu dhe në parimet kushtetuese që gjejnë zbatim gjatë caktimit të komisioneve hetimore, të elaboruara në jurisprudencën kushtetuese, të bashkëpunojnë, në respekt të parimeve dhe standardeve kushtetuese, për të garantuar të drejtën e pakicës parlamentare për ngritjen e komisioneve hetimore, ashtu edhe funksionin e kontrollit parlamentar të Kuvendit.

43. Për sa më lart, nisur nga fakti se ligjvënësi tashmë ka zgjedhur të parashikojë shprehimisht në nenin 4 të ligjit ndryshues standardet kushtetuese që duhet të plotësojë objekti i komisionit hetimor, Gjykata çmon se mungesa e parashikimit për “*formulim alternativ*” të objektit, me qëllim arritjen e konsensusit midis subjektit që kërkon ngritjen e komisionit hetimor dhe shumicës parlamentare, e cila, siç u theksua më sipër, mundëson pakicën parlamentare të ushtrojë të drejtën kushtetuese të parashikuar në nenin 77, pika 2, të Kushtetutës për të kërkuar ngritjen e një komisioni hetimor, krijon boshllëk ligjor që cenon të drejtën kushtetuese dhe passjell edhe cenimin e funksionit të Kuvendit për hetim parlamentar. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson



se pretendimi i kërkuesit për nenin 4 të ligjit ndryshues është i bazuar.

44. Në interpretim të nenit 76, pika 5, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata, për sa kohë që konstatoi boshllëk ligjor në përmbajtjen e nenit 4 të ligjit ndryshues, si dhe duke mbajtur në konsideratë rrethanat në tërësi të çështjes, rëndësinë e saj dhe procedurat parlamentare, vlerëson se Kuvendi duhet të plotësojë këtë boshllëk ligjor, sipas arsyetimit të mësipërm, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

C.2 Për funksionimin e komisioneve hetimore

45. Gjykata vlerëson të theksojë fillimisht se ngritja e një komisioni hetimi nuk është qëllim në vetvete. E drejta kushtetuese e pakicës së anëtarëve të Kuvendit për të kërkuar caktimin e komisionit hetimor realizohet vetëm nëpërmjet një hetimi efektiv, i cili garanton ushtrimin e funksionit kontrollues të Kuvendit. Qëllimi i ngritjes së një komisioni hetimor është i lidhur ngushtësisht me hetimin efektiv, përndryshe vetëm ngritja e komisionit hetimor, pa i mundësuar pakicës parlamentare kryerjen e një hetimi efektiv, nuk do të respektonte të drejtën kushtetuese të kësaj të fundit, të garantuar nga neni 77 i Kushtetutës, duke e bërë këtë të drejtë iluzive. Po kështu, duke qenë se një aspekt tjetër po aq i rëndësishëm i funksionimit dhe një nga synimet e komisionit hetimor, si instrument në duart e pakicës parlamentare për ushtrimin e funksionit të kontrollit parlamentar, është edhe garantimi i së drejtës së publikut për të verifikuar mënyrën e ushtrimit të pushtetit shtetëror, Gjykata vlerëson që ta shqyrtojë këtë pretendim të kërkuesit edhe në drejtim të së drejtës për transparencë dhe llogaridhënie. Për rrjedhojë, në vijim, duke qenë këto dy aspekte të ndryshme që lidhen me funksionimin e komisionit hetimor, Gjykata vlerëson t'i shqyrtojë ato veçmas.

C.2.1 Për cenimin e së drejtës së pakicës parlamentare për hetim efektiv

46. Kërkuesi ka pretenduar se dispozitat e ligjit ndryshues kanë vendosur hetimin parlamentar nën kontrollin e shumicës, pasi edhe në rast të ngritjes së komisionit hetimor, ushtrimi i kontrollit efektiv parlamentar bëhet i pamundur për sa kohë shumica parlamentare vendos për marrjen e provave dhe për thirrjen e dëshmitarëve. Sipas kërkuesit, neni 7 i ligjit ndryshues, që ka ndryshuar nenin 13 të ligjit për komisionet hetimore, bën që marrja e provave dhe thirrja e dëshmitarëve të ngelen në vullnetin e

shumicës parlamentare, e cila ka edhe numrin më të madh të anëtarëve në komision. Sipas tij, një mekanizëm i tillë do të zhbëjë të drejtën e pakicës parlamentare për kryerjen e një hetimi efektiv, pasi të dhënat dhe dëshmitë që do të administrohen nga komisioni do të jenë tërësisht në diskrecionin e shumicës, në ndryshim kjo nga përcaktimet e mëparshme të këtij neni, që parashikonte se marrja e provave dhe thirrja e dëshmitarëve nga çdo anëtar i komisionit pranohej pa votim. Po sipas kërkuesit, neni 9 i ligjit ndryshues kërkon marrjen e lejes nga prokuroria ose gjykata për pyetjen si dëshmitarë të personave që janë thirrur ose do të thirren nga organet e drejtësisë për proceset penale.

47. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se parashikimet e nenit 7 të ligjit ndryshues nuk përbëjnë risi, pasi janë parashikuar në ligjin për komisionet hetimore si akte që shoqërojnë të gjithë veprimtarinë e komisionit dhe miratohen me shumicë të thjeshtë të anëtarëve. Sipas këtij subjekti, marrja e provave dhe thirrja e dëshmitarëve me vendim të ndërmjetëm disiplinon punën e komisionit dhe shmang kontradiktat. Po sipas tij, parashikimet e nenit 9 të ligjit ndryshues, në lidhje me thirrjen e dëshmitarëve, janë reflektim i praktikës parlamentare të funksionimit të komisioneve hetimore, gjatë së cilës është konstatuar se komisionet dalin jashtë natyrës së tyre dhe konfundojnë objektin e hetimit parlamentar me atë të hetimit penal, ashtu sikundër kjo mënyrë sjelljeje ka bërë që Kuvendi të shfaqet si një organ që ka epërsi ndaj të tjerëve. Sipas këtij subjekti, dëshmitarët mund të refuzojnë të japin informacion në përgjigje të pyetjeve, nëse kjo do t'i ekspozonte ata ose personat e lidhur ndaj rrezikut të hetimit, sipas një procesi të rregullt ligjor.

48. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se kontrolli parlamentar zhvillohet nëpërmjet disa instrumenteve, një prej të cilave është komisioni hetimor. Ai nënkupton të drejtën e pushtetit legjislativ për t'u informuar dhe për të realizuar mbikëqyrjen për zbatimin e ligjeve nga organet e pushtetit publik, me qëllim marrjen e masave të domosdoshme për parandalimin e paligjshmërisë, si dhe nxjerrjen e përgjegjësive sipas rasteve konkrete. Nëpërmjet këtij kontrolli parlamentarët kanë të drejtën të informohen për çështjet e administrimit të pushtetit dhe të zbatimit të ligjeve apo për çështje të caktuara, marrja dijeni mbi të cilat konsiderohet e nevojshme për realizimin e detyrave të tyre, brenda



kuadrit të funksionit kushtetues (*shih vendimin nr. 18, datë 14.5.2003, të Gjykatës Kushtetuese*).

49. Gjykata ka theksuar se komisionet hetimore parlamentare kanë disa veçori që duhen mbajtur parasysh gjatë funksionimit të tyre. Procedura e hetimit parlamentar u shërben qëllimeve të ndryshme nga ato të hetimit penal. Në procesin penal qëllimi është të provohet nëse kryerja e një vepre penale të caktuar ka ardhur si pasojë e veprimi të një personi të caktuar dhe nëse midis këtyre të dyjave ekziston një lidhje shkakësore që provon fajin individual të autorit. Ndërsa në hetimin parlamentar fokusi është evidentimi dhe shpjegimi/sqarimi i një sjelljeje mbështetur mbi motive politike, para së gjithash për të realizuar efektivisht funksionin kontrollues të parlamentit. Marrja e secilës provë gjatë një hetimi parlamentar nuk është e nevojshme të lidhet patjetër me një fakt të caktuar, por mund të ketë një funksion më të përgjithshëm, për shembull për të hedhur “*dritë në errësirë*” gjatë një hetimi kompleks, me qëllim nxjerrjen e përgjegjësisë politike. Kufiri i hetimit parlamentar shkon deri në atë pikë ku marrja e provave ose fakteve bëhet pa ndonjë bazë të caktuar dhe nuk ka qëllim të evidentueshëm qartë të cilit do të mund t’i shërbejë (*shih vendimin nr. 30, datë 16.5.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

50. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, Gjykata thekson se hetimi parlamentar nuk mund të jetë absolutisht i pakufizuar, çfarë nënkupton se hetimi, kufijtë e të cilit përcaktohen nga objekti i miratuar, nuk duhet të përdoret në mënyrë abuzive dhe duhet të respektojë standardet kushtetuese. Gjykata vlerëson, gjithashtu, se pavarësisht se kufizimi i hetimit parlamentar është parë në jurisprudencën kushtetuese në këndvështrim të objektit të tij, përderisa, referuar ndryshimeve të ligjit për komisionet hetimore, edhe kërkesat për marrje provash i nënshtrohen tashmë një vendimmarrjeje, këto standarde gjejnë zbatim edhe në drejtim të kësaj veprimtarie të komisionit hetimor.

51. Gjykata, duke pasur parasysh parimet dhe standardet e mësipërme, si dhe bazuar në pretendimet e kërkuarit, vëren, fillimisht, se ai ka kundërshtuar si përmbajtjen e nenit 7 të ligjit ndryshues, i cili përcakton se marrja e provave bëhet me vendim të ndërmjetëm, ashtu edhe përmbajtjen e nenit 9 të ligjit ndryshues, në aspektet që kanë të bëjnë me lejen për pyetjen e dëshmitarëve dhe të drejtën e tyre për të refuzuar dhënien e

informacionit. Për rrjedhojë, në vijim, Gjykata do të verifikojë përmbajtjen e secilit nga këto parashikime.

C.2.1.1 Për vendimmarrjen e ndërmjetme për marrjen e provave

52. Gjykata vëren se neni 7 i ligjit ndryshues ka ndryshuar nenin 13 të ligjit për komisionet hetimore “*Marrja e vendimeve*”, pika 4 e të cilit ka këtë përmbajtje: “*Vendimmarrja e lidhur me provat realizohet me vendim të ndërmjetëm të shumicës së anëtarëve që kërkon kjo lloj vendimmarrje*”, ndërsa pika 5 e tij parashikon: “*Kërkesa për pyetjen e dëshmitarëve ose marrjen e provave të tjera, pasi ka filluar shqyrtimi, mund të ngrihet nga çdo anëtar komisioni dhe pranohet me vendim të ndërmjetëm të komisionit. Hetimi fillon me marrjen e provave të kërkuara nga grupi nismëtar i komisionit dhe vazhdon me marrjen e provave që kërkojnë nga grupimi tjetër jonismëtar*”.

53. Gjykata vlerëson se përmes të drejtave që i njihen komisionit hetimor, nëse ligji nuk do të garantonte të drejtën e marrjes së provave në aspektin procedural, ai nuk do të mund të garantonte të drejtën e pakicës parlamentare për ushtrimin e kontrollit parlamentar efektiv. Marrja e provave bëhet një proces i rëndësishëm në kuadër të hetimit efektiv, duke qenë element thelbësor dhe përcaktues i vetë rezultatit të çdo hetimi. Vendimi i komisionit të hetimit për marrjen e provave është rregull i përgjithshëm i kësaj procedure, ndaj vendimi i ndërmjetëm për refuzimin e provave duhet të jetë përjashtim nga ky rregull. Nga ana tjetër, Gjykata vlerëson të theksojë se thjesht parashikimi në nenin 7 të ligjit ndryshues i së drejtës së komisionit për të vendosur për marrjen e provave me vendim të ndërmjetëm nuk është i mjaftueshëm për ta bërë këtë dispozitë jokushtetuese. Gjykata mban parasysh në këtë drejtim jo vetëm faktin se Kuvendi organizohet dhe funksionon si organ kolegjal, në funksionimin e të cilit vendimet e ndërmjetme janë të nevojshme, por edhe faktin se kjo është një metodë e përdorur edhe në sisteme të tjera kushtetuese (për shembull në Gjermani), që parashikojnë vendimmarrjen për marrjen/refuzimin e një prove me vendim të ndërmjetëm.

54. Në kuptim të qëllimit dhe natyrës së veprimtarisë që kryen komisioni hetimor, i cili në çdo rast duhet të respektojë kriteret kushtetuese, duke u kufizuar brenda qëllimit për të cilin është ngritur dhe në dobi të shqyrtimit të çështjes objekt i veprimtarisë së tij, Gjykata vlerëson se edhe marrja e provave ose pyetja e dëshmitarëve përcaktohen në mënyrë të drejtpërdrejtë vetëm nga sfera e kësaj



veprimtarie, e cila nuk mund të jetë e pakufizuar. Në këtë kuptim, kufizimi i së drejtës së komisionit për marrjen e provave ose thirrjen e dëshmitarëve është i lidhur dhe përcaktohet nga objekti i hetimit dhe natyra e çështjes së veçantë që hetohet. Çdo qëndrim i ndryshëm do të vinte në diskutim thelbin e së drejtës së pakicës parlamentare për të kërkuar hetim parlamentar, për rrjedhojë edhe vetë funksionin e Kuvendit për hetim parlamentar. Megjithatë, Gjykata thekson se, për të garantuar kontrollin efektiv parlamentar, vendimi i ndërmjetëm për refuzimin e provës duhet të jetë një rast përjashtimor nga rregulli i përgjithshëm, sipas të cilit provat e kërkuara nga pakica parlamentare duhet të merren përveçse në ato raste kur kërkesa për marrje provash ose thirrje të dëshmitarëve del jashtë objektit të hetimit, apo e bën procesin joefektiv, për shkak se shkakton tejzgjatje abuzive të tij. Po kështu, vendimi për refuzim, në çdo rast, duhet të jetë i arsyetuar në drejtim të shkaqeve të refuzimit, jo vetëm për të garantuar parimin e bashkëpunimit luajal mes shumicës dhe pakicës parlamentare, por për të garantuar edhe kontrollin kushtetues në rast mosmarrëveshjeje.

55. Gjykata, duke pasur parasysh standardet e mësipërme në drejtim të mungesës së dispozitës ligjore, e cila nëse konstatohet se cenon parimet kushtetuese kthehet në boshllëk ligjor që nuk pajtohet me Kushtetutën, evidenton se edhe në këtë rast mënyra se si ka vepruar ligjvënësi ka krijuar boshllëk ligjor, për shkak se nuk ka parashikuar në përmbajtjen e nenit 7 të ligjit ndryshues garancitë e plota procedurale për të garantuar të drejtën e pakicës parlamentare për kontroll efektiv parlamentar.

56. Gjykata vëren se në formulimin e saj të mëparshëm pika 4 e nenit 13 të ligjit për komisionet hetimore parashikonte: *“Kërkesa për hetim ose marrje provash nga çdo anëtar i komisionit pranohet nga komisioni pa votim.”*. Parashikimi i vendimmarrjes me shumicë të anëtarëve duket sikur e zhvesh pakicën nga e drejta për një hetim efektiv, duke e lënë vlerësimin në vendimmarrjen e shumicës dhe duke mos parashikuar se cilat janë ato raste përjashtimore që mund të passjellin refuzimin e kërkesës për marrje të provave. Gjatë hetimit parlamentar Kuvendi duhet të ketë parasysh, si garantimin e parimeve kushtetuese dhe kritereve që duhet të respektohen nga komisioni, ashtu edhe detyrimin e komisionit që të arsyetojë vendimin e tij në rast refuzimi, ku të

parashtrihen shkaqet që kanë çuar në këtë vendimmarrje (refuzimi).

57. Gjykata vlerëson, gjithashtu, se për sa kohë që vendimmarrja e komisionit hetimor për marrjen e provave është pjesë e rëndësishme e së drejtës për hetim parlamentar, të garantuar nga neni 77 i Kushtetutës, vendimi për refuzimin e provave të kërkuara nga pakica parlamentare mund ta bëjë joefektive këtë të drejtë dhe ushtrimin e funksionit të Kuvendit, si titullar i kësaj të drejte dhe mund të krijojë përplasje kompetencash, të cilat mund të çojnë në mosmarrëveshje kushtetuese. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit në lidhje me përmbajtjen e nenit 7 të ligjit ndryshues është i bazuar.

58. Në kuptim të sa më sipër, për sa kohë që edhe në lidhje me përmbajtjen e nenit 7 të ligjit ndryshues Gjykata konstatoi ekzistencën e boshllëkut ligjor, i takon Kuvendit ta plotësojë atë, sipas arsyetimit të mësipërm, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

C.2.1.2 Për marrjen e lejes për të dëshmuar dhe të drejtën e dëshmitarit për të refuzuar të dëshmojë

59. Për sa i përket nenit 9 të ligjit ndryshues, ai ka ndryshuar nenin 16 të ligjit për komisionet hetimore *“Thirrja për të dëshmuar”*, duke shtuar pikën 1/2, e cila parashikon: *“Për pyetjen si dëshmitarë të personave që janë thirrur ose do të thirren nga organi i prokurorisë/ gjykatës për procesin penal të lidhur eventualisht me çështjen objekt hetimi, komisioni merr leje paraprakisht nga prokuroria ose gjykata ku ndodhen aktet për objektin dhe kufijtë e dëshmisë.”*. Po kështu është shtuar pika 2/4, e cila parashikon: *“Dëshmitarët mund të refuzojnë të japin informacion në përgjigje të pyetjeve që u drejtohen, nëse përgjigjia e këtyre pyetjeve do t'i ekspozonte ata ose personat e lidhur me ta ndaj rrezikut të hetimit sipas një procesi të rregullt ligjor.”*

60. Referuar relacionit shoqërues të projektligjit dhe parashtrimeve të subjektit të interesuar, Kuvendit, qëllimi i këtyre dispozitave lidhet me respektimin e parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve dhe përdorimin në mënyrën e duhur të instrumenteve që KPP-ja i jep prokurorisë ose gjykatës dhe synojnë ndalimin e ndërhyrjeve të tepruara në sferën e kompetencave të këtyre organeve, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe që kontrolli parlamentar të mos përdoret tej hapësirës kontrolluese të Kuvendit.

61. Gjykata, duke ritheksuar rëndësinë që ka marrja e provave (çdo e dhënë, dëshmi, dokument



apo fakt që shërben në nxjerrjen në konkluzioneve të hetimit), si një nga aspektet më të rëndësishme të hetimit parlamentar, që garanton efektivitetin e tij, do të verifikojë nëse përmbajtja e dispozitave të mësipërme përputhet me parimet dhe standardet kushtetuese në dy aspekte: i. marrja e lejes për të dëshmuar e lidhur me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve; dhe ii. e drejta e dëshmitarit për të refuzuar të dëshmojë e lidhur me të drejtat dhe liritë e individit. Po kështu, Gjykata, duke pasur në konsideratë se parimi i sigurisë juridike, si një ndër elementet më thelbësore të parimit të shtetit të së drejtës, nuk shfaqet asnjëherë si i tillë në vetvete, por shoqërohet, ndër të tjera, me qartësinë dhe përcaktueshmërinë në normimin e marrëdhënieve juridike (*shih vendimet nr. 48, datë 19.6.2024; nr. 10, datë 29.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*), do të verifikojë nëse dispozitat ligjore kanë respektuar edhe këtë parim.

C.2.1.2.1 Për marrjen e lejes për të dëshmuar

62. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se qëllimi i komisioneve hetimore nuk është përvetësimi i kompetencës së prokurorisë për të ndjekur vetë penalisht apo për të kryer vetë hetime mbi çështje konkrete, pra për të hetuar mbi çështje për të cilat ka filluar procedimi penal, por ajo që kërkohet të hetohet është çështja se sa efikase dhe të përgjegjshme kanë qenë institucionet e shtetit në kryerjen e detyrës së tyre. Natyra e hetimit parlamentar nuk është e njëlojtë dhe nuk mund të barazohet me objektin e hetimit të organit të prokurorisë. Përderisa pushteti i pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor nuk mund të vihet në dyshim, fakti se një çështje e ngjashme po hetohet nga prokuroria nuk krijon pengesë *apriori* në ngritjen e tij. Është detyrë e komisionit hetimor dhe e Kuvendit që, pas ngritjes së komisionit, të përqendrohen në objektin e hetimit parlamentar në mënyrë të tillë që të shmanget çdo ndërhyrje në veprimtarinë e organit të prokurorisë, në rastin konkret, apo të organeve të tjera shtetërore, nëpërmjet dublimit ose zëvendësimit të kompetencave, gjë që mund të krijonte një situatë konflikti kompetencash midis tyre (*shih vendimet nr. 30, datë 16.5.2014; nr. 20, datë 4.5.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

63. Gjykata thekson, gjithashtu, se demokracia kushtetuese bazohet në shtetin e së drejtës, parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të

njeriut. Në bazë të parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, të sanksionuar në nenin 7 të Kushtetutës, asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje ose jo të njërit prej tre pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që, sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese (*shih vendimin nr. 19, datë 3.5.2007, të Gjykatës Kushtetuese*). Nëpërmjet këtij parimi kushtetutëbërësi ka përcaktuar për secilin nga organet që u përkasin pushteteve të shtetit kompetencat që i përgjigjen qëllimit të tij dhe për sa kohë që këto kompetenca janë të përcaktuara nga normat kushtetuese, është e palejueshme që një organ tjetër t'i marrë ose t'i anashkalojë ato me vullnetin e tij (*shih vendimet nr. 29, datë 2.7.2021; nr. 24, datë 9.6.2011; nr. 19, datë 3.5.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

64. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, Gjykata rithekson dallimin që ekziston mes funksionit dhe qëllimit të ndryshëm që kanë procedurat hetimore të zhvilluara nga Kuvendi dhe ato të kryera nga prokuroria. Ndërsa hetimi parlamentar synon qartësimin e një çështjeje për qëllime politike dhe nënkupton të drejtën e pushtetit legjislativ për t'u informuar dhe për të realizuar mbikëqyrjen për zbatimin e ligjeve nga organet e pushtetit publik, me qëllim marrjen e masave të domosdoshme për parandalimin e paligjshmërisë, si dhe nxjerrjen e përgjegjësisë konkrete, hetimi penal kryhet nga prokuroria, me qëllim të ushtrimit të ndjekjes penale në kuadër të dhënies së drejtësisë penale.

65. Po kështu, Gjykata, duke pasur parasysh rëndësinë e marrjes së provave, ku përfshihet edhe thirrja e dëshmitarëve, vlerëson se parashikimi i detyrimit të Kuvendit që të kërkojë leje për thirrjen e dëshmitarëve nga prokuroria/gjykata e kufizon hetimin parlamentar për sa kohë e lë në çmimin dhe vlerësimin e prokurorisë/gjykatës rëndësinë dhe vetë marrjen e kësaj prove, duke cenuar në thelb efektivitetin e hetimit parlamentar. Ky detyrim i Kuvendit për të marrë leje për thirrjen e dëshmitarëve përbën një ndërhyrje në trajtimin e çështjeve që përbëjnë objektin qendror të veprimtarisë së Kuvendit, për rrjedhojë bie ndesh me parimin e ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve.

66. Gjykata, duke vënë theksin në garantimin e sekretit të hetimit penal, vlerëson se kjo mund të



sigurohet përmes mjeteve të tjera, siç është zhvillimi i mbledhjeve të komisionit me dyer të mbyllura, duke lejuar kështu që provat të merren dhe të analizohen në funksion të një hetimi efektiv.

67. Po kështu, në drejtim të parimit të sigurisë juridike, Gjykata vlerëson se kjo dispozitë mbart probleme edhe në drejtim të qartësisë, duke lejuar zbatimin e saj arbitrar dhe, për rrjedhojë, mund ta bëjë të drejtën e hetimit joefektive, duke e cenuar në mënyrë joproporcionale. Kjo sepse ajo jo vetëm që nuk përcakton kufijtë deri ku shtrihet e drejta e prokurorit/gjykatës për lejimin e thirrjes së dëshmitarëve, por edhe në drejtim të rrethit të dëshmitarëve, për të cilët parashikohet ky detyrim, e shtrin zbatimin edhe në çështje për të cilat ende nuk ka filluar hetimi apo për të cilat ende nuk është përcaktuar rrethi i dëshmitarëve që do të thirren, duke lejuar që të abuzohet me rrethin e dëshmitarëve ndaj të cilëve zbatohet kjo dispozitë.

C. 2.1.2.2 Për të drejtën e dëshmitarëve për të refuzuar dhënien e informacionit

68. Për sa i përket përmbajtjes së pikës 2/4, të nenit 16 të ligjit për komisionet hetimore, të shtuar me nenin 9 të ligjit ndryshues, duke qenë se Gjykata e shqyrton përmbajtjen e saj në drejtim të pajtueshmërisë me të drejtat themelore të njeriut, vlerëson, fillimisht, se kjo normë duket se i referohet përmbajtjes së nenit 32 të Kushtetutës, sipas të cilit askush nuk mund të detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes ose familjes së vet dhe as të pohojë fajësinë e tij. Gjykata thekson se e drejta kushtetuese e parashikuar nga neni 32 i Kushtetutës është e zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë. Gjykata, gjithashtu, konstaton se kjo e drejtë garantohej edhe në kuadër të parimit të procesit të rregullt ligjor, sipas përmbajtjes së nenit 3, shkronja “b”, të ligjit nr. 106/2023. Në çdo rast ajo plotësohet edhe nga garancitë që ofron KPP-ja, e cila është e zbatueshme në procedurën hetimore të kontrollit parlamentar.

69. Për sa i përket parimit të sigurisë juridike, Gjykata vëren se neni 32 i Kushtetutës garanton të drejtën për të mos deklaruar kundër vetvetes ose familjes, ndërkohë që pika 2/4 e shtuar me nenin 9 të ligjit ndryshues e ka lidhur të drejtën e dëshmitarit për të refuzuar dëshminë edhe në rastet kur bëhet fjalë për “persona të lidhur me të”, por pa dhënë përkufizimin e këtij koncepti dhe pa përcaktuar as kategorinë e personave që përfshihen në të. Përmbajtja e kësaj dispozite ligjore e ka shtrirë efektin e saj dhe mbrojtjen edhe ndaj një kategorie

personash që, referuar përkufizimeve të legjislacionit në fuqi në drejtim të “personit të lidhur”, shkon përtej konceptit të “familjes” që ka synuar të mbrojë vetë norma kushtetuese, duke e bërë këtë dispozitë të paqartë, për rrjedhojë duke lejuar interpretimin dhe zbatimin arbitrar të saj, çka mund të sjellë pengesa në hetimin efektiv parlamentar, me pasoja jokushtetuese. Për rrjedhojë, parashikimi i kësaj dispozite bie ndesh me parimin e sigurisë juridike.

70. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se përmbajtja e pikave 1/2 dhe 2/4 të nenit 16 të ligjit për komisionet hetimore, të shtuara me nenin 9 të ligjit ndryshues, nuk respekton parimin e ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve dhe atë të sigurisë juridike, për rrjedhojë cenon të drejtën për hetim parlamentar, duke e bërë atë iluzive, ashtu edhe vetë funksionin e Kuvendit. Për këto arsye, pretendimi i kërkuarit në drejtim të përmbajtjes së këtyre dispozitave është i bazuar.

C.2.2 Për cenimin e së drejtës për transparencë dhe llogaridhënie

71. Kërkuarisi ka pretenduar se ligji ndryshues ka cenuar të drejtën për transparencë dhe llogaridhënie, pasi neni 6 i ligjit ndryshues, i cili ka ndryshuar nenin 12 të ligjit për komisionet hetimore, bie ndesh me qëllimin kryesor që ka ngritja e një komisioni hetimi, konkretisht njohjen dhe verifikimin e një fenomeni, ngjarjeje ose veprimtarie të caktuar. Sipas kërkuarit, në thelb të veprimtarisë së komisioneve hetimore qëndron transparenca për median, opinionin publik dhe qytetarët, ndaj zhvillimi i mbledhjeve me dyer të mbyllura, vetëm me votat e shumicës, është në kundërshtim me këto parime. Kërkuarisi ka pretenduar se shumica do të vlerësojë se kur duhet të bëhet transparencë për aspekte të caktuara të veprimtarisë së komisionit dhe në cilat raste do të veprohet në mungesë transparence, ndërkohë që kjo dispozitë duhej të kufizohej vetëm në rastet kur të dhënat e trajtuara përbëjnë informacion të klasifikuar “*sekret shtetëror*”, siç ka qenë praktika e përhershme e punës së komisioneve. Sipas tij, një vendimmarrje e tillë, në të kundërt, duhet t'i nënshtrohet një shumice të cilësuar.

72. Subjekti i interesuar ka prapësuar se ndryshimet e ligjit për komisionet hetimore, lidhur me zhvillimin e mbledhjes së komisionit me dyer të mbyllura, nuk prekin përcaktimet e përgjithshme që parashikojnë se mbledhjet, si rregull, janë të hapura. Sipas tij, edhe nëse neni 6 i ligjit ndryshues nuk do të parashikonte specifikisht në shkronjat “a” deri “d”



të tij rastet e zhvillimit të mbledhjeve me dyer të mbyllura, kjo do të ndodhte sa herë që komisioni do të ishte para një rasti të tillë, pra nëse komisioni do duhej t'u referohej fakteve që kanë të bëjnë me jetën personale të dëshmitarëve ose të palëve të treta; kur rrezikohet jeta, shëndeti dhe liria e dëshmitarit ose personit të lidhur; kur bëhen referenca për një sekret tregtar, të klasifikuar si informacion “sekret”; kur publiciteti mund të sjellë përhapjen e të dhënave që duhet të mbahen sekret në interes të shtetit.

73. Neni 23 i Kushtetutës parashikon se e drejta e informimit është e garantuar. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive. Në zbatim të këtij parimi, edhe për veprimtarinë e Kuvendit, si organ i zgjedhur kolegjial, neni 79 i Kushtetutës parashikon si rregull se mbledhjet e tij bëhen të hapura. Megjithatë sipas pikës 2 të të njëjtit nen, mbledhjet e Kuvendit mund të bëhen të mbyllura, me kërkesë të Presidentit të Republikës, të Kryeministrit ose të një të pestës së deputetëve, kur për këtë kanë votuar shumica e të gjithë anëtarëve të tij.

74. Gjykata në jurisprudencën e saj në analizën e parimit të transparencës dhe llogaridhënies në lidhje me funksionimin e komisioneve hetimore ka theksuar se funksioni i kontrollit parlamentar nënkupton të drejtën e pushtetit ligjvënës për t'u informuar dhe për të realizuar mbikëqyrjen, brenda kufijve të përcaktuar nga Kushtetuta. Kontrolli parlamentar realizohet nëpërmjet një administrate që jep llogari, raporton dhe përgjigjet për veprimtarinë e saj. Nëpërmjet këtij kontrolli, parlamentarët kanë të drejtën të informohen për çështjet e administrimit të pushtetit dhe të zbatimit të ligjeve apo për çështje të caktuara, marrja dijeni mbi të cilat konsiderohet si e nevojshme për realizimin e qëllimeve dhe detyrave të tyre, por gjithmonë brenda kuadrit të funksionit kushtetues. Sipas Gjykatës, në një shoqëri demokratike, kjo mundësi që u jepet parlamentarëve rrjedh nga e drejta e popullit për të njohur dhe ditur se çfarë bëhet në emrin e tij. Prandaj, kontrolli parlamentar ushtrohet edhe në kontekstin e së drejtës kushtetuese të çdo shtetasi për të marrë informacionin e nevojshëm në lidhje me çështjet me interes publik. Organet e pushtetit publik që u nënshtrohen kontrollit parlamentar, duke i

transmetuar fakte e të dhëna përfaqësuesve të popullit, përmbushin njëkohësisht detyrimin kushtetues për të qenë transparentë në raport me publikun (*shih vendimin nr. 18, datë 14.5.2003, të Gjykatës Kushtetuese*).

75. Duke iu referuar të drejtës për informim të publikut, si një nga parimet themelore mbi të cilat ndërtohen e funksionojnë shoqëritë demokratike, Gjykata ka pohuar se në të tilla raste komisionet hetimore parlamentare duhet të tregojnë kujdes në gjetjen e një baraspeshe mes së drejtës për informim dhe respektimit të parimeve të tjera kushtetuese (*shih vendimin nr. 18, datë 14.5.2003, të Gjykatës Kushtetuese*).

76. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se neni 6 i ligjit ndryshues, pasi vendos rregullin se mbledhjet e komisionit janë të hapura, përcakton rastet se kur ato duhet të zhvillohen pa pjesëmarrjen e publikut (me dyer të mbyllura). Prandaj, nisur nga argumentet e parashtruara nga kërkuesi, sipas të cilit komisioni duhet të veprojë me dyer të mbyllura vetëm kur të dhënat e trajtuara përbëjnë informacion të klasifikuar “*sekret shtetëror*”, në vijim do të analizohen edhe rastet e tjera të përcaktuara në nenin 6. Për këtë qëllim, bazuar në standardet e lartpërmendura, Gjykata do të kontrollojë nëse respektohet balanca midis së drejtës për informim dhe llogaridhënie të organeve publike, nga njëra anë dhe të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, nga ana tjetër, për mbrojtjen e të cilave neni 6 ka parashikuar se komisioni vepron me dyer të mbyllura.

77. Gjykata vëren se neni 6 i ligjit objekt shqyrtimi, i cili ka ndryshuar nenin 12 “*Zhvillimi i mbledhjeve*” të ligjit për komisionet hetimore, konkretisht parashikon: “*Mbledhjet e komisionit si rregull janë të hapura. Komisioni betimor me vendim të ndërmjetëm përjashton publikun nga mbledhjet e tij nëse: a) duhet t'u referohen fakteve që kanë të bëjnë me jetën personale të dëshmitarëve ose të palëve të treta; b) kur rrezikohet jeta, shëndeti dhe liria e dëshmitarit ose personit të lidhur me të; c) kur bëhen referenca për një sekret tregtar, të klasifikuar si informacion “sekret”; d) kur publiciteti mund të sjellë përhapjen e të dhënave që duhet të mbahen sekret në interes të shtetit*.”.

78. Gjykata vëren se dispozita objekt shqyrtimi parashikon, si rregull, zhvillimin e mbledhjeve me pjesëmarrjen e publikut, pra me dyer të hapura, ndërkohë që përjashtim nga ky rregull përbëjnë vetëm rastet e përcaktuara shprehimisht në të, për të cilat parashikohet zhvillimi i mbledhjeve pa



pjesëmarrjen e publikut, të quajtur ndryshe “*me dyer të mbyllura*”. Në krahasim me përmbajtjen e mëparshme të këtij neni, që parashikonte se “*mbledhjet e komisionit si rregull janë të hapura me përjashtim të rasteve kur komisioni vendos ndryshe*”, Gjykata vëren se ndryshimet në këtë dispozitë kanë parashikuar në mënyrë shteruese rastet ose situatat për zhvillimin e mbledhjeve pa pjesëmarrjen e publikut, duke i përcaktuar ato nëpërmjet një liste të numërtuar.

79. Gjykata konstaton se neni 6 ka evidentuar katër raste të mundshme kur mbledhja e komisionit mund të zhvillohet pa praninë e publikut: i. *i pari* lidhet me garancitë për mbrojtjen e jetës personale (shkronja “a”); ii. *i dyti* lidhet me mbrojtjen e jetës dhe rastin kur në procesin e hetimit dalin fakte që vënë në rrezik jetën, shëndetin dhe lirinë e personit (shkronja “b”); iii. *i treti* lidhet me mbrojtjen e një sekreti tregtar (shkronja “c”); iv. *i katërti* lidhet me mbrojtjen nga përhapja e të dhënave që janë sekret në interes të shtetit (shkronja “d”). Kjo do të thotë se formulimet që numërojnë me listë të mbyllur rastet kur mund të zhvillohen mbledhjet me dyer të mbyllura, jo vetëm janë përjashtimore, por secili prej tyre i shërben mbrojtjes së një të drejte apo lirie tjetër kushtetuese, të identifikuar në të drejtën për jetën dhe shëndetin dhe atë për jetë private e personale, në rastet e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” dhe me mbrojtjen e “sekretit tregtar”, si pjesë e lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe atij “shtetëror”, me qëllim mbrojtjen e interesit publik, në rastet e parashikuara në shkronjat “c” dhe “d” të nenit 12.

80. Nisur nga përmbajtja e normës së kundërshtuar, si dhe fakti se komisionet hetimore parlamentare duhet të tregojnë kujdes në gjetjen e një baraspeshe mes së drejtës për informim dhe respektimit të parimeve të tjera kushtetuese, Gjykata paraprakisht vlerëson të theksojë se në trajtimin e pretendimeve dhe prapësimeve mbi këtë dispozitë ballafaqohen e drejta për informim dhe transparencë e organeve të zgjedhura, në kuptim të nenit 23, pika 3, të Kushtetutës, në raport me të drejtën për jetën dhe shëndetin dhe të drejtën për jetë private e personale, në rastet e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, si dhe me mbrojtjen e sekretit tregtar dhe atij shtetëror, në rastet e parashikuara në shkronjat “c” dhe “d”, të nenit 12.

81. Në këtë kuptim, Gjykata nuk vë në dyshim se transparenca është një parakusht i domosdoshëm i funksionimit të organeve të zgjedhura, dhe në këtë kuptim, si rregull, veprimtaria e komisionit hetimor

duhet të jetë publike. Megjithatë, verifikimi i nevojës për të vlerësuar baraspeshën midis parimit të transparencës dhe të drejtave kushtetuese të njeriut ose ato që janë të lidhura me sekretin tregtar dhe atë shtetëror lidhet me vetë funksionimin e komisionit hetimor, në drejtum të përmbushjes së qëllimit të hetimit parlamentar. Me fjalë të tjera, vetëm përjashtimisht mbledhjet e komisionit hetimor mund të zhvillohen me dyer të mbyllura, kur të drejtat e njeriut prevalojnë në raport me të drejtën për transparencë e informim.

82. Në analizë të përmbajtjes së nenit 6, Gjykata ndalon të analizojë fillimisht qëllimin e normës. Në këtë këndvështrim, Gjykata rithekson se në shkronjat “a” dhe “b” norma synon të vendosë në baraspeshë, nga njëra anë, parimin e transparencës dhe llogaridhënies (të trajtuara më sipër) në raport me garancitë e lidhura me të drejtën e jetës dhe jetës private, nga ana tjetër.

83. Neni 21 i Kushtetutës parashikon se jeta e personit mbrohet me ligj. Gjykata ka pohuar se njeriu dhe jeta e tij janë vlerat më superiore për shtetin dhe se kjo e drejtë qëndron në themel të të gjitha të drejtave dhe mohimi i saj sjell edhe eliminimin e të drejtave të tjera njerëzore. Koncepti për jetën dhe dinjitetin njerëzor paraqiten në dispozitat e Kushtetutës si vlera shumë të rëndësishme, të cilat konsiderohen si burimi nga i cili rrjedhin të gjitha të drejtat e tjera si të drejta themelore absolute. Jeta njerëzore bëhet një vlerë mbi të gjitha vlerat e tjera që mbrohet nga Kushtetuta. Ky është dhe qëllimi i Kushtetutës sonë, i cili del që në Preambulën e saj, si dhe në mjaft dispozita të tjera (shih vendimet nr. 2, datë 29.5.2024; nr. 65, datë 10.12.1999, të Gjykatës Kushtetuese).

84. Kurse për sa i përket të drejtës kushtetuese të jetës private, Gjykata ka theksuar se ajo nuk mbrohet nga një dispozitë e vetme e Kushtetutës, por nga disa prej tyre, ndër të cilat përfshihen neni 35 (mbrojtja e të dhënave personale), neni 36 (liria dhe fshehtësia e korrespondencës) dhe neni 37 (paprëshmëria e banesës). Këto të drejta themelore autonome, të vlerësuara nën konceptin e mbrojtjes të së drejtës së jetës private, përbëjnë disa nga aspektet e saj, por pa shteruar përmbajtjen e kësaj të drejte, e cila përbën hapësirën e mbrojtur brenda së cilës individ i zhvillon personalitetin e tij dhe marrëdhëniet me individët e tjerë (shih vendimin nr. 30, datë 5.7.2021, të Gjykatës Kushtetuese). Gjithashtu, e drejta për jetë private përcakton jo vetëm detyrimin negativ të



autoriteteve publike për të mos ndërhyrë në jetën private dhe familjare, por edhe detyrimin pozitiv shtetëror për t'i mbrojtur këto të drejta sa më realisht, përmes organeve të të tria pushteteve; ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. Sa më shumë të depërtohet në sferën e jetës intime apo sensitive, aq më shumë rritet edhe detyrimi i pushtetit publik për mbrojtjen e jetës private (*shih vendimin nr. 16, datë 11.11.2004, të Gjykatës Kushtetuese*).

85. Duke analizuar të drejtat si më lart, si dhe duke mbajtur në vëmendje se zhvillimi i mbledhjes pa praninë e publikut është një rast përjashtimor, Gjykata i gjen shkaqet e parashikuara në dy shkronjat e para (*shkronjat "a" dhe "b", të nenit 6*), të lidhura me mbrojtjen e së drejtës së jetës dhe asaj të jetës private, të baraspeshuara në raport me të drejtën për transparencë në atë masë, sa në çdo rast kur vihet në rrezik e drejta e jetës ose ajo e jetës private e personit, kjo e fundit do të prevalojë ndaj parimit të transparencës, pasi respektimi i saj përbën konsideratë parësore. Vetëm në këtë mënyrë garantohet detyrimi i autoriteteve publike për të mbrojtur realisht këto të drejta, qoftë në aspektin negativ, qoftë në atë pozitiv. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit në lidhje me rastet e parashikuara nga shkronjat "a" dhe "b", të nenit 6, nuk është i bazuar.

86. Për sa i përket përmbajtjes së shkronjave "c" dhe "d", të nenit 6 të ligjit ndryshues, Gjykata vëren se ato parashikojnë zhvillimin e mbledhjeve pa praninë e publikut kur bëhen referenca për një *sekret tregtar*, të klasifikuar si informacion "sekret" dhe kur publiciteti mund të sjellë përhapjen e të dhënave që duhet të mbahen *sekret në interes të shtetit*. Pra, në pamje të parë, duket se qëllimi i këtyre dispozitave është mbrojtja e "*sekretit tregtar*" dhe "*sekretit në interes të shtetit*" në raport me parimin e transparencës. Për sa i përket "*sekretit tregtar*", sipas shkronjës "c", të nenit 6, përmbajtja e kësaj pjese të normës duket si e paplotë, sepse nuk rezulton të përmbajë referencën ligjore ku të përcaktohet se cilat të dhëna do të konsiderohen "*sekret tregtar*", çka lind dyshime në drejtim të mënyrës së zbatimit të kësaj dispozite. Kurse për sa i përket përmbajtjes së shkronjës "d", të nenit 6, që i referohet sekretit në interes të shtetit, Gjykata vëren se përmbajtja e kësaj dispozite nuk është e qartë në drejtim të përcaktimit të natyrës së të dhënave, duke vënë në dyshim hapësirën e komisionit hetimor për interpretimin dhe zbatimin e saj.

87. Gjykata ka theksuar se në vlerësimin e kushtetutshmërisë të ligjeve ajo nisët nga prezumimi i kushtetutshmërisë së tyre, si dhe mundësia e interpretimit pajtues të tyre. Interpretimi pajtues është i mundur kur një ligj ose dispozitë ligjore mund të interpretohet në më shumë se një mënyrë, njëra nga të cilat është në pajtim me Kushtetutën. Kjo metodë kërkon efektet kushtetuese të rezultateve të ndryshme dhe përzgjedh rezultatin që është në pajtim me vlerat kushtetuese, duke marrë parasysh këtu të drejtat themelore të individëve (*shih vendimet nr. 2, datë 18.1.2017; nr.5, datë 16.2.2012; nr. 33, datë 24.6.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

88. Për rrjedhojë, Gjykata vëren se edhe pse dispozitat e mësipërme në dukje lënë hapësirë për mënyrën e interpretimit të tyre gjatë zbatimit rast pas rasti nga komisioni hetimor, kjo nuk është e mjaftueshme për ta bërë normën jokushtetuese, për sa kohë që ato lejojnë disa mënyra interpretimi, duke i dhënë mundësinë Gjykatës që të verifikojë, përmes interpretimit pajtues, nëse ka një interpretim që është në pajtim me Kushtetutën. Gjykata, nisur nga konteksti i këtyre dispozitave dhe nga qëllimi e kuptimi i përmbajtjes së nenit 12 të ligjit për komisionet hetimore, vlerëson se qëllimi i tyre, në thelb, është siguria publike dhe garantimi i të drejtave kushtetuese për jetë private e familjare dhe ai nuk duket se synon që të cenojë të drejtën e publikut për transparencë, pra zhvillimin e kësaj veprimtarie larg syrit dhe vëzhgimit të publikut. Me qëllim garantimin e këtyre të drejtave, Gjykata çmon se gjatë zbatimit të këtyre dispozitave ato duhet të interpretohen nga komisioni vetëm në atë mënyrë që shmang rrezikun për vlerësim subjektiv në përcaktimin e natyrës së këtyre të dhënave. Për këtë qëllim, Gjykata vlerëson se në përkufizimin se cila e dhënë do të konsiderohet ose klasifikohet si sekret tregtar, komisioni duhet t'i referohet vetëm përcaktimit "*sekret tregtar*" sipas legjislacionit në fuqi. Ndërsa në lidhje me parashikimin "*sekret në interes të shtetit*", e cila pavarësisht se përfshin edhe konceptin e "*sekretit shtetëror*", në vetvete paraqet një koncept më të gjerë se sa ai. Prandaj, ky parashikim ligjor duhet të zbatohet dhe interpretohet nga komisioni hetimor vetëm si çdo e dhënë e parashikuar si informacion i klasifikuar në bazë të ligjit, përfshirë edhe "*sekretin hetimor*".

89. Bazuar në këtë interpretim pajtues, Gjykata arrin në përfundimin se shkronjat "c" dhe "d", të nenit 6 të ligjit ndryshues janë kushtetuese me kusht



që ato të interpretohen si më sipër. Çdo interpretim i ndryshëm i tyre do të cenonte balancën midis parimit të transparencës dhe llogaridhënies, nga njëra anë, dhe të drejtave e lirive kushtetuese për mbrojtjen e të cilave shkronjat “c” dhe “d” kanë parashikuar se komisioni vepron me dyer të mbyllura, nga ana tjetër, në drejtim të përmbushjes së qëllimit të kontrollit parlamentar. Prandaj, asnjë interpretim tjetër i këtyre dispozitave nuk është i lejueshëm nga pikëpamja kushtetuese dhe se mbrojtja e të drejtave dhe parimeve kushtetuese të lartpërmendura nuk mund të arrihet në rast se këtyre dispozitave të kundërshtuara do t’u jepet një kuptim tjetër.

90. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se përmbajtja e kundërshtuar e nenit 6 të ligjit ndryshues nuk ka cenuar parimin e transparencës dhe të llogaridhënies, ndaj ky pretendim është i pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “a” dhe 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Konstatimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 4 të ligjit nr. 106/2023, datë 21.12.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8891, datë 2.5.2002, ‘Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit’”, për shkak të boshllëkut ligjor lidhur me formulimet alternative të objektit të hetimit.

3. Konstatimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 7, të ligjit nr. 106/2023, datë 21.12.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8891, datë 2.5.2002, ‘Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit’”, për shkak të boshllëkut ligjor lidhur me vendimin e ndërmjetëm për marrjen e provave.

4. Shfuqizimin e nenit 9, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 106/2023, datë 21.12.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8891, datë 2.5.2002, ‘Për

organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit’”, në pjesën që ka shtuar pikat 1/2 dhe 2/4, në nenin 16, të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si të papajtueshme me Kushtetutën.

5. Detyrimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të plotësojë boshllëkun ligjor brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

6. Rrëzimin e kërkesës për kërkimet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 9.7.2024.

Shpallur, më 1.8.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Elsa Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahim, Ilir Toska

Anëtare pjesërisht kundër: Sonila Bejtja

MENDIM PJESËRISHT KUNDËR

1. Në shqyrtimin e çështjes nr. 2 (Nj) 2024 që i përket kërkesës së subjektit kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit, me objekt shfuqizimin e ligjit nr. 106, datë 21.12.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8891, datë 2.5.2002, ‘Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit’”, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, nuk pajtohem me qëndrimin e shumicës, si për sa i përket pretendimit të kërkuesit për mosrespektimin e procedurës së miratimit të ligjit ndryshues, ashtu edhe në lidhje me përmbajtjen e neneve 6, pika 3, shkronja “d” dhe 7, pika 1, të ligjit ndryshues, për të cilat unë votova për shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën. Për rrjedhojë, në vijim, do të parashtroj argumentet që mbështetin qëndrimin tim kundër në lidhje për sa më sipër.

2. Fillimisht, vlerësoj të qartësoj qëndrimin tim, të mbajtur edhe në çështjen tjetër të shqyrtuar nga kjo Gjykatë, që kishte të bënte me kontrollin e Rregullores së Kuvendit, si të papajtueshme me Kushtetutën (*shih vendimin nr. 48, datë 19.6.2024, të Gjykatës Kushtetuese*), ku jam shprehur edhe në drejtim të juridiksionit të Gjykatës, për sa u përket pretendimeve që kanë të bëjnë me procedurën e shqyrtimit dhe miratimit të ligjeve sipas kësaj



Rregulloreje. Siç jam shprehur edhe në mendimin pjesërisht kundër në atë çështje, Rregullorja, edhe pse nuk është tipikisht dhe formalisht një ligj, në thelb dhe në përmbajtje përbën aktin mbi të cilin organizohet dhe funksionon Kuvendi, pra barazohet me ligjin organik të këtij organi. Gjykata ka theksuar se në ndryshim nga organet kushtetuese, organizimi dhe funksionimi i të cilave rregullohet me ligje të veçanta të miratuara me shumicë të cilësuar (nenet 6 dhe 81, pika 2, shkronja “a”, të Kushtetutës), Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas Rregullores së miratuar nga shumica e të gjithë anëtarëve të tij (neni 75, pika 2, i Kushtetutës). E drejta e Kuvendit për të miratuar rregullat e organizimit dhe të funksionimit të tij ka të bëjë me autonominë procedurale (normative dhe organizative) të këtij organi, i cili ka të drejtën ekskluzive për të rregulluar organizimin e tij, rolin e deputetëve, strukturën dhe procedurat e brendshme (*shih vendimin nr. 1, datë 16.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Fakti që Kushtetuta e ka parashikuar drejtpërdrejt, në nenin 75 të saj, aktin me të cilin Kuvendi do të rregullojë organizimin dhe veprimtarinë e tij, nënkupton se ajo e ka ngritur Rregulloren në nivelin e ligjit organik, duke i njohur një status të veçantë dhe të ndryshëm nga ato të akteve të këtij lloji (rregullore) që miratohen nga organet e tjera.

3. Për sa më sipër, duke pasur parasysh jo vetëm statusin dhe vlerën e ligjit që Kushtetuta i ka njohur Rregullores, si një ligj i posaçëm, duke qenë ligji organik i Kuvendit, si edhe parashikimet e nenit 51, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, i cili përcakton se gjatë shqyrtimit të kërkesave të parashikuara nga nenet 49 e 50 të këtij ligji (pra gjatë shqyrtimit të kontrollit abstrakt të pajtueshmërisë së ligjit me Kushtetutën), Gjykata vlerëson: a) përmbajtjen e ligjeve dhe të akteve normative; b) formën e ligjeve dhe të akteve normative; c) procedurën për miratimin, shpalljen dhe hyrjen në fuqi të tyre. Për rrjedhojë, Gjykata, për sa kohë që është vënë në lëvizje për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit ndryshues të ligjit për komisionet hetimore, ajo ndalet në shqyrtimin jo vetëm të përmbajtjes së tyre, por nëse ka pretendime për procedurën e miratimit, siç është rasti konkret, edhe në verifikimin e respektimit të dispozitave përkatëse të Rregullores, mbi bazën e të cilave ajo vlerëson edhe respektimin e dispozitave kushtetuese që materializohen përmes normave të Rregullores. Mbi këto argumente unë i qëndroj qasjes se të tilla

pretendime bëjnë pjesë në juridiksionin e Gjykatës dhe nuk bëjnë pjesë në ato çështje që bien jashtë kontrollit kushtetues mbi bazën e parimit të autonomisë parlamentare, për rrjedhojë ai duhej të ishte shqyrtuar në themel nga shumica.

4. Referuar qëndrimit të shumicës, në përgjigje të pretendimit të kërkuarit për respektimin e procedurës së miratimit të ligjit ndryshues, ajo ka argumentuar se ai nuk ka ngritur ndonjë pretendim për cenimin e standardeve dhe parimeve kushtetuese në drejtim të ushtrimit të nismës ligjvënëse nga dy deputetët e pakicës parlamentare, madje nuk ka paraqitur asnjë argument nëse mosrespektimi i procedurës së nismës ligjvënëse ka prekur kushtetutshmërinë e ligjit të kundërshtuar. Ndërsa, për sa u takon argumenteve që lidhen me mënyrën e zhvillimit të mbledhjeve (në platformën *online*, pa pjesëmarrjen e deputetëve të pakicës dhe pa konsensusin politik të tyre), shumica ka vlerësuar se ato kanë të bëjnë me aspekte të brendshme të veprimtarisë së Kuvendit në shqyrtimin dhe miratimin e nismave ligjore të deputetëve. Sipas shumicës, ato i përkasin autonomisë parlamentare të Kuvendit dhe nuk i nënshtrohen kontrollit kushtetues, ndaj pretendimi i kërkuarit për mosrespektimin e procedurës së miratimit të ligjit të kundërshtuar, në formën se si janë paraqitur argumentet nga kërkuari, nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata (*shih paragrafin 22 të vendimit*).

5. Edhe pse jam dakord me pjesën e parë (fjalë e parë) të qëndrimit të mbajtur nga shumica në paragrafin 22 të vendimit, nuk pajtohem me qëndrimin e mbajtur në pjesën tjetër të tij. Në këtë kuptim, për sa kohë që bëhet fjalë për ushtrimin e kontrollit të miratimit të një ligji në përputhje me një ligj tjetër organik, siç është Rregullorja e Kuvendit, Gjykata duhet të vlerësojë edhe verifikimin e pretendimeve për respektimin e procedurës parlamentare të diskutimit dhe miratimit të tij. Për rrjedhojë, në lidhje me pretendimin e kërkuarit për mosrespektimin e procedurës së miratimit të ligjit ndryshues, pasi nuk është respektuar parashikimi i nenit 5/a të Rregullores, vlerësoj, ndryshe nga shumica, se ai është një pretendim që bën pjesë në juridiksionin kushtetues, por, nga ana tjetër, kërkuari nuk ka sjellë në këtë drejtim argumente për cenimin e standardeve dhe parimeve kushtetuese. Kërkuari nuk ka sjellë argumente të mjaftueshme për të provuar cenimin e të drejtave të tij kushtetuese dhe nuk ka arritur të provojë se si zhvillimi i mbledhjes



në platformën *zoom* në komisionin parlamentar për diskutimin e ligjit dhe procedurën e miratimit të tij i ka cenuar të drejtat e tij kushtetuese, ndaj vlerësoj se ky pretendim i tij është i pabazuar, për rrjedhojë ai duhej të ishte rrëzuar në drejtim të themelit të tij.

6. Për sa i përket qëndrimit të shumicës në lidhje me kërkimet për shfuqizimin e neneve 6, pika 3, shkronja “d” dhe 7, pika 1, të ligjit ndryshues, nuk jam dakord me shumicën që ka vendosur rrëzimin e kërkesës dhe në vijim do të parashtoj argumentet ku mbështes qëndrimin tim për secilën nga këto dispozita.

Për nenin 6, pika 3, shkronja “d”, të ligjit ndryshues

7. Sipas shumicës, edhe pse dispozitat e nenit 6 të ligjit ndryshues të kundërshtuara nga kërkuuesi në dukje lënë hapësirë për mënyrën e interpretimit të tyre gjatë zbatimit rast pas rasti nga komisioni hetimor, kjo nuk është e mjaftueshme për ta bërë normën jokushtetuese, për sa kohë që ato lejojnë disa mënyra interpretimi, duke i dhënë mundësinë Gjykatës që të verifikojë, përmes interpretimit pajtues, nëse ka një interpretim që është në pajtim me Kushtetutën. Nisur nga konteksti i këtyre dispozitave dhe nga qëllimi e kuptimi i përmbajtjes së nenit 12 të ligjit për komisionet hetimore, shumica ka vlerësuar se qëllimi i tyre, në thelb, është siguria publike dhe garantimi i të drejtave kushtetuese për jetë private dhe familjare dhe ai nuk duket se synon që të cenojë të drejtën e publikut për transparencë, pra zhvillimin e kësaj veprimtarie larg syrit dhe vëzhgimit të publikut. Me qëllim garantimin e këtyre të drejtave, shumica ka vlerësuar se gjatë zbatimit të këtyre dispozitave ato duhet të interpretohen nga komisioni vetëm në atë mënyrë që shmang rrezikun për vlerësim subjektiv në përcaktimin e natyrës së këtyre të dhënave. Për këtë qëllim, shumica ka vlerësuar se në përkufizimin se cila e dhënë do të konsiderohet ose klasifikohet si sekret tregtar, komisioni duhet t’i referohet vetëm përcaktimit ligjor “*sekret tregtar*” sipas legjislacionit në fuqi. Ndërsa në lidhje me parashikimin “*sekretit në interes të shtetit*”, e cila pavarësisht se përfshin edhe konceptin e “*sekretit shtetëror*”, në vetvete paraqet një koncept më të gjerë sesa ai. Prandaj, ky parashikim ligjor duhet të zbatohet dhe interpretohet nga komisioni hetimor vetëm si çdo e dhënë e parashikuar si informacion i klasifikuar në bazë të ligjit, përfshirë edhe “*sekretin hetimor*” (*shih paragrafin 88 të vendimit*).

8. Edhe pse shumica është përpjekur që ta mbështesë qëndrimin e saj në raportin mes së drejtës

për transparencë dhe informim të publikut me të drejtat e tjera kushtetuese, vlerësoj se përmbajtja e kësaj dispozite nuk lë hapësirë për interpretim pajtues, ndaj vlerësoj se arsyetimi i shumicës në këtë drejtim është i sforcuar. Edhe pse unë, gjithashtu, jam e qëndrimit se Gjykata mund të ndërhyjë në rastet kur norma ka mundësi të shërohet përmes interpretimit pajtues të saj, se sa të krijohet një boshllëk ligjor përmes shfuqizimit të normës që, deri në plotësimin e tij nga Kuvendi, mund të krijojë pasoja jokushtetuese, në rastin konkret kjo është e pamundur, për sa kohë që mënyra se si është formuluar shkronja “d”, e pikës 3, të nenit 6, është aq e gjerë sa është e pamundur të bëhet ndonjë interpretim i saj që të jetë në linjë me standardet, parimet dhe të drejtat kushtetuese.

9. Në vlerësimin tim, i vetmi shkak i pranueshëm për zhvillimin e mbledhjeve me dyer të mbyllura, referuar kjo edhe legjislacionit në fuqi, që mund të jetë i lejueshëm në aspektin kushtetues, është vetëm kur kemi të bëjmë me informacione që kanë të bëjnë me “*sekret shtetëror*”. Në rastin konkret, sipas gjykimit tim, e drejta e informimit prevalon mbi interesat e shtetit, për sa kohë që ushtrimi i veprimtarisë së komisionit hetimor synon që të garantojë llogaridhënien e organeve shtetërore (pra të qeverisë), e cila është një nga instrumentet e funksionit kontrollues të Kuvendit. Për rrjedhojë, hetimi efektiv lidhet edhe me interesin e publikut që të njihet me veprimtarinë e institucioneve shtetërore, vetëm kur bëhet fjalë për të dhëna ose informacione të tilla që lidhen me aspekte të kësaj veprimtarie që është e ndaluar që të bëhen publike sipas legjislacionit në fuqi.

10. Ligji nr. 10/2023, datë 2.2.2023, “Për informacionin e klasifikuar” (*ligji nr. 10/2023*), përcakton parimet bazë dhe rregullat për krijimin, administrimin, deklasifikimin, zhvlerësimin dhe mbikëqyrjen e informacionit të klasifikuar gjatë gjithë ciklit jetësor të tij (*neni 1*) kurse qëllimi i tij është mbrojtja e informacionit të klasifikuar nga humbja, dëmtimi, rrjedhja, komprometimi ose ekspozimi i paautorizuar (*neni 2*). Neni 4, pika 11, i ligjit nr. 10/2023, parashikon se “informacioni i klasifikuar “*Sekret shtetëror*” është çdo dokument ose material, pavarësisht nga forma dhe natyra e tij, i përgatitur ose që përgatitet, të cilit i është vendosur një nivel i caktuar klasifikimi dhe afat ruajtjeje klasifikimi në përputhje me këtë ligj, në interes të sigurisë kombëtare dhe mbrohet nga shkatërrimi,



humbja, vjedhja, rrjedhja, përhapja e paautorizuar ose qasja nga çdo lloj tjetër komprometimi sigurie, kurse neni 14 parashikon se “Material i klasifikuar ‘Sekret shtetëror’” përfshin dokumentet, makineritë, pajisjet, armatimet dhe komponentët e tyre të prodhuara ose në proces prodhimi, klasifikuar sipas këtij ligji.

11. Neni 9, i ligjit nr. 10/2023, parashikon se informacioni i klasifikuar “sekret shtetëror”, në bazë të përmbajtjes, të vlerave dhe interesit shtetëror, klasifikohet në njërin nga katër nivelet e mëposhtme: a) “Tepër sekret”, kur ekspozimi i paautorizuar mund t’i shkaktojë dëme jashtëzakonisht të rënda sigurisë kombëtare; b) “Sekret”, kur ekspozimi i paautorizuar mund t’i shkaktojë dëme serioze sigurisë kombëtare; c) “Konfidencial”, kur ekspozimi i paautorizuar mund t’i shkaktojë dëme sigurisë kombëtare; ç) “I kufizuar”, kur ekspozimi i paautorizuar mund të dëmtojë veprimtarinë ose efektivitetin e institucioneve të administratës publike në fushën e sigurisë kombëtare. Në nenin 5 të ligjit janë parashikuar parimet e sigurisë së informacionit të klasifikuar, që janë: a) konfidencialiteti që nënkupton mbrojtjen e informacionit të klasifikuar nga qasja e paautorizuar; b) integriteti që nënkupton mbrojtjen e informacionit të klasifikuar nga modifikimi i paautorizuar; c) disponibiliteti që nënkupton garantimin e qasjes së nevojshme dhe përdorimit të informacionit të klasifikuar prej personave të autorizuar; ç) autenticiteti që nënkupton garantimin që informacioni i klasifikuar është origjinal nga burim i besueshëm dhe i vërtetueshëm; d) pamohueshmëria që nënkupton sigurinë, që dërguesi dhe marrësi nuk mohojnë procesin e shkëmbimit të informacionit. Ai përcakton edhe masat që zbatojnë institucionet e administratës publike dhe operatorët ekonomikë, që kanë qasje në informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, ndërkohë që, sipas pikës 4, të nenit 6, e drejta e informimit nuk refuzohet automatikisht kur informacioni i kërkuar është i klasifikuar, referuar pikës 5, të nenit 17, të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit” dhe informacioni nuk publikohet vetëm kur është i klasifikuar “sekret shtetëror”.

12. Bazuar edhe në përmbajtjen e dispozitave të ligjit nr. 10/2023, që përcakton në mënyrë të qartë klasifikimin e informacioneve, materialeve dhe të dhënave, parimet dhe rregullat për ruajtjen dhe mbrojtjen e tij, unë kam mbajtur qasjen se vetëm në

rast se do të kemi të bëjmë me një informacion që përbën “sekret shtetëror”, sipas përcaktimeve të atij ligji, do të ishte me vend që të procedohej nëpërmjet një seance me dyer të mbyllura. Në këtë analizë, në qasjen time shoh cenim në shprehjen “sekret në interes të shtetit” dhe ndaj jam për shfuqizimin e kësaj pjese për të evituar në këtë mënyrë klasifikimin abuziv të çdo informacioni për trajtim përpara komisionit hetimor si “sekret në interes të shtetit”, duke e cenuar në këtë mënyrë transparencën dhe të drejtën e informimit nëpërmjet mekanizmave fiktivë siç është edhe përcaktimi i natyrës së informacionit.

Për nenin 7, pika 1, të ligjit ndryshues

13. Në lidhje me nenin 7, pika 1, të ligjit ndryshues, shumica ka vlerësuar se mënyra se si ka vepruar ligjvënësi ka krijuar boshllëk ligjor për shkak se nuk ka parashikuar në përmbajtjen e tij garancitë e plota procedurale për të garantuar të drejtën e pakicës parlamentare për kontroll efektiv parlamentar (*shih paragrafin 55 të vendimit*). Sipas shumicës, në kuptim të qëllimit dhe natyrës së veprimtarisë që kryen komisioni hetimor, i cili në çdo rast duhet të respektojë kriteret kushtetuese, duke u kufizuar vetëm brenda qëllimit për të cilin është ngritur dhe në dobi të shqyrtimit të çështjes objekt i veprimtarisë së tij, edhe marrja e provave ose pyetja e dëshmitarëve përcaktohen në mënyrë të drejtpërdrejtë vetëm nga sfera e kësaj veprimtarie, e cila nuk është/mund të jetë e pakufizuar. Në kuptim, shumica ka vlerësuar se kufizimi i së drejtës së komisionit për marrjen e provave ose thirrjen e dëshmitarëve është i lidhur dhe përcaktohet vetëm nga objekti i hetimit dhe natyra e çështjes së veçantë që hetohet dhe se çdo qëndrim i ndryshëm do të vinte në diskutim vetë thelbin e së drejtës së pakicës parlamentare për të kërkuar hetim parlamentar e, për rrjedhojë, edhe vetë funksionin e Kuvendit për hetim parlamentar. Megjithatë, sipas shumicës, për të garantuar kontrollin efektiv parlamentar, vendimi i ndërmjetëm për refuzimin e provës duhet të jetë një rast përjashtimor nga rregulli i përgjithshëm, sipas të cilit provat e kërkuara nga pakica parlamentare duhet të merren përveçse në ato raste kur kërkesa për marrje provash ose thirrje të dëshmitarëve del jashtë objektit të hetimit ose e bën procesin joefektiv, për shkak se shkakton tejzgjatje abuzive të tij. Po kështu, shumica ka vlerësuar se vendimi për refuzim, në çdo rast, duhet të jetë i arsyetuar në drejtim të shkaqeve të refuzimit, jo vetëm për të garantuar parimin e bashkëpunimit



luajal mes shumicës dhe pakicës parlamentare, por për të garantuar edhe kontrollin kushtetues në rast mosmarrëveshjeje (*shih paragrafin 54 të vendimit*).

14. Në ndryshim nga shumica, vlerësoj se konstatimi i boshllëkut ligjor nuk është i mjaftueshëm për të riparuar në aspektin kushtetues këtë dispozitë. Në vlerësimin tim, ajo është jokushtetuese, jo për shkak se nuk parashikon garanci gjatë veprimtarisë së komisionit hetimor për marrjen e provave, por sepse, në vetvete, risia e sjellë me ligjin ndryshues, i cili ia nënshtron marrjen e provave shtimit të një hallke të re, që është procesi i votimit (i cili në ligjin e ndryshuar nuk parashikohet si procedurë, pasi provat merreshin automatikisht në çdo rast që kërkoheshin, pa votim, sipas formulimi të mëparshëm të pikës 4, të nenit 13 të ligjit, për komisionet hetimore, sipas së cilës *“kërkesa për hetim ose marrje provash nga çdo anëtar i komisionit pranohet nga komisioni pa votim”*), si dhe parashikimi i këtij procesi që finalizohet me një vendimarrje (e cila në vetvete nënkupton një kuorum të nevojshëm) të shumicës së anëtarëve e zhvesh pakicën parlamentare nga e drejta për një hetim efektiv, duke e lënë vlerësimin në vendimarrjen e shumicës parlamentare, e cila, në fakt, përkthehet në vendimarrje vetëm të kësaj të fundit.

15. Në përfundim, bazuar në argumentet e mësipërme, vlerësoj se Gjykata duhet të pranonte kërkesën, duke shfuqizuar edhe nenet 6, pika 3, shkronja “d” dhe 7, pika 1, të ligjit ndryshues, si të papajtueshme me Kushtetutën.

Anëtare: Sonila Bejtja

NJOFTIM

Nr. 11830/2, datë 7.8.2024

MBI HYRJEN NË FUQI TË MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Ukrainës, për punësimin fitimprurës të anëtarëve të familjes së anëtarëve të misioneve diplomatike ose posteve konsullore, nënshkruar më datë 28 shkurt 2024 dhe do të hyjë në fuqi më datë 1 shtator 2024.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT
E JASHTME
Armand Skapi

VENDIM

Nr. 42, datë 7.8.2024

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR LICENCIMIN, USHTRIMIN E VEPRIMTARISË, REVOKIMIN E LICENCËS DHE LIKUIDIMIN E PORTOFOLIT TË KREDIVE TË KRIJUAR NGA USHTRIMI I VEPRIMTARISË FINANCIARE NGA SUBJEKTET FINANCIARE JOBANKA”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “b”, nenit 12, shkronja “a” dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të nenit 126, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për licencimin, ushtrimin e veprimtarisë, revokimin e licencës dhe likuidimin e portofolit të kredive të krijuar nga ushtrimi i veprimtarisë financiare nga subjektet financiare jobanka”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 1, datë 17.1.2013, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pas nenit 6, shtohet neni 6/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

“Neni 6/1

Forma ligjore

Forma ligjore e shoqërisë që kërkon të ushtrojë veprimtari financiare si subjekt financiar jobankë ose si institucion financiar i mikrokredisë, me përjashtim të subjekteve që kërkojnë të ushtrojnë vetëm veprimtari të financiare të faktoringut dhe/ose të qirasë financiare, duhet të jetë shoqëri aksionare, sipas dispozitave të parashikuara në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;

b) Në nenin 8 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në pikën 1 dhe në pikën 2, shkronjat “P”, “h” dhe “i”, kudo pas fjalës “themeluesit”, shtohet togfjalëshi “/aksionerët/ortakët”;

ii. në pikën 2, shkronja “d”, togfjalëshi “Qendra Kombëtare e Regjistrimit”, zëvendësohet me togfjalëshin “Qendra Kombëtare e Biznesit”;



iii. në pikën 2, shkronja “g”, nënpikat “i” dhe “ii”, pas fjalës “themeluesve”, shtohet togfjalëshi “/ aksionerëve/ ortakëve”, dhe në shkronjën “i”, pas fjalës “themeluesi”, shtohet togfjalëshi “/ aksioneri / ortaku”;

iv. në pikën 2, përmbajtja e shkronjës “j” ndryshon si më poshtë:

“j) dokumentacioni për kryetarin e këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administratorin dhe kryetarin e komitetit të kontrollit, siç parashikohet në nenin 9/1 të kësaj rregulloreje dhe dokumentacioni i mëposhtëm:”;

c) Në nenin 9, pika 1, pas togfjalëshit “Subjekti financiar jobankë dhe institucioni financiar i mikroreditë”, shtohet togfjalëshi “krijon organet e parashikuara në nenin 134 të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe,”;

d) Në nenin 10 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në pikën 1, shkronja “a” dhe në pikën 2, shkronjat “b” dhe “d”, pas fjalës “themeluesit”, shtohet togfjalëshi “/ aksionerët/ ortakët”;

ii. në pikën 1, shkronja “b” dhe në pikën 2, shkronja “c”, pas fjalës “themeluesve”, shtohet togfjalëshi “/ aksionerëve/ ortakëve”;

e) Në nenin 14, pika 1, shkronja “b” pas fjalës “themeluesit”, shtohet togfjalëshi “/ aksionerët/ ortakët” dhe në shkronjën “g”, pas fjalës “themeluesve”, shtohet togfjalëshi “/ aksionerëve/ ortakëve”;

f) Në nenin 17, pika 1, shkronja “d”, nënpika “ii”, fjala “QKR”, zëvendësohet me togfjalëshin “Qendra Kombëtare e Biznesit”;

g) Në nenin 19, pika 1, shkronja “b”, togfjalëshi “Qendra Kombëtare e Regjistrimit”, zëvendësohet me togfjalëshin “Qendra Kombëtare e Biznesit”;

h) Në nenin 21 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në pikën 1, shkronja “d”, togfjalëshi “paragrafi 3”, zëvendësohet me togfjalëshin “paragrafi 2”;

ii. pas pikës 2, shtohen pikat 3, 4 dhe 5 me përmbajtjen e mëposhtme:

“3. Subjekti financiar jobankë ose institucioni financiar i mikroreditë, në rastin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë, paraqet në Bankën e Shqipërisë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vendimin e asamblesë së aksionerëve/ ortakëve për zmadhimin e kapitalit;

b) relacionin shoqërues për rritjen e kapitalit;

c) deklaratën noteriale lidhur me burimin e krijimit të kapitalit, të shoqëruar me dokumentacion justifikues sipas përcaktimit të shkronjës “g” të pikës 2 të nenit 8 të kësaj rregulloreje.

4. Subjekti financiar jobankë ose institucioni financiar i mikroreditë, në rastin e ndryshimeve në strukturën e

kapitalit, paraqet në Bankën e Shqipërisë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) aktin për veprimin juridik përkatës, që sjell më pas ndryshimet në strukturën e kapitalit;

b) vendimin e organit drejtues të shoqërisë për dhënien e pëlqimit për kalimin e pronësisë të aksioneve/kuotave (nëse është e aplikueshme);

c) relacionin shoqërues për ndryshimet në strukturën e kapitalit;

d) deklaratën noteriale të aksionerëve/ ortakëve përfitues lidhur me burimin e krijimit të kapitalit, të shoqëruar me dokumentacion justifikues sipas përcaktimit të shkronjës “g” të pikës 2 të nenit 8 të kësaj rregulloreje;

e) vërtetime, për aksionerët/ ortakët përfitues, të lëshuara nga organet kompetente sipas juridiksionit përkatës, se:

i. personi nuk është në ndjekje penale (kur është e aplikueshme);

ii. personi nuk është në gjykim për vepra penale (kur është e aplikueshme);

iii. personi nuk është i dënuar penalisht (kur është e aplikueshme);

iv. personi nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera;

v. ndaj personit nuk kanë filluar procedura të paafsisë paguese, të falimentimit ose të likuidimit, etj. (kur është e aplikueshme).

Vërtetimet e lartpërmendura të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së njoftimit në Bankën e Shqipërisë;

f) deklaratën e aksionerit/ortakut përfitues, e cila përmban informacion për marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë (sipas formularit nr. 11 të kësaj rregulloreje).

5. Banka e Shqipërisë, nëse e çmon të nevojshme, mund të kërkojë rast pas rasti edhe dokumente apo informacione shtesë, përveç sa është parashikuar në këtë nen.”;

i) Në nenin 32, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. pikat 1 dhe 2 shfuqizohen;

ii. pas pikës 3, shtohen pikat 4 dhe 5 me përmbajtjen e mëposhtme:

“4. Subjektet financiare jobanka dhe institucionet financiare të mikroreditë, me përjashtim të subjekteve që ushtrojnë vetëm veprimtari të financiare të faktoringut dhe/ose të qirasë financiare, të licencuara si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k) nga Banka e Shqipërisë përpara datës 1 shtator 2024, marrin masat e nevojshme për të përmbushur kërkesën në lidhje me formën ligjore, në përputhje me kërkesat e nenit 6/1 të kësaj rregulloreje, dhe krijimin e organeve sipas përcaktimeve të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, si



dhe njoftojnë Bankën e Shqipërisë, brenda datës 31 mars 2025. Këto subjekte gjithashtu paraqesin në Bankën e Shqipërisë, dokumentacionin e parashikuar në nenin 9/1 dhe sigurojnë plotësimin e kërkesave të nenit 9/2 të kësaj rregulloreje, brenda datës 31 dhjetor 2025.

5. Subjektet financiare jobanka dhe institucionet financiare të mikrokredisë të licencuara nga Banka e Shqipërisë përpara datës 1 shtator 2024, marrin masat e nevojshme për të përmbushur kërkesën në lidhje me krijimin e hapësirave të posaçme dhe kushteve të nevojshme për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit lidhur me veprimtarinë financiare, në përputhje me kërkesat e pikës 5 të formularit 7 të kësaj rregulloreje, si dhe njoftojnë Bankën e Shqipërisë, brenda datës 31 mars 2025.”;

j) Në formularin nr. 5 (aneksi i rregullores), pas fjalës “themelues”, shtohet togfjalëshi “aksioner/ortak”;

k) Në formularin nr. 6 (aneksi i rregullores), togfjalëshi “Ky dokument është i vlefshëm për 6 muaj”, zëvendësohet kudo me togfjalëshin “Vlefshmëria e këtij dokumenti është pa afat të përcaktuar”, si dhe pas fjalës “themelues”, shtohet togfjalëshi “/ aksioner/ortak”;

l) Në formularin nr. 7 (aneksi i rregullores), pas pikës 4, shtohet pika 5 me përmbajtjen e mëposhtme:

“5. Informacion mbi hapësira/njedisë të veçanta të nevojshme, si dhe kushte të përshtatshme për evidentimin, mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit lidhur me veprimtarinë financiare.”.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1 shtator 2024.

KRYETAR
Gent Sejko

VENDIM
Nr. 43, datë 7.8.2024

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR INFORMACIONIN QË
SHOQËRON TRANSFERTAT
E FONDEVE”

Në mbështetje të nenit 1, pika 4, shkronja “b”, nenit 3, pika 3, nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 9, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjit 55/2020, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave”; ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për informacionin që shoqëron transfertat e fondeve”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ofruesit e shërbimeve të pagesave të përcaktuar në nenin 3, pika 2, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të ligjit nr. 55, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave”, për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko



RREGULLORE
PËR INFORMACIONIN QË SHOQËRON
TRANSFERTAT E FONDEVE

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, për:

a) informacionin mbi pagesit dhe përfituesit e pagesave që shoqëron transfertat e fondeve, në Euro, në kontekstin e Zonës Unike të Pagesave në Euro (SEPA), pjesëmarrjen e ofruesve të shërbimeve të pagesave në Shqipëri, në skemat e pagesave të administruara nga Këshilli Evropian i Pagesave dhe për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në rastet kur të paktën një nga ofruesit e shërbimeve të pagesave i përfshirë në transfertën e ekzekutuar në një skemë pagese të administruar nga Këshilli Evropian i Pagesave është i vendosur dhe i licencuar në Shqipëri;

b) politikat, procedurat dhe kontrollet e brendshme për të siguruar zbatimin e masave shtrënguese, kur të paktën një nga ofruesit e shërbimeve të pagesave është i vendosur dhe i licencuar në Shqipëri, pavarësisht transaksionit të përfshirë ose monedhës së përdorur.

Neni 2
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë ofruesit e shërbimeve të pagesave, siç përcaktohen në nenin 3, pika 2, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave”.

Neni 3
Baza ligjore

Kjo rregullore nxirret në mbështetje të:

a) nenit 1, pika 4, shkronja “b”, nenit 3, pika 3, nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”;

b) nenit 9, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili në këtë rregullore do të quhet ligji “Për bankat”;

c) ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave”, i cili në këtë rregullore do të quhet ligji “Për shërbimet e pagesave”;

d) ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, i cili në këtë rregullore do të quhet ligji “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.

Neni 4
Fusha e zbatimit

1. Parashikimet e neneve 7 deri në 14 të kësaj rregulloreje zbatohen për transfertat e fondeve në Euro, të dërguara ose të përfituara, nga ofruesit e shërbimeve të pagesave ose ofruesit ndërmjetës të shërbimeve të pagesave, të licencuar dhe që operojnë në Shqipëri, si pjesëmarrës në një skemë pagese të administruar nga Këshilli Evropian i Pagesave, ku të paktën një nga ofruesit e shërbimeve të pagesave ose ofruesit ndërmjetës të shërbimeve të pagesave i përfshirë në transaksion është i vendosur dhe i licencuar në Shqipëri.

2. Parashikimet e neneve 15 deri në 18 të kësaj rregulloreje zbatohen për të gjithë ofruesit e shërbimeve të pagesave të licencuar dhe që operojnë në Shqipëri, pavarësisht nga sistemi, skema, transaksioni ose monedha e përdorur.

3. Kjo rregullore zbatohet kur një kartë pagese, një instrument i parasë elektronike, një telefon celular ose çdo pajisje tjetër digjitale ose e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) me parapagesë ose me kontratë me karakteristika të ngjashme, përdoret për të kryer një transfertë fondesh ndërmjet personave fizikë që veprojnë si konsumatorë jo për qëllime tregtare, të biznesit ose profesionale.

Neni 5
Përfshirjet nga fusha e zbatimit

Kjo rregullore nuk zbatohet për:

a) shërbimet e renditura në shkronjat “a” deri në “i” dhe në shkronjën “k” të nenit 4 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”;

b) transfertat e fondeve të kryera duke përdorur një kartë pagese, një instrument të parasë



elektronike, një telefon celular ose çdo pajisje tjetër digjitale ose të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) me parapagesë ose me kontratë me karakteristika të ngjashme, në rastet kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. karta, instrumenti ose pajisja është përdorur ekskluzivisht për të paguar për mallra dhe shërbime, dhe

ii. numri i kartës, instrumentit ose pajisjes shoqëron të gjitha transfertat që rrjedhin nga transaksioni;

c) personat që nuk kryejnë aktivitet tjetër përveç konvertimit të dokumenteve në letër në të dhëna elektronike dhe që e bëjnë këtë bazuar në një kontratë me një ofrues të shërbimeve të pagesave, ose për personat që nuk kryejnë asnjë aktivitet tjetër përveç se t'u sigurojnë ofruesve të shërbimeve të pagesave, shërbime të transmetimit të mesazheve ose sisteme të tjera mbështetëse për transmetimin e fondeve ose sisteme të klerimit dhe shlyerjes;

d) transfertën e fondeve, kur plotësohet ndonjë nga kushtet e mëposhtme:

i. përfshin tërheqjen e parave fizike nga paguesi nga vetë llogaria e tij e pagesave (paguesit);

ii. përbën një transfertë fondesh te një autoritet publik kombëtar si pagesë për taksat, gjokat ose detyrime të tjera financiare brenda Shqipërisë;

iii. si paguesi ashtu edhe përfituesi janë ofrues të shërbimeve të pagesave që veprojnë secili në emër të vet;

iv. kryhet përmes shkëmbimeve të imazheve të çeqeve, duke përfshirë çeqet “*truncated*”;

e) transfertat e fondeve brenda Shqipërisë në llogarinë e pagesave të përfituesit që lejon pagesën ekskluzivisht për ofrimin e mallrave ose shërbimeve kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

i. ofruesi i shërbimit të pagesave të përfituesit zbaton kërkesat e ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”;

ii. ofruesi i shërbimit të pagesave të përfituesit është në gjendje të gjurmtojë, nëpërmjet përfituesit, me anë të një kodi unik të identifikimit të transaksionit, transferimin e fondeve nga personi që ka një marrëveshje me përfituesin për ofrimin e mallrave ose shërbimeve;

iii. shuma e transfertës së fondeve nuk tejkalon 1,000 euro.

Neni 6

Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përdorur në ligjin “Për shërbimet e pagesave”, në ligjin “Për bankat” dhe në ligjin “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “**financim i terrorizmit**” është financimi i terrorizmit sipas neneve 230/a deri në 230/ç të Kodit Penal;

b) “**pastrim i parave**” është pastrimi i produkteve të veprës penale të parashikuar në nenin 287 të Kodit Penal;

c) “**ofrues i shërbimeve të pagesave ndërmjetës**” është një ofrues i shërbimeve të pagesave që nuk është ofrues i shërbimeve të pagesave i paguesit ose i përfituesit dhe që merr dhe transmeton një transfertë fondesh në emër të ofruesit të shërbimeve të pagesave të paguesit ose të përfituesit ose të një ofruesi të shërbimeve të pagesave tjetër ndërmjetës;

d) “**transfertë e fondeve**” është çdo transaksion i kryer të paktën pjesërisht me mjete elektronike në emër të një paguesi, përmes një ofruesi të shërbimeve të pagesave, me synimin për t'i bërë fondet të disponueshme te një përfitues, përmes një ofruesi të shërbimeve të pagesave, pavarësisht nëse paguesi dhe përfituesi janë i njëjti person dhe pavarësisht nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit dhe ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit janë një dhe i njëjti, duke përfshirë:

i. një transfertë krediti,

ii. një debitim direkt,

iii. një dërgesë parash (*remitanca*),

iv. një transfertë të kryer duke përdorur një kartë pagese, një instrument të parasë elektronike, një telefon celular ose çdo pajisje tjetër digjitale ose të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), me parapagesë ose me kontratë, me karakteristika të ngjashme;

e) “**transfertë në grup**” (*batch file*) është një bashkësi e disa transfertave të fondeve të grupuara me qëllim transmetimi;

f) “**kod unik i identifikimit të transaksionit**” është një kombinim shkronjash, numrash ose simbolesh, të përcaktuara nga ofruesi i shërbimeve



të pagesave, në përputhje me protokollet e sistemeve të pagesave dhe shlyerjeve ose sistemeve të mesazheve të përdorura për transferimin e fondeve, gjë që lejon gjurmimin e transaksionit të paguesi dhe përfituesi;

g) **“kod i identifikimit të subjektit juridik”** (*Legal Entity Identifier*) është një kod unik referimi alfanumerik i bazuar në standardin ISO 17442, i caktuar për një person juridik;

h) **“skemë pagese”** është një grup i vetëm rregullash, praktikash, standardesh dhe/ose udhëzimesh zbatimi për të cilat është rënë dakord ndërmjet ofruesit të shërbimeve të pagesave për ekzekutimin e transaksioneve të pagesave brenda Shqipërisë dhe në të gjithë Zonën Unike të Pagesave në Euro (*SEPA*), dhe që është e ndarë nga çdo infrastrukturë ose sistem pagese që mbështet funksionimin e saj;

i) **“SEPA”** është Zona Unike e Pagesave në Euro (*Single Euro Payments Area*);

j) **“zona SEPA”** - është shtrirja gjeografike e skemave të SEPA-s siç përcaktohet nga kriteret e vendosura nga Këshilli Evropian i Pagesave (KEP);

k) **“skemë pagese SEPA e KEP”** është një skemë pagese e administruar nga Këshilli Evropian i Pagesave (KEP).

KREU II

DETYRIMET E OFRUESIT TË SHËRBIMEVE TË PAGESAVE PËR INFORMACIONIN QË SHOQËRON TRANSFERTAT E FONDEVE

NËNKREU I

DETYRIMET E OFRUESIT TË SHËRBIMEVE TË PAGESAVE TË PAGUESIT

Neni 7

Informacioni që shoqëron transfertat e fondeve

1. Ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit sigurohet se transfertat e fondeve shoqërohen me informacionin e mëposhtëm për paguesin:

a) emri dhe mbiemri i paguesit ose emri i personit juridik të paguesit;

b) numri i llogarisë së pagesës së paguesit;

c) adresa e paguesit, përfshirë emrin e shtetit apo juridiksionit, numri i dokumentit të identifikimit dhe

numri personal i klientit, ose, si alternativë, ditëlindja dhe vendlindja e paguesit; dhe

d) kod i identifikimit të subjektit juridik (në varësi të ekzistencës së fushës së përkatëse në formatin e mesazhit të pagesës, dhe nëse paguesi ia ka siguruar ofruesit të shërbimeve të pagesave përkatës), ose në mungesë të tij, çdo numër unik identifikimi i barasvlershëm.

2. Ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit sigurohet që transfertat e fondeve shoqërohen me informacionin e mëposhtëm për përfituesin:

a) emri dhe mbiemri i përfituesit ose emri i personit juridik të përfituesit;

b) numri i llogarisë së pagesës së përfituesit; dhe

c) kod i identifikimit të subjektit juridik (në varësi të ekzistencës së fushës së përkatëse në formatin e mesazhit të pagesës, dhe nëse paguesi ia ka siguruar ofruesit të shërbimeve të pagesave përkatës), ose në mungesë të tij, çdo numër unik identifikimi i barasvlershëm.

3. Pa rënë ndesh me përcaktimet e pikës 1, shkronja “b”, dhe pikës 2, shkronja “b”, të këtij neni, në rastin e transfertave që nuk bëhen tek/ose nga një llogari pagesash, ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit duhet të sigurojë se transfertat e fondeve shoqërohet me një kod unik të identifikimit të transaksionit, në vend të numrit të llogarisë së pagesës.

4. Përpara transferimit të fondeve, ofruesi i shërbimit të pagesave të paguesit verifikon saktësinë e informacionit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dhe, ku është e zbatueshme, në pikën 3 të këtij neni, në bazë të dokumenteve, të dhënave ose informacionit të përftuar nga një burim i pavarur dhe i besueshëm.

5. Procesi i verifikimit, i parashikuar në pikën 4 të këtij neni, do të konsiderohet i kryer nëse:

a) identiteti i paguesit është verifikuar në përputhje me nenin 4/1 të ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” dhe informacioni i marrë nga ky verifikim ruhet në përputhje me nenin 16 të atij ligji;

b) dispozitat e nenit 4/1 të ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” zbatohen edhe kur paguesi është klient ekzistues.

6. Pa rënë ndesh me përjashtimet në nenin 8 dhe 9 të kësaj rregulloreje, ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit nuk do të ekzekutojë



transfertën e fondeve, pa siguruar përputhshmërinë e plotë me parashikimet e këtij neni.

Neni 8

Transfertat e fondeve brenda Shqipërisë

1. Pa rënë ndesh me përcaktimet në pikat 1 dhe 2 të nenit 7 të kësaj rregulloreje, kur të gjithë ofruesit e shërbimeve të pagesave të përfshirë në zinxhirin e pagesës janë të vendosur në Shqipëri, transfertat e fondeve shoqërohen të paktën me numrin e llogarisë së pagesës të paguesit dhe numrin e llogarisë së pagesës së përfituesit, ose, kur zbatohet pika 3 e nenit 7 të kësaj rregulloreje, kodin unik të identifikimit të transaksionit, pa cenuar kërkesat për informacion të përcaktuara në rregulloren “Për përcaktimin e kërkesave për transfertat e kreditit dhe të debitimit direkt në Euro”, kur kjo është e zbatueshme.

2. Pavarësisht nga pika 1 e këtij neni, ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit, brenda 3 ditëve pune pas marrjes së kërkesës për informacion nga ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit ose nga një ofrues i shërbimeve të pagesave ndërmjetës, vë në dispozicion si më poshtë:

a) për transfertat e fondeve që tejkalojnë shumën 1,000 euro, pavarësisht nëse këto transfertat kryhen si një transaksion i vetëm apo disa transaksione që vlerësohen të lidhura, informacionin mbi paguesin ose përfituesin në përputhje me nenin 7 të kësaj rregulloreje;

b) për transfertat e fondeve që nuk tejkalojnë shumën 1,000 euro, që nuk vlerësohen të lidhura me transfertat të tjera, të cilat, së bashku me transfertën në fjalë, tejkalojnë shumën 1,000 euro, informacionin që përmban të paktën:

i. emrin dhe mbiemrin e paguesit dhe të përfituesit, dhe

ii. numrin e llogarisë së pagesës së paguesit dhe të përfituesit, ose, kur zbatohet pika 3 e nenit 7 të kësaj rregulloreje, kodin unik të identifikimit të transaksionit.

3. Pa rënë ndesh me parashikimet në pikën 4 të nenit 7 të kësaj rregulloreje, në rastin e transfertave të fondeve të përmendura në shkronjën “b” të pikës 2 të këtij neni, ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit nuk ka nevojë të verifikojë informacionin mbi paguesin, përveç se kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit:

a) ka marrë fondet që do të transferohen në formën e parasë fizike (*cash*);

b) ka baza të arsyeshme të dyshojë për pastrim parash ose financim terrorizmi;

c) ka dyshime për vërtetësinë ose përshtatshmërinë e të dhënave të marra më parë; ose

d) ka dyshime për mashtrim.

Neni 9

Transfertat e fondeve jashtë Shqipërisë

1. Në rastin e një transferte në grup (*batch file*) nga një pagues i vetëm, ku ofruesit e shërbimeve të pagesave të përfituesve janë të vendosur jashtë territorit të Shqipërisë, pika 1 e nenit 7 të kësaj rregulloreje nuk zbatohet për transfertat individuale të grupuara në këtë formë, me kusht që transfertat në grup (*batch file*) të përmbajë informacionin e përcaktuar në pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 7 të kësaj rregulloreje, dhe ky informacion të jetë verifikuar në përputhje me pikat 4 dhe 5 të nenit 7 të kësaj rregulloreje dhe transfertat individuale të kenë numrin e llogarisë së pagesës të paguesit, ose kur zbatohet pika 3 e nenit 7 të kësaj rregulloreje, të kenë kodin unik të identifikimit të transaksionit.

2. Pa rënë ndesh me parashikimet në pikën 1 të nenit 7 të kësaj rregulloreje, dhe, aty ku është e zbatueshme, pa rënë ndesh me kërkesat për informacion të përcaktuara në rregulloren “Për përcaktimin e kërkesave për transfertat e kreditit dhe të debitimit direkt në Euro”, kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit është i vendosur jashtë territorit të Shqipërisë, transfertat e fondeve që nuk tejkalojnë shumën 1,000 euro dhe që nuk vlerësohen të lidhura me transfertat të tjera fondesh, të cilat, së bashku me transfertën në fjalë, tejkalojnë shumën 1,000 euro, shoqërohen me informacionin që përmban të paktën:

a) emrin dhe mbiemrin e paguesit dhe të përfituesit, ose emrin e personit juridik të paguesit dhe të përfituesit; dhe

b) numrin e llogarisë së pagesës së paguesit dhe të përfituesit, ose, aty ku është e zbatueshme pika 3 e nenit 7 të kësaj rregulloreje, kodin unik të identifikimit të transaksionit.

3. Pa rënë ndesh me parashikimet e pikës 4 të nenit 7 të kësaj rregulloreje, ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit nuk ka nevojë të verifikojë informacionin mbi paguesin të përmendur në pikën



2 të këtij neni, përveç se kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të pagesit:

- a) ka marrë fondet që do të transferohen në formën e parasë fizike (*cash*);
- b) ka baza të arsyeshme të dyshojë për pastrim parash ose financim terrorizmi;
- c) ka dyshime për vërtetësinë ose përshtatshmërinë e të dhënave të marra më parë; ose
- d) ka dyshime për mashtrim.

NËNKREU II DETYRIMET E OFRUESIT TË SHËRBIMEVE TË PAGESAVE TË PËRFTUESIT

Neni 10

Zbulimi i informacionit që mungon mbi paguesin ose përfituesin

1. Ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit zbaton procedura efektive për të zbuluar nëse fushat që lidhen me informacionin mbi paguesin dhe përfituesin në transmetimin e mesazheve, ose në sistemin e pagesave dhe të shlyerjeve që përdoret për të ekzekutuar transfertën e fondeve, janë plotësuar duke përdorur karaktere ose të dhëna të pranuar në përputhje me rregullat dhe procedurat nga ai sistem.

2. Ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit zbaton procedura efektive, përfshirë, aty ku është e përshtatshme, monitorimin gjatë ose pas transfertave, për të zbuluar nëse mungon informacioni i mëposhtëm mbi paguesin ose përfituesin:

a) për transfertat e fondeve, kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të pagesit është i vendosur në Shqipëri, informacioni i parashikuar në nenin 8 të kësaj rregulloreje;

b) për transfertat e fondeve, kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të pagesit është i vendosur jashtë Shqipërisë, informacioni i parashikuar në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 dhe në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2 të nenit 7 të kësaj rregulloreje;

c) për transfertat në grup (*batch file*), kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të pagesit është i vendosur jashtë Shqipërisë, informacioni i parashikuar në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 dhe në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2 të nenit 7 të kësaj rregulloreje, në lidhje me atë transfertë në grup (*batch file*).

3. Në rastin e transfertave të fondeve që tejkalojnë shumën 1,000 euro, pavarësisht nëse këto transferta kryhen si një transaksion i vetëm ose si disa transaksione që vlerësohen të lidhura, ofruesi i shërbimeve të pagesave i përfituesit, përpara kreditimit të llogarisë së pagesave të përfituesit ose vendosjes në dispozicion të fondeve për përfituesin, verifikon saktësinë e informacionit mbi përfituesin të përmendur në pikën 2 të këtij neni, bazuar në dokumente, të dhëna apo informacion të marrë nga një burim i pavarur dhe i besueshëm, pa rënë ndesh me kërkesat e përcaktuara në nenet 76 dhe 77 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”.

4. Në rastin e transfertave të fondeve që nuk tejkalojnë shumën 1,000 euro, që nuk vlerësohen të lidhura me transferta të tjera fondesh, të cilat, së bashku me transfertën në fjalë, tejkalojnë shumën 1,000 euro, ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit nuk ka nevojë të verifikojë saktësinë e informacionit mbi përfituesin, përveç se në rastet kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit:

- a) realizon pagesën e fondeve në formën e parasë fizike (*cash*);
- b) ka baza të arsyeshme të dyshojë për pastrim parash ose financim terrorizmi;
- c) ka dyshime për vërtetësinë ose përshtatshmërinë e të dhënave të marra më parë; ose
- d) ka dyshime për mashtrim.

5. Procesi i verifikimit, i parashikuar në pikat 3 dhe 4 të këtij neni, do të konsiderohet i kryer nëse:

a) identiteti i përfituesit është verifikuar në përputhje me nenin 4/1 të ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” dhe informacioni i marrë nga ky verifikim ruhet në përputhje me nenin 16 të atij ligji;

b) dispozitat e nenit 4/1 të ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” zbatohen edhe kur përfituesi është klient ekzistues.

Neni 11

Transfertat e fondeve me informacion të munguar ose jo të plotë mbi paguesin ose përfituesin

1. Ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit do të zbatojë procedura efektive të bazuara në rrezik, siç parashikohet në nenin 4/1 dhe nenin 11 të ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, në rastin e një transferte



fondesh së cilës i mungon informacioni i plotë i kërkuar mbi pagesin dhe mbi përfituesin, me qëllim që të përcaktojë nëse transfertat duhet ekzekutuar, refuzuar ose pezulluar, dhe për të ndërmarrë veprimet e duhura të mëtejshme.

2. Kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit vihet në dijeni, kur merr një transfertë të fondeve, se informacioni i parashikuar në nenin 7, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, nenin 7, pika 2, shkronjat “a” dhe “b”, nenin 8, pika 1, ose në nenin 9, mungon, nuk është i plotë ose nuk është plotësuar duke përdorur karaktere ose të dhëna të pranueshme, në përputhje me rregullat dhe procedurat e transmetimit të mesazheve ose të sistemit të pagesave dhe shlyerjeve, siç parashikohet në pikën 1 të nenit 10 të kësaj rregulloreje, ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit:

a) kërkon informacionin e nevojshëm për pagesin dhe përfituesin përpara kreditimit të llogarisë së pagesës së përfituesit ose vendosjes së fondeve në dispozicion të përfituesit;

b) refuzon transfertën, nëse informacioni i kërkuar sipas shkronjës “a” të kësaj pike nuk plotësohet,

siç parashikohet në nenin 10 të ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.

3. Në vijim të pikës 2 të këtij neni, ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit raporton pranë Agjencisë së Inteligjencës Financiare, transfertën e refuzuar për shkak të mossigurimit të informacionit dhe hapat e ndërmarrë, siç parashikohet në nenin 10 të ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.

NËNKREU III DETYRIMET PËR OFRUESIN E SHËRBIMEVE TË PAGESAVE NDËRMJETËS

Neni 12

Ruajtja e informacionit mbi pagesin dhe përfituesin që shoqëron transfertën

Ofruesi i shërbimeve të pagesave ndërmjetës siguron që i gjithë informacioni i marrë për pagesin dhe përfituesin që shoqëron një transfertë fondesh, ruhet me transfertën.

Neni 13

Zbulimi i informacionit që mungon mbi pagesin ose përfituesin

1. Ofruesi i shërbimeve të pagesave ndërmjetës zbaton procedura efektive për të zbuluar nëse fushat në lidhje me informacionin mbi pagesin dhe përfituesin në transferimin e mesazheve ose sistemin e pagesave dhe të shlyerjeve të përdorura për të realizuar transfertën e fondeve, janë plotësuar duke përdorur karaktere ose të dhëna të pranueshme në përputhje me rregullat dhe procedurat e atij sistemi.

2. Ofruesi i shërbimeve të pagesave ndërmjetës zbaton procedura efektive, duke përfshirë, kur është e përshtatshme, monitorimin gjatë ose pas transfertave, për të zbuluar nëse mungon informacioni i mëposhtëm për pagesin ose përfituesin:

a) për transfertat e fondeve, kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të pagesit dhe të përfituesit është i vendosur në Shqipëri, informacioni i parashikuar në nenin 8 të kësaj rregulloreje;

b) për transfertat e fondeve, kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të pagesit ose të përfituesit është i vendosur jashtë Shqipërisë, informacioni i parashikuar në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 dhe në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2 të nenit 7 të kësaj rregulloreje;

c) për transfertat në grup (*batch file*), kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të pagesit ose të përfituesit është i vendosur jashtë Shqipërisë, informacioni i parashikuar në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 dhe në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2 të nenit 7 të kësaj rregulloreje, në lidhje me atë transfertë në grup (*batch file*).

Neni 14

Transfertat e fondeve me informacion të munguar mbi pagesin ose përfituesin

1. Ofruesi i shërbimeve të pagesave ndërmjetës harton procedura efektive të bazuara në rrezik për të vendosur nëse do të ekzekutohet, refuzohet ose pezullohet një transfertë fondesh, së cilës i mungojnë informacionet e kërkuara mbi pagesin dhe përfituesin, dhe për marrjen e masave të duhura të mëtejshme.

2. Kur ofruesi i shërbimeve të pagesave ndërmjetës merr dijeni, kur merr një transfertë fondesh, se informacioni i parashikuar në nenin 7, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, dhe pikën 2,



shkronjat “a” dhe “b” të kësaj rregulloreje, nenin 8, pika 1, ose në nenin 9, mungon ose nuk është plotësuar duke përdorur karaktere ose të dhëna të pranueshme, në përputhje me rregullat dhe procedurat e transmetimit të mesazheve ose sistemit të pagesave dhe shlyerjeve, siç parashikohet në pikën 1 të nenit 10 të kësaj rregulloreje, ai (ofruesi i shërbimeve të pagesave ndërmjetës) mbi bazën e ndjeshmërisë ndaj rrezikut do të:

a) kërkojë informacionin e kërkuar për pagesin dhe përfituesin, para ose pas transmetimit të transfertës së fondeve; ose

b) refuzojë transfertën.

3. Kur një ofrues i shërbimeve të pagesave, në mënyrë të përsëritur, dështon të japë informacionin e kërkuar për pagesin ose përfituesin, ofruesi i shërbimeve të pagesave ndërmjetës duhet:

a) të ndërmarrë hapa, të cilët fillimisht mund të përfshijnë lëshimin e paralajmërimeve dhe caktimin e afateve, përpara se të vazhdohet me refuzimin, kufizimin ose përfundimin në përputhje me shkronjën “b” të kësaj pike, nëse ende nuk ofrohet informacioni i kërkuar; ose

b) të refuzojë drejtpërdrejt çdo transfertë të ardhshme të fondeve nga ai ofrues i shërbimeve të pagesave, të kufizojë ose të përfundojë marrëdhënien e tij të biznesit me atë ofrues të shërbimeve të pagesave.

4. Ofruesi i shërbimeve të pagesave ndërmjetës raporton pranë Agjencisë së Inteligjencës Financiare, transfertën e refuzuar për shkak të mospërcaktimit të informacionit dhe hapat e ndërmarrë.

KREU III

ZBATIMI I MASAVE SHTRËNGUESE

Neni 15

Politikat, procedurat dhe kontrollet e brendshme për të siguruar zbatimin e masave shtrënguese

1. Ofruesi i shërbimeve të pagesave duhet të ketë politika, procedura dhe kontrolle të brendshme për të siguruar zbatimin e masave shtrënguese sipas ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, gjatë kryerjes së transfertave të fondeve sipas kësaj rregulloreje ose dispozitave të tjera në fuqi.

KREU IV

INFORMACIONI, MBROJTJA DHE RUAJTJA E TË DHËNAVE

Neni 16

Sigurimi i informacionit

Ofruesi i shërbimeve të pagesave do të përgjigjet plotësisht dhe pa vonesë, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullative përkatëse, për kërkesat përkatëse nga Banka e Shqipërisë ose Agjencia e Inteligjencës Financiare, në lidhje me informacionin e përcaktuar sipas kësaj rregulloreje.

Neni 17

Mbrojtja e të dhënave

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave sigurojnë që përpunimi i të dhënave personale sipas kësaj rregulloreje, i nënshtrohet legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

2. Të dhënat personale do të përpunohen në bazë të kësaj rregulloreje vetëm për qëllime të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe nuk do të përpunohen më tej në një mënyrë të papajtueshme me ato qëllime. Përpunimi i të dhënave personale në bazë të kësaj rregulloreje për qëllime tregtare është rreptësisht i ndaluar.

3. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do t'u ofrojnë klientëve të rinj informacionin e kërkuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, përpara se të krijojnë një marrëdhënie biznesi ose të kryejnë një transaksion të rastit. Ky informacion do të jepet në një formë koncize, transparente, të kuptueshme dhe lehtësisht të aksesueshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe, në veçanti, do të përfshijë një njoftim të përgjithshëm në lidhje me detyrimet ligjore të ofruesit të shërbimeve të pagesave sipas kësaj rregulloreje, kur përpunon të dhëna personale për qëllime të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

4. Ofruesit e shërbimeve të pagesave duhet të sigurojnë gjithmonë që transmetimi i çdo të dhëne personale për palët e përfshira në transfertën e fondeve, të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave.



Neni 18

Ruajtja e të dhënave

1. Informacioni mbi pagesin dhe përfituesin nuk do të ruhet për më gjatë se sa është e nevojshme. Ofruesit e shërbimeve të pagesave të pagesit dhe të përfituesit do të ruajnë regjistrat e informacionit të parashikuar në nenet 7 deri në 10 të kësaj rregulloreje, në përputhje me afatet e përcaktuara në nenin 16 të ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.

2. Në përfundim të skadimit të periudhës së ruajtjes së të dhënave të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, ofruesit e shërbimeve të pagesave do të sigurojnë që të dhënat personale të fshihen, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj.

3. Agjencia e Inteligjencës Financiare mund të lejojë ose të kërkojë ruajtjen e të dhënave për një periudhë më të zgjatur, për një periudhë maksimale prej pesë vjetësh, pasi të ketë kryer një vlerësim të plotë të domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit të ruajtjes për një periudhë më të zgjatur dhe kur e konsideron të justifikuar si të nevojshme për parandalimin, zbulimin ose hetimin e pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit.

**KREU V
TË TJERA**

Neni 19

Aktet e tjera në fuqi

1. Kjo rregullore do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, dhe ky i fundit do të mbizotërojë në rast të ndonjë konflikti. Zbatimi i masave të shtuara, detyrimet e raportimit ose çdo detyrim i lidhur do të ketë përparësi, në rast dyshimi për pastrim parash ose financim terrorizmi.

2. Dispozitat e rregullores “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” zbatohen për çdo rast që nuk parashikohet shprehimisht në këtë rregullore.

Neni 20

Raportimi i shkeljeve

Ofruesit e shërbimeve të pagesave hartojnë procedura të brendshme të përshtatshme për punonjësit e tyre të të gjitha niveleve, për të raportuar shkeljet e kësaj rregulloreje brenda subjektit, nëpërmjet një sistemi të sigurt, të pavarur, specifik dhe anonim, në përpjesëtim me natyrën dhe madhësinë e subjektit në fjalë.

Neni 21

Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit të zgjerimit të shtrirjes gjeografike të SEPA-s në Republikën e Shqipërisë, nga Këshilli Evropian i Pagesave.

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave që janë objekt i kësaj rregulloreje marrin masat e nevojshme për përshtatjen e aktiviteteve dhe operacioneve të tyre me kërkesat e kësaj rregulloreje, brenda një periudhe prej 180 ditësh nga miratimi i zgjerimit të shtrirjes gjeografike të SEPA-s në Shqipëri, nga Këshilli Evropian i Pagesave.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Gent Sejko

VENDIM**Nr. 134, datë 9.7.2024****MBI ZGJATJEN E AFATIT TË
VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-
s LIDHUR ME LICENCIMIN E
SHOQËRISË “H.K. HEC GRABOVA 2”
SHPK NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 67 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenit 14, pika 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë



29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.7.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 996/5 prot., datë 4.7.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi licencimin e shoqërisë ‘H.K HEC Grabova 2’ sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Grabova 2’”,

konstatoi se:

- Shoqëria “H.K HEC Grabova 2” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 996 prot., datë 25.4.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Grabova 2”, me kapacitet prodhues 10.8 mw, me vendndodhje në pellgun e përroit të Grabovës, Gramsh, qarku Elbasan.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 87, datë 9.5.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “H.K HEC Grabova 2” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 11.5.2024 dhe 13.5.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 10.6.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën me nr. 996/3 prot., datë 20.5.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të pa plotësuar apo plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria me shkresën me nr. 996/4 prot., datë 3.6.2024, ka përcjellë dokumentacionin plotësues të aplikimit, i cili gjendet në pjesët respektive të këtij relacioni.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesë më të lartë se ajo që kërkohej për një njësi gjeneruese, sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores, ndaj në vijim do të bëhen sistemimet përkatëse me Departamentin e Financës.

- Sa rezulton nga dokumentacioni i depozituar nga shoqëria, lind nevoja për saktësime/sqarime në lidhje me afatet e ndërtimit dhe vënies në punë të hidrocentralit, në referencë të përcaktimeve të kontratës së koncesionit nr. 2026 rep., nr. 926/1

kol., datë 14.9.2017, për ndërtimin e hidrocentralit “Grabova 2”, e ndryshuar. Për këtë qëllim dhe në mbështetje të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 14, pika 3 e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, vlerësohet të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s në lidhje me licencimin e shoqërisë “H.K HEC Grabova 2” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë vendimmarrjen përfundimtare të Bordit të ERE-s në lidhje me licencimin e shoqërisë “H.K. HEC Grabova 2” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Grabova 2”, me kapacitet total të instaluar 10.8 mw, me vendndodhje në pellgun e përroit të Grabovës, Gramsh, qarku Elbasan.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 135, datë 9.7.2024

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “5GX ENERGY” SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e



Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.7.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 866/7 prot., datë 4.7.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi licencimin e shoqërisë ‘5GX Energy’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “5GX Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 855 prot., datë 3.4.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 10 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 1020, fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnjë, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 63, datë 12.4.2024, vendosi të filloje procedurën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 10 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 1020, fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnjë, qarku Fier.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 13.4.2024 dhe 15.4.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 22.4.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të ERE-s. Gjithashtu, me shkresën nr. 1030 prot., datë 2.5.2024, ERE ka njoftuar MIE-n mbi fillimin e procedurës së licencimit të kësaj shoqërie.

- Me shkresën me nr. 867/3 prot., datë 22.4.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të paplotësuar apo të plotësuar pjesërisht. Shoqëria me shkresat nr. 867/4 prot., datë 30.4.2024 dhe nr. 867/5 prot., datë 3.5.2024, ka përcjellë një pjesë të dokumentacionit të kërkuar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 91, datë 13.5.2024, vendosi zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar në lidhje me aplikimin e shoqërisë “5GX Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me qëllim zhvillimin e korrespondencës së mëtejshme me shoqërinë apo

dhe planifikimin e një seance dëgjimore për të sqaruar dokumentacionin e mbetur për t’u plotësuar dhe depozitimin e tij në ERE.

- Pas shqyrtimit të informacionit/dokumentacionit plotësues të depozituar nga shoqëria, me vendimin nr. 114, datë 10.6.2024, ERE vendosi zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar në lidhje me aplikimin e shoqërisë “5GX Energy” sh.p.k., me qëllim dokumentimin e fillimit të punimeve dhe sqarimin/dokumentimin e shumës së disbursuar nga banka në kuadër të financimit të projektit, referuar faktit që shoqëria kishte parashikuar si datë të fillimit të operimit 1.7.2024.

- ERE njoftoi shoqërinë për vendimin nr. 114/2024 me shkresën me nr. 866/5 prot., datë 14.6.2024. Shoqëria ka depozituar informacionin/dokumentacionin e munguar me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 866/6 prot., datë 1.7.2024.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Nga analizimi i aplikimit, rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të përcaktimeve të nenit 9 të rregullores, për pikën 1.1, gjerat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3 gjerat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 2.1 gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria “5 GX Energy” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë Kontratën 2175 rep., nr. 484 kol., datë 23.6.2023, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 10 mw, i cili nuk është objekt koncesioni, dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale 1020, fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnjë, qarku Fier nga shoqëria ‘5GX Energy’ shpk”;

- Ka nënshkruar me shoqërinë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes marrëveshjen nr. 761/2 prot., datë 2.2.2023, për lidhjen e parkut fotovoltaike me rrjetin e shpërndarjes;



- Është pajisur me vendim për VNM paraprahe, lëshuar më 18.7.2023 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për të zhvilluar projektin “Ndërtimi i centralit fotovoltai 5GX Energy Sol Park 10 mw”.

- Shoqëria ka dokumentuar aftësinë dhe mbështetjen financiare për realizimin e projektit sipas planit të saj të biznesit, si dhe ka depozituar kërkesën drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për amendimin përkatës të kontratës nr. 2175 rep., nr. 484 kol., datë 23.6.2023, për sa i përket vlerës së investimit. Në këto rrethana vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të depozitojë në ERE qëndrimin e MIE-s dhe/ose amendimin përkatës të kontratës. ERE rezervon të drejtën e rishikimit të vendimit të licencimit në varësi të përcaktimeve të kontratës shtesë të koncesionit.

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a” të rregullores lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka informuar se jetëgjatësia e paneleve është 30 vjet, ndaj ERE-s kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në përcaktimin e afatit të vlefshmërisë së licencës, pra për 30 vjet. Ky afat do të fillojë nga data e parashikuar nga shoqëria për operimin e centralit, pra nga data 1.8.2024.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “5GX Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 10 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 1020, fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnjë, qarku Fier për një afat 30-vjeçar, duke filluar ky afat nga data 1.8.2024.

2. Shoqëria “5GX Energy” sh.p.k. të depozitojë në ERE qëndrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe/ose amendimin e kontratës së nënshkruar, për kërkesën e bërë nga shoqëria për ndryshimin e vlerës së investimit të projektit.

3. Ky vendim është objekti rishikimi nga ERE në varësi të depozitimit të dokumentacionit të përcaktuar në pikën 2 të tij.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “5GX Energy” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a.

dhe shoqërinë Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 137, datë 10.7.2024

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN QERSHOR 2024 PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 kV

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, e ndryshuar; dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.7.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1597/1 prot., datë 8.7.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin qershor 2024 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

konstatoi se:

- Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 4515 prot., datë 2.7.2024, protokolluar me tonën me nr. 1597 prot., datë 4.7.2024, ka përcjellë në ERE kërkesën mbi miratimin e çmimit të shitjes së



energjisë elektrike të muajit qershor 2024, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit. Bazuar në aplikimin e sipërcituar, për muajin qershor 2024, shoqëria FSHU sh.a. e ka siguruar sasinë e energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës për energji të kësaj kategorie klientësh nëpërmjet blerjeve mujore në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX).

- Për përlogaritjen e çmimit mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike për këtë periudhë (CBEt), shoqëria është bazuar në të dhënat e çmimeve orare të tregut të ditës në avancë të ALPEX-it për muajin qershor 2024, profilet ditore të energjisë elektrike të prokuruar në bursë nga FSHU sh.a., si dhe vlerat rezultuese të faturave ditore. Në aplikimin e përcjellë nga ana e shoqërisë gjenden të bashkëlidhura tabelat me të dhënat e sipërcituara.

- Referuar aplikimit të shoqërisë FSHU sh.a., rezulton se është marrë në konsideratë kursi ditor i këmbimit (EURO/LEK), vlera të cilat janë bazuar në kurset zyrtare të këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë për datat 31.5.2024–29.6.2024.

- Mbështetur në nenin 8 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017,

e ndryshuar, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin qershor 2024 janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes, si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar.

- *Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike* për periudhën 1 maj 2022–31 dhjetor 2024, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.4.2022, është 0.85 lekë/kWh.

- *Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV*, në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 365, datë 15.12.2023, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022”, vijon të jetë 1.55 lekë/kWh.

- *Kostot administrative*, të cilat në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 366, datë 15.12.2023, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022”, vijojnë të jenë 1.06 lekë/kWh.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, referuar aplikimit të FSHU sh.a., si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin qershor 2024, përlogaritet si më poshtë:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin Qershor 2024			
		Njësia	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh	10.86
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.33
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt + TRr + TSHt + CA			14.65



- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë *14.65 lekë/kWh për muajin qershor 2024*.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit sh.a., për muajin qershor 2024 prej 14.65 lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 138, datë 10.7.2024

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “KROI MBRET ENERGJI” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, 13 dhe 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”,

Faqe | 18578

të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin, dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.7.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1028/6 prot., datë 8.7.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Kroi Mbret Energji’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 105, datë 31.5.2024 vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 456, seria T19, të shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 192, datë 2.12.2019, për një afat 5-vjeçar.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 1.6.2024, dhe 3.6.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 10.6.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u publikua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1028/4 prot., datë 10.6.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin për fillimin e procedurës dhe kërkesën për plotësimin e dokumentacionit për të vijuar me procedurën për rinovim.

- Në vijim, shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1028/5 prot., datë 4.7.2024, ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

- Dokumentacioni i këtij aplikimi rezulton tërësisht i plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën nr. 456, seria T19, të shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., në



veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 192, datë 2.12.2019, për një afat 5 vjeçar, duke filluar nga data 3.12.2024.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrje, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 141, datë 16.7.2024

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “BMG ENERGY SAL” SHPK
PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.7.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1569/1 prot., datë 10.7.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi

kërkesën e shoqërisë ‘BMG Energy SAL’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “BMG Energy SAL” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1569 prot., datë 1.7.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 të Rregullores për pikën 1.1, germat “a” “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “a”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3 germën “c”; për pikën 2.1 germat “b”, “c”, “d”, dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria “BMG Energy SAL” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, kontratën nr. 3247 rep., nr. 2138 kol., datë 2.6.2023, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw dhe veprave ndihmëse, zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria “BMG Energy SAL” sh.p.k.”;

- Ka nënshkruar me shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” marrëveshjen nr. 9511/2 prot., datë 13.10.2023, për lidhjen e centralit fotovoltaike të shoqërisë “BMG Energy SAL” sh.p.k. me rrjetin e shpërndarjes.

- Nga ky aplikimi nevojitet të plotësohet informacioni/dokumentacioni në vijim:

Neni 9

Pika 1, “Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë”

Pika 1.2

- Germa “b”: Vërtetimi për vetë shoqërinë duhet të depozitohet me datë të përditësuar dhe i lëshuar jo më vonë se 1 muaj nga paraqitja e aplikimit.

Pika 1.3



- Germa “a”: Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin përkatës që nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

- Germa “b”: Shoqëria duhet të saktësojë/sqarojë ndryshimet e mënyrës së financimit të projektit, si dhe të depozitojë vendimet përkatëse të organeve drejtuese të saj dhe të ortakut të vetëm të saj në lidhje me financimin e projektit.

Pika 2, “Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës”

Pika 2.1

- Germa “a”: Shoqëria duhet të bëjë saktësimet përkatëse në numrin e njërive gjeneruese dhe kapacitetin e instaluar të secilës, të depozitojë dokumentacionin teknik në lidhje me jetëgjatësinë e centralit fotovoltai, si dhe të përcaktojë një datë konkrete për operimin e centralit.

- Germa “e”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentin përkatës të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), VNM paraprake, deklarata mjedisore etj.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “BMG Energy SAL” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “BMG Energy SAL” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM Nr. 142, datë 16.7.2024

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL” SHA PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2 germa “ç” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”, 10, pikat 1 dhe 3, si dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1 germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.7.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1318/2 prot., datë 10.7.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë ‘Furnizuesi i Shërbimit Universal’ sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”.

konstatoi se:

- Shoqëria “Furnizuesi i Shërbimit Universal” (FSHU) sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 3820/3 prot., datë 18.6.2024, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të Rregullores, aplikanti duhet të depozitojë në ERE formatin e plotësuar të aplikimit, sipas shtojcës 1: çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo



dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë; informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë së licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur).

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Shoqëria ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa u përket pagesave të rregullimit.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria ka plotësuar dokumentacionin e përcaktuar në nenin 16, shtojca 1, gerrat “b” dhe “c”, si dhe nenin 16, pika 7, por në kuadër të një dosjeje të plotë aplikimi, shoqëria duhet të informojë në lidhje me sa më poshtë:

Neni 16, “Rinovimi i licencës”:

- Germa “a”: Formatin e plotësuar të aplikimit, sipas shtojcës 1. plotësuar pjesërisht;

- Germa “c” (deklarata e aplikuesit): Aplikuesi ka depozituar shtojcën 1 me dokumentacionin e kërkuar nga gerrat “a” dhe “b”, konstatojmë se aplikuesi nuk ka plotësuar germën “c”, pra deklaratën e aplikuesit. Si e tillë kjo pikë e rregullores konsiderohet e pa plotësuar dhe do t’i kërkohej aplikuesit të depozitojë edhe shtojcën 1/c.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 21.12.2024.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë,

brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 143, datë 16.7.2024

MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË “EGNATIA HYDROPOWER” SHPK, SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 9, pika 8, dhe 10 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.7.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1503/3 prot., datë 10.7.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Egnatia Hydropower’ sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj, si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Egnatia Hydropower” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 248, datë 29.9.2022, dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 238, datë 22.9.2022.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1503 prot., datë 11.6.2024, shoqëria ka paraqitur aplikimin për marrjen e autorizimit nga ERE për



vendosjen e kuotave të saj si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredi dhënëse, “Raiffeisen Bank” sh.a.

- Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar, me shkresën nr. 1503/1 prot., datë 27.6.2024, ERE i evidentoi shoqërisë informacionin/dokumentacionin e munguar të aplikimit të saj.

- Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1503/2 prot., datë 2.7.2024, shoqëria ka depozituar informacionin dhe dokumentacionin e munguar.

- Pas analizimit të kërkesës dhe dokumentacionit rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021, si dhe ka shlyer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k., si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërket nga këto organe.

- Për shkak të natyrës që ka vendosja e një mjeti të tillë mbi kuotat për garantimin e detyrimit përkatës nga i licencuari, vlerësohet që t'i lihet kusht shoqërisë që të njoftojë menjëherë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k., si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse, “Raiffeisen Bank” sh.a.

2. Dhënia e autorizimit, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi, nuk e çliron shoqërinë

“Egnatia Hydropower” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo të palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërket nga këto organe.

3. Shoqëria “Egnatia Hydropower” sh.p.k. të njoftojë menjëherë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Egnatia Hydropower” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM Nr. 146, datë 19.7.2024

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË “NOVA PROSPECT” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar



me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.7.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1448/5 prot., datë 17.7.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Nova Prospect’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Nova Prospect” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1448 prot., datë 3.6.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 22960, Njësia Administrative Pilur, Bashkia Himarë, qarku Vlorë.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 123, datë 19.6.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 20.6.2024 dhe 21.6.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 1.7.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Gjithashtu, me shkresën nr. 1558 prot., datë 27.6.2024, ERE ka njoftuar dhe MIE-n mbi fillimin e procedurës së licencimit të kësaj shoqërie.

- Me shkresën me nr. 1448/3 prot., datë 24.6.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të paplotësuar apo plotësuar pjesërisht.

- Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1448/4 prot., datë 3.7.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Pas shqyrtimit të këtij dokumentacioni, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, rezulton se shoqëria duhet të dokumentojë në ERE mënyrën e shlyerjes së vlerës së mbetur të investimit, si dhe të depozitojë njoftimin që i është bërë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), në lidhje me ndryshimin e vlerës së investimit dhe qëndrimin e saj për këtë, në rast se ka pasur një të tillë.

- Në nenin 14, pika 3, të Rregullores parashikohet, se: “Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë”.

- Me qëllim zhvillimin e korrespondencës së mëtejshme me shoqërinë për të sqaruar informacionin/dokumentacionin që ka mbetur ende për t’u plotësuar dhe depozitim të tij në vijim në ERE, vlerësojmë të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “Nova Prospect” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Shoqëria duhet të depozitojë këtë informacion/dokumentacion në ERE brenda 20 (njëzet) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “Nova Prospect” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacionin/dokumentacionin e munguar të aplikimit brenda 20 (njëzet) ditëve.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “Nova Prospect” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 147, datë 19.7.2024

**MBI DHËNIEN E GARANCISË SË
ORIGJINËS PËR ENERGJINË
ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA HEC
“DRAGOBIA” DHE HEC “CEREM” TË
SHOQËRISË “DRAGOBIA ENERGY”
SHPK**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 22 të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”;

Faqe | 18583



nenit 7 të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar nga Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) me vendimin nr. 229, datë 20.12.2019; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, e ndryshuar; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.7.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 255/8 prot, datë 18.7.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Dragobia Energy’ sh.p.k. për dhënien e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga HEC ‘Dragobia’ dhe HEC ‘Cerem’”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 17, datë 16.2.2026, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-i “Cerem”, me kapaciteti 8.6 mw dhe HEC-i “Dragobia”, me kapacitet 13.3 mw, me kapacitet total 21.9 mw.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2451 prot, datë 30.11.2023, shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për pajisjen me Garancinë e Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga HEC-i “Dragobia” dhe HEC-i “Cerem”.

- Pas zhvillimit të korrespondencës përkatëse me shoqërinë në lidhje me plotësimin e dokumentacionit të munguar dhe për sa i përket sasisë e energjisë elektrike për të cilën shoqëria nuk ka përfutur asnjë lloj tjetër mbështetjeje, rezulton se ajo ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar nga “Rregullorja për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar nga Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 229, datë 20.12.2019, e ndryshuar.

- Duke iu referuar përcaktimeve të nenit 22, pika 6 të ligjit nr. 24/2023, ERE me shkresën nr. 255/2 prot., datë 21.2.2024, i është drejtuar OST sh.a. me kërkesën për informacion për sasinë e energjisë elektrike faktike të prodhuar nga këto hidrocentrale gjatë kësaj periudhe, kodin/numrin e matësve dhe leximin e datës 1 të secilit muaj të kësaj periudhe për secilin hidrocentral.

- Po ashtu, ERE i është drejtuar dhe “FTL” sh.a. me kërkesën për informacion për sasinë e energjisë

elektrike të blerë nga secili hidrocentral i shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k., për secilin muaj të periudhës 1.11.2022–30.11.2023, referuar kjo kontratës përkatëse të shitblerjes së energjisë elektrike të nënshkruar me këtë subjekt dhe aktrakordimeve përkatëse.

- Në përgjigje, OST sh.a. ka sqaruar se, referuar marrëveshjes së lidhjes, për të dy HEC-et si pikë lidhje është pika ku objekti lidhet me rrjetin e Transmetimit dhe pikë matje është pika ku matet energjia elektrike që HEC-et “Dragobia” dhe “Cerem” injektojnë në Rrjetin e Transmetimit.

- Ndërsa “FTL” sh.a. ka sqaruar se shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k. është e lidhur në rrjetin e transmetimit në nivel tensioni 110 kV dhe ka një pikë ku matet energjia për HEC-et “Dragobia” dhe “Cerem”, ndaj “OST” sh.a. i përcjell shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. vetëm një të dhënë për prodhimin e (dy) centraleve prodhuese sipas pikës së matjes, si dhe ka paraqitur energjinë e blerës nga ana e saj gjatë periudhës së kërkuar.

- Për gjithë sa depozituar, vlerësohet që shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k. t’i lëshohet GO për energjinë elektrike të prodhuar nga HEC-et “Dragobia” dhe “Cerem”, për periudhën 1.11.2022–30.10.2023, sipas të dhënave të OST sh.a., duke i zbritur kësaj sasive energjinë e blerë nga “FTL” sh.a.

- Në zbatim të përcaktimeve të nenit 22, pika 5, të ligjit nr. 24/2023, “Garancia e origjinës është e vlefshme për një vit duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e Garancisë së Origjinës për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet “Dragobia” dhe “Cerem” të shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k., për periudhën 1.11.2022–30.10.2023, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Garancia e origjinës, e dhënë sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi, është e vlefshme për një vit duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me vendimin nr. 62-2024-2389 (289), datë 3.5.2024, vendosi shpalljen e zhdukjes së shtetasit Lorenc Silaj, me atësi Agron dhe amësi Urani, i datëlindjes 12.11.1991, lindur në Boshtovë, Kavajë, si dhe caktimin e shtetasit Agron Silaj si kujdestar për administrimin e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme në emër të tij.

Periudha	Energjia prodhuar (MWh) nga HEC-et “Dragobia” dhe “Cerem” për të cilën lëshohet garanci origjine
Nëntor 2022	167
Dhjetor 2022	72
Janar 2023	62
Shkurt 2023	60
Mars 2023	86
Prill 2023	103
Maj 2023	62
Qershor 2023	153
Korrik 2023	89
Gusht 2023	59
Shtator 2023	34
Tetor 2023	0
Totali	947



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024



Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 368 lekë